

Shkruar posaçërisht për gazetën “ExLibris”

## NË GJURMËT E EDWARD LEAR NË SHQIPËRI

Nga Profesor Tim Wilson, *Oxford*

### Vëllimi poetik i Skënder Buçpapajt “IMGUR” -PEIZAZH I NGARKUAR ME SHPIRT

Nga Ali Aliu

(fq.7)

Libri “Imgur” i Skënder Buçpapajt, vjen artikulum i mallit për botëfëmijërinë, për djalërinë; ky bosht tematik shtrihet në hapësirën kryesore të librit voluminoz me rreth 150 faqe, sistemuar brenda 7 cikleve. Ngasja e kësaj ndjenje, mallit për vendlindjen, truallit, sidomos nga distanca kohë-hapësirë, nuk është frymëzim i rrallë...

### “MBRETËRIA E ËNDRRAVE” në vegimet e Ndue Ukajt

Nga Elvi Sidheri

(f.11)

Homazh për Shpresa Bërdëllimën

### SI ERDHE NË JETËN TIME? DHE SI U LARGOVE?

Nga Arjan Miluka

(fq.18)

Studiuesi, përkthyesi dhe profesori i gjuhës shqipe në Universitetin e Sofjes

### Anton Panchev: PËRKTHIMI, NJË AKT I DOMOSDOSHËM NË SHKËMBIMET LETRARE DHE KULTURORE

Intervistë dhënë gazetares  
Mimoza Hasani Pllana

(fq.5)

...erdha për herë të parë në Kosovë në Seminarin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare dhe isha kaq i mahnitur nga mikpritja e shqiptarëve, nga optimizmi i tyre, ndonëse pasojat e luftës ende ndiheshin, që vendosa të merresha në mënyrë profesionale me shqipen.



(fq.9)

### Postmodernizëm/realizëm: përballje kuptimore - filozofike apo formaliste - estetike?

Nga Floresha Dado

Realizmi ka preokupuar filozofë, teoricienë të arteve, veçanërisht të letërsisë, që në antikitet. Por nuk mund të themi se është arritur në një konkluzion të qëndrueshëm, sepse koncepti i realizmit është objekt i mosmarrëveshjeve lidhur me kuptimin, përfshirjen e tij në çdo nivel të teorisë dhe praktikës, të semantikës...



(fq.2-4)

### 13 gabime që hasen rëndom në kritikën letrare dhe si të shmangen ato


JAY A. FERNANDEZ  
shkruan për disa gjëra  
të gabuara

(fq.22)

### SYRI SHQIPTAR: MARY SHELLEY DHE KADARE

Nga Gilles Bandérier

(fq.20)



### BIBLIOTEKË

Xhelal Tosku

*Atdheu është i vetëm si Homeri*

(fq. 12)

Fatmir Mborja

*Etyd*

(fq. 14)

Sokol Sylejmani

*Vyshkun vjeshte*

(fq. 15)

Istref Haxhillari

*Një mënyrë për të vdekur*

(fq. 13)

Xhevair Lleshi

*Misteret e Beratit*

(fq. 16)

### “Letra e verdhë e murit” dhe shqetësimet e Charlotte Perkins Gilman-it

Halle Butler

*The Paris Review*

(fq. 19)

“Letra e verdhë e murit” është rrëfim për hipokrizinë, shtypjen dhe trashëgiminë. Është histori rreth modeleve të fshehura nën modele. Letra e murit e shtyp rrëfimtaren derisa të filloj ta shohë veten te ajo, dhe të identifikohet me të.



# NË GJURMËT E EDWARD LEAR NË SHQIPËRI

*Nga Profesor Tim Wilson, Oksford*



**Profesor Tim Wilson**

**L**idhja ime me Shqipërinë daton që nga fillimi i viteve '90, kur u ftova që të merrja pjesë në një pagëzim në Tiranë. Ceremonia u braktis, megjithatë u bëra me një famull dhe që prej asaj kohe kam shijuar plot udhëtime drejt Shqipërisë, qëkur eksploroja vendet që lidheshin me poetin, muzikantin, aventurierin dhe artistin e shquar, heroin tim, Edward Lear, me të cilin ndoshta ndaj të njëjtën ditëlindje, 12 majin.

Lear është një prej dy udhëtarëve të mëdhenj të cilët kanë lënë gjurmë të identitetit të tyre në kulturën shqiptare, gjatë kohës kur perandoria osmane po tërhiqej dhe idetë e identitetit kombëtar

po shfaqeshin në të gjithë Ballkanin. Lord Byron e vizitoi Shqipërinë në vitin 1809, ku pozoi për Thomas Phillips-it me veshjen tradicionale, “një fustanellë e bardhë dhe e gjatë, një mantel të punuar me ar dhe një xhakë të kadife ngjyrë vishnje, me dantella prej ari”, kostum të cilin ai e quajti “më të mahnitshmin në botë”. Në jug, në qytetin e Tepelenës, ai takoi Ali Pashën, një kryekomandant i përkushtuar për fituar pavarësinë, që e mbrojti Byron-in dhe gjatë turit të tij të madh e furnizoi me bajame dhe sherbet.

Edhe sot, e sidomos në veri, Shqipëria ka mbetur ashtu siç Byron e quajti, “një nënë e ashpër”, një


tokë me male dhe surpriza. Siç kam zbuluar, është një vend i mbushur me mikpritje dhe histori.

Ndihem thellësisht krenar për lidhjen që mbaj me Shqipërinë. Gjatë 20 vjetëve të fundit, kam udhëtuar prej Stambollit përgjatë rrugës Egnatia, përmes Shqipërisë e deri në Adriatik, duke ndjekur gjurmët e Edward Lear-it, i cili botoi ditarin e mirënjohur kur u kthye në Angli në vitin 1851. Në udhëtimet e tij që fillojnë në shtator 1848, ai krijoi mbi 500 tablo, shumë prej të cilave sot gjenden në Bibliotekën Gennadius në Athinë, dhe fatkeqësisht në Shqipëri nuk ndodhet asnjë. Kam vizituar të njëjtat vende dhe kam vizatuar atë çfarë sheh sot. Është një punë e bërë me dashuri, por ka qenë një pretekst i lehtë për t'u kthyer vazhdimisht në tokën e shqiponjave.

U gëzova shumë kur takova profesor Ferid Hudhrin – kisha punuar me projektin tim për Edward Lear-in dhe po ndiqja aventurat e tij në Tiranë dhe në Elbasan, ndaj ishte kënaqësi të pinim çaj bashkë në një restorant të dekoruar me kopje të “topografive” të Lear-it. Tani, dhjetë vite më pas, po punoj ende me të njëjtin projekt, duke vijuar udhëtimin e Lear-it të vitit 1848, me shpresën për ta kthyer këtë projekt në një film dokumentar ku të përfshihen jo vetëm vizatimet e frymëzuara prej skicave të tij, por edhe animime dhe muzikë të krijuara posaçërisht për t'i sjellë në jetë në shekullin e 21-të rromet e tij pesëvargëshe. Megjithatë, edhe pse në mendjen time jam i sigurt se nuk do të gjej kurrë ndonjë justifikim kushedi, bufi dhe macja, kafshët e tij më të famshme dhe çifti më i pagjasë në letërsinë botërore, të pëlqyer prej fëmijëve të të gjitha moshave, do të kërcejnë gjithmonë nën yjet e Adriatikut në një plazh pranë Durrësit dhe do t'i martojë një gjel deti që banon aty pranë. Për mua, poezia dhe arti i Edward Lear-it vijnë më fuqishëm në jetë në Shqipëri dhe ndihem thellësisht mirënjohës ndaj profesor Hudhrit që më ndihmoi të çmoja lidhjen e jashtëzakonshme që ekziston ndërmjet Edward Lear-it dhe vendit tuaj.

Ashtu si Byron, edhe Lear është një personalitet që ka kontribuar në Shqipëri dhe në Britani, vepra e të cilit është jo vetëm e cilësisë më të lartë dhe një dëshmi personale, por në raste të veçanta, ashtu

**Edward Lear, vizatim nga Tim Wilson**







**Tim Wilson, Tiranë, 2011, vizatim**

Vizatimet e xhamisë së Et'hem Bej në Tiranë dhe të kalasë së Durrësit, i kam bërë dhjetë vjet më parë, pothuaj në të njëjtin vend ku i ka realizuar Lear.

**Edward Lear, Tiranë, 28 shtator 1848, akuarel**





si piktura e akuaduktit në Gjirokastrë, Lear na ofron të vetmet dokumente të ndërtimeve që kanë humbur prej kohësh. Si rrjedhojë, për të krahasuar atë që Lear ka vizatuar dhe atë çfarë gjendet sot, siç kam vepruar unë, duhet të shënojmë ngjarjet e gati dy shekuj ndryshimesh rrënjësore.

E megjithatë, edhe sot ruhen ende traditat e së shkuarës: në një shteg të vështirë shkëmbor në vargmalin që ndan Tiranën nga Elbasani, takova rastësisht një bari dhish që mbante veshur një qeleshe të bardhë dhe një xhakëtë të leshtë. Edhe unë dikur jam kujdesur për një tufë dhish të të tilla në malet Tayegetos pranë Spartës në Greqi, ndaj e mora me mend se mund të kishim diçka të përbashkët për të folur, por famulli im, i cili në atë kohë ishte një adoleshent, më këshilloi të bëja kujdes. Mu pas tufës së dhive ishin fshehur dy këlyshë ariu të cilët m'u dukën si qen dhe shkova t'i përkëdhelja. Edhe sot, kujtimet e mia nga ai vargmal janë të mbushura me djathë shtëpie dhe raki të fortë me bollëk, bashkë me ndjenjën se për një fije do ta kisha humbur krahun prej versionit shqiptar të personazhit vizatimor *Winnie the Pooh* (dhe motrës së tij). Bariu i dhive doli nga konteksti i historisë dhe më shpëtoi në momentin e duhur. I jam shumë mirënjohës. Ishte momenti kur e dija se Shqipëria që gjeta ishte po e njëjta Shqipëri që Lear-i zbuloi! Kjo është Shqipëria e arteve dhe traditave folklorike, sigurisht brenda muzeve dhe galerive të artit në Berat dhe Tiranë, por gjithashtu mund të gjendet në vendet e parrahura. Kam ndjekur pasionin e Lear-it për të dokumentuar



Profesor TIM WILSON me studiuesin FERID HUDHRI në takimin për projektin “Edward Lear në Shqipëri”, Tiranë, 2011

shumëllojshmërinë e veshjeve kombëtare dhe kulturën plot gjallëri që përfaqon jo vetëm islamizmin dhe judaizmin, por edhe katolicizmin, ortodoksinë dhe ateizmin e përkushtuar, një kolazh ngjyrash ku çdo gjë ka një kuptim i cili është gjithmonë përtej të përfytyrimit tim. Nëse dëshironi të mrekulloheni dhe të magjepseni, Shqipëria është vendi i duhur.

Në udhëtimet e tij Lear-in e shoqëronte bashkudhëtari i përkushtuar me emrin Georgio,

përmes Ohrit, Strugës, Elbasanit, Tiranës, Krujës, Shkodrës dhe Lezhës, vendlindjes së Gjergj Skënderbeut, më pas drejt jugut në Berat, Ardenicë, Apoloni, Vlorë, Tepelenë, Gjirokastrë dhe në fund Janinë, një qytet tani në Greqinë e veriut. Jam i kënaqur që ashtu si Lear-i, udhëtimi im i parë për në Shqipëri ishte rastësor, dhe ashtu si Lear-i, jam magjepsur nga ky vend. Nuk e kuptoj dhe as nuk pretendoj ta kuptoj – vetë Lear-i e ka thënë më mirë se unë. “Shqipëria është një enigmë e madhe”, por është një enigmë që ia vlen.

Njësoj si Lear-i, edhe unë u gjenda duke bërë skicime të shpejta të cilat më pas i përpunoja në shtëpi. Por ndryshe nga Lear-i, nuk kam justifikim për këtë kujdes. Megjithatë, Lear-i tregon një histori tejet argëtuese nga fillimi i ditarit të tij, kur banorët vendas e qortuan dhe e quajtën djall sepse i skiconte. Ata e larguan nga vendi që kishte zgjedhur duke i thënë “Shporru shejtan! Shejtan!” Zbulova se edhe unë vizatoja turmat, por njerëzit kryesisht dëshironin t'u skicoja portretin, ose, së fundmi, të pozonin për një *selfie*. Vizatimet e mia të xhamisë Et'hem Bej në Tiranë dhe të kalasë së Durrësit jehojnë emrin e Lear-it. Ata janë bërë që përpara dhjetë vitesh, ndërkohë që kanë ndodhur shumë ndryshime, sidomos në Tiranë.

Lear udhëtoi nga Durrësi për në Korfuz, ku jetoi për shumë vite me macen e tij Foss, në një shtëpi që vështron mbi portin e Korfuzit, të cilën e njoh mirë. Ai u largua për në San Remo në Itali, ku edhe ndërroi jetë. Në atë kohë, për të po kujdesej djali i Georgio-s.


Megjithëse arti shqiptar mbeti në vend nën sundimin osman dhe luftoi me censurën gjatë epokës së pasluftës të Enver Hoxhës, në fillim të shekullit të 19-të dhe së fundmi prej viteve '80, ka pasur një zhvillim të shpejtë. Arti bashkëkohor nxitet nga një komunitet entuziast i diasporës, në Kosovë, si edhe në Europë e Amerikë. Por do të ishte e gabuar ta mendojmë artin shqiptar si një fenomen të vetëm 200 viteve të fundit – një udhëtim i shpejtë për në Butrint duhet ta bindë çdo udhëtar se ky është një vend me një të kaluar të mahnitshme. Atje gjeta një teatër të përsosur grek dhe rrënoja të cilat me siguri mund të datojnë që nga rënia e vetë Trojës. Në fjalë të tjera, historia e artit shqiptar është e një vendi me të shkuar dhe të ardhme shumë të shëndetshme.

*E dua Shqipërinë!*

E përktheu nga anglishtja  
DAVID HUDHRI



Edward Lear, Durrës, 11 tetor 1848, akuarel



Tim Wilson, Durrës, 2011, vizatim



“Që nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX shkencëtarë si Vasil Kënçov, Nedjalko Kolushev (N. Marenin), Stefan Dimitrov, Jordan Ivanov, Stefan Mladenov, Dimitër Gadzhanov, dhe më vonë Bojka Sokollova e disa të tjerë, kanë qenë jo vetëm midis profesorëve më të famshëm bullgarë, të cilët kanë lënë gjurmë të shumta në fusha të ndryshme si historia, gjeografia, arkeologjia, ekonomia, etnografia, gjuhësia etj., por kanë shkruar edhe disa libra dhe shumë artikuj shkencorë, në të cilët janë përshkruar dhe janë hulumtuar viset lindore shqiptare”. **Anton Panchev**

Studiuesi, përkthyesi dhe profesori i gjuhës shqipe në Universitetin e Sofjes “Shën Klimenti i Ohrit”

## ANTON PANCHEV: PËRKTHIMI, NJË AKTI I DOMOSDOSHËM NË SHKËMBIMET LETRARE DHE KULTURORE

*Intervistë dhënë gazetares Mimoza Hasani Pllana*

**M.** Profesor Anton, në Kosovë jeni bërë i njohur për kontributin në fushën e studimeve ballkanike, relacioneve kulturore në mes shqiptarëve dhe bullgarëve, për mësimdhënien e gjuhës shqipe në Universitetin e Sofjes, “Shën Klementi i Ohrit” dhe për pjesëmarrje të rregullt në Seminarin për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Si u lidhët me gjuhën shqipe?

**Anton Panchev:** E vërteta është se kur isha student në Departamentin e Ballkanistikës i preferova greqishten dhe rumanishten dhe kisha ndërmend të merresha me këto gjuhë, por në vitin 2005, me rekomandimin e profesoreshës sime të gjuhës shqipes, Rusana Bejleri, erdha për herë të parë në Kosovë në Seminarin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare dhe isha kaq i mahnitur nga mikpritja e shqiptarëve, nga optimizmi i tyre, ndonëse pasojat e luftës ende ndiheshin, që vendosa të merresha në mënyrë profesionale me shqipen. Prej vitit 2005 marr pjesë rregullisht në Seminar me kumtesa – mendoj se kam mbi 12 pjesëmarrje. Në vitin 2006/2007 isha në Prishtinë, ku e mësova shqipen me studentët e Degës së Gjuhës Shqipe. Pastaj prof. Bejleri më ftoi që të bëhesha asistent në Universitetin e Sofjes.



**M.:** Si i kujtoni profesorët tuaj të gjuhës dhe letërsisë shqipe?

**A.P.:** Në semestrin e parë profesoreshat e mia ishin Zonja Kostadinova dhe Rusana Bejleri, pastaj vetëm prof. Bejleri. Për fat të keq, unë nuk isha shumë i rregullt në mësimet e shqipes, por më bënë përshtypje përpjekjet e tyre ta stimulonin interesin e studentëve dhe të kërkonin qasje individuale ndaj nesh.

**M.:** Kurset e gjuhës shqipe në Universitetin, “Shën Klementi i Ohrit”, filluan në mbaheshin në vitin 1962 nga profesor Thoma Kacori, më pas nga profesoreshë Zonja Kostadinova, ndërsa në vitin 1994 me përkrahjen e madhe të linguistës së njohur bullgare Petja Asenova, gjuha shqipe filloi të mësohet si lëndë e veçantë obligative në kuadër të studimeve të Ballkanologjisë. Si i kujtoni këto tri personalitete të rëndësishme, si ishte raporti juaj me ata gjatë studimeve dhe më pas?

**A.P.:** Zonja Kostadinovën dhe prof. Petja Asenovën i kam pasur pedagoge në Universitetin e Sofjes dhe ruaj kujtime shumë të mira prej tyre. Më kanë inspiruar me etikën e tyre profesionale dhe me punën e palodhshme. Për fat të keq, kam kontaktuar shumë pak me Thoma Kacorrin, por e di kontributin e tij madhështor për hulumtimin e të gjitha drejtimeve të albanologjisë.

**M.:** Duke qenë se jeni nga profesorët e njohur të shqipes, në Degën e Ballkanologjisë, si ndiheni sot kur programet për studimet shqiptare janë zhvilluar deri në nivelin PhD?

**A.P.:** Neve na vjen shumë mirë se përveç studentëve dhe doktorantëve bullgarë, në vitet e fundit kemi edhe disa doktorantë nga Kosova dhe dy prej tyre i mbaruan studimet me sukses të plotë. Jemi krenarë me to dhe jemi të sigurt se do të realizohen në fushat e tyre shkencore dhe profesionale. Ne, profesorët e Katedrës sonë, por edhe studentët dhe doktorantët tanë, kanë mësuar dhe mësojnë shumë gjëra të dobishme falë doktoranteve tona nga Kosova.

**M.:** Ka disa vite që bashkëpunoni me Universitetin e Tiranës dhe Prishtinës, jeni pjesë e tryezave dhe seminareve me prezantimin e kumtesave shkencore



*të studimeve në fushën e gjuhësisë ballkanike dhe asaj shqipe. A mund të na thoni sa është studiuar shqipja në kontekstin ballkanik dhe çfarë e bën të veçantë kulturën shqiptare nga kulturat e vendeve tjera ballkanike?*

**A.P.:** Është e vërtetë se kemi bashkëpunim të frytshëm me shkencëtarët shqiptarë dhe marrim pjesë në forume të ndryshme shkencore në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoninë e Veriut, ku prezantohen kumtesa shumë interesante dhe mësojmë në mënyrë të ndërsjellë. Është e natyrshme se fqinjët e shqiptarëve, pra popujt e tjerë në Gadishullin tonë, ta studiojnë dhe ta mësojnë gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Më duket, mund të gabo, se në të kaluarën ka pasur më shumë studiues që janë marrë me shqipen. Ndoshta gjatë këtyre viteve ka një ndërrim të brezave në albanologji.

**M.:** *Kultura shqiptare është e lidhur me shtetin bullgar nga fundi i shek. XIX, përmes veprimtarisë së kolonisë Shqiptare të Sofjes, aktiviteteve të shoqërive kulturore, të cilat gjetën mbështetje nga Qeveria Bullgare për të kontribuar për Rilindjen Kombëtare Shqiptare, sa mund të kenë ndikuar këto relacione të hershme për të njohur gjuhën e njeri-tjetrit dhe për të vazhduar bashkëpunimin edhe sot?*

**A.P.:** Për shkak të këtyre proceseve, në Bullgari kanë mbetur arkiva tepër të çmuara për historinë shqiptare në të gjitha aspektet. Kjo pasuri dokumentesh në Bullgari sa i përket historisë së shqiptarëve, gjithmonë i ka ndihmuar hulumtimet albanologjike në Bullgari. Që nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX shkencëtarë si Vasil Kënçov, Nedjalko Kolushev (N. Marenin), Stefan Dimitrov, Jordan Ivanov, Stefan Mladenov, Dimitër Gadzhanov, dhe më vonë Bojka Sokolova e disa të tjerë, kanë qenë jo vetëm midis profesorëve më të famshëm bullgarë, të cilët kanë lënë gjurmë të shumta në fusha të ndryshme si historia, gjeografia, arkeologjia, ekonomia, etnografia, gjuhësia etj., por kanë shkruar edhe disa libra dhe shumë artikuj shkencorë, në të cilët janë përshkruar dhe janë hulumtuar viset lindore shqiptare. Ata kanë udhëtuar në Maqedoni dhe në Kosovë dhe përshtypjet e tyre bashkë me një analizë të shkëlqyer kanë sjellë rezultate të larta shkencore. Nga punimet e tyre mund të marrim të dhëna dhe fakte të hollësishme për gjendjen në trevat lindore shqiptare, por edhe në përgjithësi. Hulumtimet e këtyre profesorëve vazhdojnë të jenë burim i çmueshëm për numrin e popullsisë shqiptare në Maqedoni, por edhe në Kosovë në fillim të shekullit XX, për gjendjen sociale, për ekonominë, tregtinë, gjuhën, situatën fetare, etnografinë, arkitekturën, kolonizimin serb pas Luftërave Ballkanike, për arsimin dhe organizimin shoqëror, për kishat dhe xhamitë e për shumë aspekte të tjera nga jeta e shqiptarëve.

Edhe në shekullin e ri historiografia dhe gjuhësia bullgare vazhdojnë të japin kontributin e tyre për hulumtimin e shumë aspekteve të rëndësishme nga historia, gjuha, letërsia dhe kultura e shqiptarëve. Punimet e studiuesve të rinj si Teodora Toleva, Marjana Stamova, Iliana Ilieva etj., hedhin dritë mbi periudha vendimtare në zhvillimin e popullit shqiptar. Studimi i prof. Georgi Georgievit “Marrëdhëniet politike bullgaro-shqiptare (1908-1915)” është përpjekja më e re për vlerësimin e lidhjeve ndërmjet

shqiptarëve dhe bullgarëve në një periudhë jashtëzakonisht të rëndësishme në historinë e tyre. Në fushën e gjuhësisë dhe të letërsisë punojnë studiues si prof. Rusana Bejleri, prof. Ekaterina Tërpomanova, Ludmill Stankov dhe disa të tjerë. Studimet e tyre kanë vlera të veçanta dhe trajtojnë çështje shumë të rëndësishme për zhvillimin e shqipes në Bullgari, për krahasimin e gjuhës shqipe me gjuhët e tjera ballkanike.

**M.:** *Më vonë, me ardhjen e komunizmit në pushtet, marrëdhëniet ndërkulturore filluan të ftoheshin, sa i ka dëmtuar zhvillimet ndërkulturore ky lloj regjimi?*

**A.P.:** Faktikisht, këtu mund të shënojmë se ka pasur dy periudha në periudhën komuniste. Së pari, deri vitin 1961, pra deri në shkëputjen e lidhjeve mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik, lidhjet ndërmjet Shqipërisë dhe Bullgarisë kanë marrë një hov të madh në të gjitha fushat – marrëdhënie politike, ekonomike, kulturore etj. Pas këtij viti ndodhi e kundërta – për shkak të ideologjisë, këto lidhje janë zvogëluar së tepërmi. Por, prapë ka pasur kanale dhe mundësi për zhvillimin e kontakteve kulturore – mjafton ta përmendin faktin e mirënjohur se romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” është përkthyer për herë të parë në një gjuhë të huaj pikërisht në bullgarisht. Me të gjitha mangësi dhe shtypjen, periudha e komunizmit ka pasur edhe dobi sa i përket përkthimit me sistemin e tij të centralizuar për financim.

**M.:** *Aktualisht, përveç studimeve, numërojmë disa shkrimtarë shqiptarë veprat e të cilëve i keni përkthyer në gjuhën bullgare, a do të thotë kjo se janë rritur mundësit që lexuesi bullgarë të njohë kulturën shqiptare përmes letërsisë, si mendoni, sa lexohen këto vepra?*

**A.P.:** Është e qartë se ne, përkthyesit, por edhe në vend të parë edhe autorët, kemi shumë telashe në dy dekadat e fundit së paku për shkak të teknologjive të reja. Libri ka humbur hapësira të mëdha në krahasim me format e tjera të zbavitjes. Nuk e di si është situata në vendet e tjera evropiane, por në Bullgari dominon një tip letërsi, që ka për qëllim thjesht zbavitjen dhe tekste të tjera lexohen kryesisht nga specialistët në fushën përkatëse.

**M.:** *Bazuar në përvojën tuaj dhe në teoritë e përkthimit, si mendoni, e dëmtun veprën origjinale përkthimi?*

**A.P.:** Natyrisht, një përkthim që është “kopje” e origjinalit është krejt i pamundshëm. Përkthyesi është kufizuar jo vetëm për shkak të gjuhës dhe kuptimet, nuancat e pasura të një fjale, të një shprehje etj., por edhe nga i tërë konteksti historik, kulturor... Pra, në këtë plan mund të flasim deri diku për “dëmtime” të origjinalit, por nga ana tjetër, nuk duhet të harrojmë që përkthimi është edhe një lloj interpretimi dhe përkthyesi e “pasuron” origjinalin – i jep tekstit kuptime dhe përmasa të reja. Këto zhvillime të paevitueshme duhet shikuar nga pikëpamja pozitive.

**M.:** *Ka shumë debate mbi përkthimin, si e shihni ju rolin e përkthimit në letërsinë botërore, e pasuron atë, apo nuk është i nevojshëm?*

**A.P.:** Pa përkthimet nuk mund të ketë fare shkëmbime letrare dhe kulturore dhe për mua debate të tilla janë krejt të panevojshme.

**M.:** Autorët që keni përkthyer janë zgjedhje juaj personale, rekomandim i shtëpive botuese, apo jeni ndikuar nga vlerësimet e kritikës dhe shitja e librit në gjuhën origjinale?

**A.P.:** Më së shumti kanë luajtur rol preferimet e mia, ndoshta. Kam bërë përpjekje të realizoj përkthime të veprave që u japin lexuesve bullgarë njohuri për historinë e shqiptarëve, për vlerat e tyre kombëtare. Për fat të keq, unë kam kufizime kohore, luan një rol tepër negativ edhe tregu i vogël dhe i varfër bullgar, ku nuk ka mundësi për përkthime duke u mbështetur mbi përfitime tregtare.

**M.:** Duke qenë se jeni aktiv në punën tuaj shkencore, a mund të na thoni se çfarë jeni duke punuar aktualisht?

**A.P.:** Aktualisht merrem me hulumtimin e ndikimit të shqipes mbi të folmet e fshehta të muratorëve në Bullgari dhe në përgjithësi me ndikimin e shqipes mbi bullgarishten. Para një viti u habita shumë kur kuptova se edhe në një katund, që ndodhet 4-5 kilometra nga fshati i fisit tim, para 50-60 vitesh ka pasur njerëz të moshuar, të cilët e kanë përdorur këtë të folme me mbi 100 fjalë shqiptare. Ky është veç një shembull se dukuria e shpërndarjes së shqipes ka qenë më e madhe sesa është menduar.



**Anton Panchev**, (28 dhjetor 1978, Srednogorie). Më 1997, ka përfunduar Shkollën e Mesme “Vasil Levski” në qytetin Elin Pelin me profil ekonomik. Ka studiuar në Universitetin e Sofjes “Shën Kliment Ohridski”, në Degën e 9. Stereotipet Televizive, ku ka mbaruar edhe studimet master në Degën e Shkencave Politike (1997-2003) dhe atë të Ballkanistikës (2000-2005, Master). Në vitin 2013 ka mbrojtur disertacionin me temë për zhvillimet politike në Shqipëri pas vitit 1991 dhe e ka marrë titullin Doktor i Shkencave politike. Nga viti 2009, ka filluar punën si profesor asistent në Degën e Ballkanistikës, ku ligjëron shqip dhe disa lëndë zgjedhëse për zhvillimet politike në Ballkan. Ka publikuar mbi 50 punime shkencore në shqip, bullgarisht dhe anglisht, të botuara në disa vende. Në këto punime, kryesisht trajton temat për marrëdhëniet bullgaro-shqiptare nga pikëpamje historike, politike dhe gjuhësore. Ka marrë pjesë në mbi 30 konferenca shkencore në Bullgari dhe në vende të tjera. Përveç studimeve, Anton Panchev është edhe përkthyes letrar, deri tani ka përkthyer 10 libra nga shqip në bullgarisht dhe anasjelltas dhe disa tekste të tjera. Merret edhe me analiza politike për gazeta dhe revista, ku në fokus janë marrëdhëniet bullgaro-shqiptare.



“Imgur”, libër i poetit Skënder Buçpapaj

# “IMGUR” - PEIZAZH I NGARKUAR ME SHPIRT

Nga Ali Aliu



Viteve të fundit, sidomos, ato 2018 – 2020, poezia shqipe solli disa nga librat më të artikuluar; - kam parasysh “Kukuta e Sokratit”, (Sabri Hamiti), “Këngë e Solomonit”, (Sadik Bejko), “Prill i hidhur”, (Bardhyl Londo), “Rrathët e brendashkruar”, (Rudolf Marku), “Lirikë me dhimbje”, (Majlinda Rama), “Mështeknaja e babait”, (Lindita Ahmeti), “In Love”, (Preç Zogaj) dhe “Imgur” i Skënder Buçpapajt.

Libri “Imgur” i Skënder Buçpapajt, vjen artikulum i mallit për botëfëmijërinë, për djalërinë; ky bosht tematik shtrihet në hapësirën kryesore të librit voluminoz me rreth 150 faqe, sistemuar brenda 7 cikleve. Ngasja e kësaj ndjenje, mallit për vendlindjen, truallit, sidomos nga distanca kohë-hapësirë, nuk është frymëzim i rrallë në poezi, dhe, edhe në poezinë tonë... Malli është emocion i fuqishëm, sidomos nga largësitë e papërballueshme, si ato të periudhës së Rilindjes në poezinë shqipe.

Te vepra poetike “Imgur” e Skënder Buçpapajt,

afshi i parë ndjellës i lirikës, lidhet me vetminë e cila vuan një mall që ushqehet, mbahet gjallë që nga fëmijëria, djalëria e memorizuar dhe që artikulohet varg i pakëputur imazhesh, në këtë rast, ngarkuar me emocion dhe refleks bashkë, estetikisht me ngasje të fuqishme sugjестive...; vetmia ngacmon dhe vë në lëvizje tërë këtë univers të palosur, palimpsest, që përcjell varg-pamjet, të cilat vijnë të përtërira udhësh, perspektivash, ngjyrimesh, rrethanash të shumta si përfitime riinkarnimi dhe rrezatim kreativ i pandërprerë; imazhet, që iluminojnë hapësirën, gjithë nga pamje të ndryshme, sjellin impulse dekoduese lidhur me kontekste të shumta dhe lëvizëse, identifikime me situata përjetuese. Mes këtij ndërkomunikimi lirik me librin “Imgur” të Buçpapajt, universi në të cilin ateron kujtimi i subjektit, rrezaton ndjesi ndjellëse ndaj natyrës, e me këtë rast, ndaj imazheve me bukuri atraktive, ku shquhet bardhësia e ngrohtë-e acartë, dimërore,


alpinike; magjia e hapësirës së bardhë pafund që sa sfidon tundime të kundërta, ndjellëse, në vetmi përsiatëse, lëshuar ëndjeve të ekzistencës, pa përjashtuar disponimin melankolik, edhe ashtu ndër më elegantët; herë duke i hapur krahë imazhit ngarkuar përjetime të ndryshme, bosht qendror i poetikës së kësaj poezie, në radhën e përtërimit konstant, vjen ngarkuar edhe me disa sinjale dhe kode të pashfaqura, enigma që përftojnë dritë të pakapshme, një fluid i ndehur së brendshmi dhe perfeksion estetik, me ndjelljen e magjisë për përsiatje; siç ngjan me vargjet e tre cikleve të para të librit “Imgur”, por që ndjehet gjithandej në këtë libër...

Gjatë procesit të ngjizjes, thurjes dhe rrjedhjes varg të imazheve dhe të substituiimit të asociacioneve që nxisin ato, në lirikën ngarkuar mall të këtij poeti, pamjet vijnë plot tensione emocionale, kambana që rrahin larg në kohë, sa nënshtresa mitike, mitizuese; thurje ëndërore që luhaten krahëve kontenplative... Imazhet e nënqiellit të tillë në lirikën e Buçpapajt, vijnë semantizim i zëshëm me ngjyrim të fuqishëm emocional në radhë të pare dhe, thellësi refleksive, qartësisht të prekshme si

përjetim. Duke semantizuar tone, vibrime, duke i ngarkuar me to imazhet, dekor i jashtëm dhe brendshëm, virtytet dhe huqet e tyre, sfidën dhe ndjelljen, joshjen dhe kërcënimin, kureshtjen dhe magjinë ndjellëse (Nata e shpirtave...), tërë shumësinë emocionale dhe reflektive, valët e shtimungjeve, iluminimeve të brendshme, poeti mëton, me këtë rast arrin, finalizim estetik të gjendjes shpirtërore dhe kuptimore; dhe rishtazi fillon nga e para, një ecejake, mes udhëkryqeve të pleksura, nisjeve të furishme, buzë caqeve e kurrë të mbërritura, pranë sapo të prekura gjurmët, zërat, pamjet e çdo gjë që digjet të bëhet fjalë, të flasë dhe tretje në hapësirën pafund, të bardhë, të gjelbër; tërë në fluturim përftues, fshikës që zërin e lëshon jehonë të tretur larg në horizont, ndjellës, magjepsës, urtësi ngasëse: - hapësira pafund s’pushtohet dot, sovrani kaq, kështu ka vendosur, kaq përjetësi për mallin; e zëri lirik, poeti nën saçin e mallit, sizif i pashëruar, ia nis udhëtimit që nuk do prajë së ëndërruari...; pa turje, pa patos romantik, udhëtim spontan, natyrshëm, prandaj plot hijeshi, elegance, gatuar ndjenjë dhe refleks bashkë; ritmi ngakuar tensione i vargut, ka këtë ngjyrim, këtë puls zemre dhe urtie; pa qenë peng personal i zërit, por që ndjek parimin e rreptë estetik, që pas çdo shpërthim emocion malli, ateron në tokën e fortë; sintezë artistike e përbërësve të poetikës me këtë rast, pos e pranishme në vargjet dhe tërësinë e librit, e plotë, e përsosur qëndron edhe në tekstin e poezisë “Imgur”, që është edhe titulli i librit...; imazhi që sjell poezia, një sfond me dritë të fuqishme, brenda të cilit kushdo e çdogjë gjakon të shndërrohet në zë, në jehonë, në dekor stampuar, testament në hapësirë me ozon të pastruar qartë, rrjedhë rrëke ritmike, këtu janë përmasa frymëzimi, janë vetëdehje malli e zërit lirik në krahët e këtij bashkëbisedimi...

Poeti Skender Buçpapaj, mesa di, ka 30 vite që jeton në Zvicër, dhe në gjirin alpin të lindjes, është vizitor i shpeshtë. Se sa e bën zjarr me flakë në ngjitje këtë ndjenjë dhe sa e kundërta, në zbehje, kjo është për t’u parë. Malli i tij... ndërsa, kthimi i tij është i tjetër cilësie, është strehë mbrojtëse nga tjetërsimi, nga trysnia e përditshmërisë, është mëtim për oksigjen që pastron, ngjashëm me atë të Azem Shkrelit që, sa herë ndjen se i zbehet qëndresa e boshtit kurrizor, ateron majave të Rugovës së tij.

Në rastin e Skënder Buçpapajt, sa më i shpeshtë kthimi fizik, aq më i gjallë e më i etshëm malli që nuk ka kthim; nuk ka kthim të imazheve shtresuar kujtimesh, s’ka kthim të situatave shpirtërore, të sfidave, vatrave pa fund të shtresuara, gëzimeve, lumturimeve, habitjeve, frikërave e magjive; tërë ai univers i pasur, ngarkuar memorie, shndërruar në një hije, boshësi, mbetur shkretë e jetim, mbetur veçse një bosh gërryes, që veç sa ta bën të papërballueshme vetminë; veç sa të ndërmend të braktisurin, të përjashtuarin dhe përjashtuesin që mëton të shuajë etjen nga kroje të shtruara, burime të tharë; zjarr i ndezur-i shuar-i përhershëm i njeriut që poezia, qysh nga fillimet, e ka shndërruar art...





Shpalimin e një bote të shtresuar nga e kaluara e kësaj perspektive, si mozaik kujtimi, poeti Skënder Buçpapajt e sinjalizon që në titullin e librit, “Imgur”, me gjeturi kreative, që rrezaton shtresime kuptimore, emocionale të pritshme, në vargun e asociacioneve Im’At, Ime Më, Im’ Bir, Vatër, Kullë, Qëndresë,... Përjetësi.

Hapësira, pamja, imazhi është gjuha e parë e kësaj poezie, është shtrati “narrativ” i kësaj lirike; ai lëviz dhe përcjell në ecje asociacione atraktive, bartje emocionesh dhe refleksesh; shtrati-kohë ndërsa qëndron në sfond, gjithë duke e përplotësuar, e përgjallëron vargun zinxhiror të tyre, të imazheve, të ngarkuar mall dhe përsosmëri estetike; është imazh-gjuhë që shtrihet pafund në bardhësinë dimërore të alpeve shqiptare, bujshmëri bari pranveror, gjelbërim pyllor, gjallëri zogjsh e gjë e gjallë, tinguj kumbone që e mbushin hapësirën refleksive të brendshme, zhveshur mallëngjime patetike; mozaik hapësire dhe kohe, ndërlidhur raportesh ekzistenciale, bulëzim refleksesh për kthim të mundshëm, të pamundshëm, njësoj si imazhet e prekshme e të paprekshme, përfundimisht të pakthyeshme...

Kthim-moskthimet e tilla në poezi, në letërsi, janë xehe frymëzimi; ushqejnë ngasje, njësoj si në lashtësi, kohëve kur shtegtim-komunikimi, bëhej këmbë-kaluar; njësoj hapësira pushtoheshin pa pengesa, përmes imagjinatës, si fluturimet e sotme. Malli për t’u kthyer gjurmëve dhe ëndrrave është i pashuar; është mëtim për të kaluarën, për të pakthyeshmen, mëtim për të qenë prani atje ku s’mundet, prani e asaj që s’është, përjetësia...

Një mëtim për kthim, strehë, vërehet tek një rreth poetësh, të përafërt në brez, si Preç Zogaj te kthimi i mundshëm e i pamundshëm orfeik, Sadik Bejko tek urtia solomoniane, Sabri Hamiti te kupa e Sokratit, Rudolf Marku, te kthim i mundshëm e i pamundshëm në Tiranë, jo shumë larg, kthimi i Azem Shkrelit majave kristalore të Rugovës për strehë mbështetëse e kodeve etike në përpjestim majash alpine, strehë mbrojtëse nga brutaliteti agresiv i përditshmërisë. Poezi që duhet veçuar është poezia ‘Ngujim në Gur’, e cila vjen në përmasat e një poezie antologjike.

#### NGUJIM NE GUR

*Qiejt që lë tek ju ja si ikin me një thikë hënë të ngulur  
Në shpinë*

*Në këtë natë me hënë shpinëkthyer nga unë, po e marr  
Veten time dhe po e ngujoj në këtë gur  
Veshur dhe mbathur larë dhe krehur me kozmosin tim  
Me kozmosin tim që nuk e ndaj me askënd që e ndaj  
Veç me veten time*

*Kjo hapësirë e pafund ishte plot me pritjen time*

*Kjo hapësirë e pafund është plot me mua*

*Këtu shoh gjithkënd e gjithçka, këtu më sheh*

*Zoti*

*Për trup e për shpirt kjo hapësirë nuk më bie ngushtë as*

*Unë nuk i bie ngushtë*

*Qiejt tuaj ikin askush nuk ua heq dot thikën thikën e hënës nga  
Shpina*

*Nuk ia heq dot shpinën e therur të këtyre qiejve këtij*

*Tehu të zi hënë të zverdhur,*

*Nuk ia heq dot damarët e prerë të këtyre qiejve këtij*

*Tehu të verdhë hënë të nxirë*

*A nuk duket kjo hënë mbi shpinë të këtyre qiejve në ikje*

*Si një embrion i dështuar hershëm?*

*A nuk duket kjo hënë mbi shpinë të qiejve në ikje si një*

*Kërmill mbi shpinë*

*Guaskash fluturuese?*


*Kështu pyes uni teksa ngujohem në gurin tim me diell*

*Dhe hënë të tetën*

*Që lindi njëherë dhe nuk perëndon kurrë. Pyes. Kë tjetër?*

*Pyes veten time.*

Melankolia është veshje estetike, me gjetje kreative në tërësinë e universit poetik; peng-ngujuar, i ndërsjelltë, gozhdë malli stampuar në gur. I përjetshëm? Për zërin lirik po, përjetësuar në art; hëna, sa verdhë, sa zi, pleksura e



përjashtuar gjithnjë fluturimthi, përftimthi, me gozhdëngulurën në shpinë, - edhe ajo, sado në ikje, s’kalon përtej, në tretje përfundimtare.....

Ta përsërisim edhe njëherë se, imazhi në librin “Imgur” shquhet me vezullim të fuqishëm; janë sa të shtresëzuara në memorie, sa të përplotësuara dhe metamorforizuara në ecje, sa në pritje të zërit për takimin e radhës veshur nga e para, është në funksion të përhershëm frymëzimi; ambienti që e ka ngjizur dhe prej nga ka hyrë në botë, në udhëtim-jete, kurdo e kudo i pandarë; nga shumë perspektiva, situata ekzistenciale, sfida ndaj të cilave përballlet poeti udhës, rrahgjetje, rigjetje, veten, unin, kodin identitar; ngasje që shpien tek hapat e parë në jetëbotë; është imazhi i marrë me vete i asaj bote; tek rasti i Buçpapajt ai është zë ndjellës për kthim, për marrje oksigjeni në përballim me largësitë, tjetërsimet, brutalitetet, absurditetet; tundime të tilla, të poetëve të shquar, janë të shpeshta në përgjithësi, edhe në poezinë tonë; të ndryshme janë rrugët e thithjes oksigjen, të ndryshme rrethanat ambient dhe kohë; poezia moderne moti e shkarkuar patosit, drejt refleksive përsiatëse, edhe filozofike; valët e imazheve vijnë ngjyime dhe ritme në lëvizje, vijnë shtysë vetëdehjeje drejt mëtimeve për prani, për reflektim dy kahjesh, përftim që iluminon dy palët në kryqëzim; sa më ngulmues trazimi drejt ngujimit në gur, drejt përjetësimit, aq më i pakapshëm peizazhi në ikje, aq më e largët jehona, magjia për ta shuar mallin, për ta mëkuar vizionin e zërit që s’pushon së besuari; brenda këtij konteksti trazimi të brendshëm, brenda këtij gjakimi për të mbërritur, për kthim, për zënie e të ikurës dhe, pamundësinë e arritjes në asnjë cak, imazhi në fjalë, ai i mbamendjes, i zgjimit të saj që i bie në gjirin alpin shqiptar, arrin edhe gjuhën universalizuese të artit poetik; sidomos, këtë nuancë poetike e nxit, e mban gjallë prania e nuancës së refleksit, premisat përsiatëse që artikuloohen pëshpëritje të brendshme, të pazëshme; është ndjellje e gjithandëjshme e lirikës së Skënder Buçpapajt me rastin e këtij libri, që pa ndërhyrje, pa këmbëngulje, e tërheq lexuesin në krahët e një prehje kontenplative; pikërisht, edhe kjo nuancë, ky oksigjen, nga tërësia e përbërësve të poetikës, poezinë e librit e kompletton, e bën plotëni artistike, e rendit ndër veprat përfaqësuese të lirikës bashkëkohore të shqipes.

Skënder Buçpapaj është poet i imazheve të shpirtit; ato kanë ngarkesën e refleksit të jashtëm të botës, të natyrës, të gjithësisë dhe situatat shpirtërore të zërit të vet; ja edhe vargjet medalione edhe të një poezie të shkurtër:

#### LUGU I GDHEJVE

Këtu përroin mespërmes  
Dhe udhët në të dyja anët e përroit  
I fsheh bari i ri  
Ashtu si bari i vjetër  
Këtu qielli i ri ia fsheh tokës  
Ashtu si qielli i vjetër  
Dhe toka ia fsheh qiellit  
Ashtu si toka e vjetër  
Lugun e Gdhëjve  
Pishat në shpatet anës së Lugut  
Re të blugjelbërta  
Që turren për në qiell  
Dhe nuk i shkëputen kurrë tokës  
Vejushet e mia të mbetura shkret  
Valltare elegjiake

Ja edhe një nga dritaret e harruara-paharruara ndezur, të “marra” me vete, nga shumë të tilla të Buçpapajt në librin “Imgur”, përkatësisht të shuara atje ku i ka lënë; Lugun..., kësaj here, mbase edhe në vizitë të vërtetë, përroin mespërmes të tij, mbuluar bari i vjetër nga bari i ri që ia fsheh të shtresuarën qiellit; ky ndërsa, qielli i ri, ia fsheh zjarrin mbuluar në hi. Pompeu... një tjetër imazh i gjetur, përflakës, njësoj si dritarja e ndezur dhe dritarja e shuar, ngarkuar si fijet elektrike ngarkuar sinjale telegrafike ngarkuar tensione; i sillet rrotull Lugut poeti, në kërkim të shtresimeve fshehur, Lugut lënë pa admirimin dikur të djaloshit, lënë shkretë, bonjak, rrethuar mbase rritjesh tjetërsuese, të thata, pa e ndjerë praninë e zërit të dikurshëm, mbetur thjesht në mëshirë të vetvetes; pishat në dy anët e Lugut, me mëtim të përjetshëm drejt qiellit, kurrë të mbërritura, valltare elegjiake...; poezi e shkurtër që sjell imazhe të gjalla, mbresëlënëse që të mbesin gjatë në përfytyrim, si në shumicën e vargjeve të librit, plot elegancë dhe bukuri të papërsëritshme.

*Ps.*

*Meqë shkrimin për poezinë e Skënder Buçpapajt po e hedh në kompjuter gjatë ditëve të panairit të librit në Tiranë, 2020, më bëri përshtypje një fenomen gati i shëmtuar: edhe pse të pranishëm me libra, disa nga emrat e përmendura këtu, si edhe disa nga emrat e prozatorëve të shquar të letërsisë kombëtare, juria nuk denjoi asnjërin nga këta! Për bindjen dhe shijen time, ky ishte skandal kulturor; dëshpërim edhe më i madh që mbeti pa reagim adekuat. Nuk, të paktën, nuk u qortua një juri e tillë “kompetente” dhe as shefi i tyre që emëron të tilla juri për të injoruar letërsinë kombëtare, për të cilën, kudo në botë, në radhë të parë atë e kanë si synim të parë, sidomos në panairë librash...*

*Nëntor 2020*



# Postmodernizëm / realizëm: përballje kuptimore - filozofike apo formaliste - estetike?

Nga Floresha Dado

Realizmi ka preokupuar filozofë, teoricienë të arteve, veçanërisht të letërsisë, që në antikitet. Por nuk mund të themi se është arritur në një konkluzion të qëndrueshëm, sepse koncepti i *realizmit* është objekt i mosmarrëveshjeve lidhur me kuptimin, përfshirjen e tij në çdo nivel të teorisë dhe praktikës, të semantikës ose të ontologjisë, madje lidhur edhe me peshën që ka në strukturat e disiplinave që thamë. Kështu, duke pranuar multivalencën e konceptit, është shprehur mendimi se realizmi duhet të diskutohet në sfond interdisiplinar.<sup>1</sup> Kjo qasje ofron mundësi të gjera sidomos për të sqaruar se çfarë përbën një pozicion realist në filozofi dhe sa kjo gjë mund të identifikohet në kontekstin e teorisë letrare.

Por, nëse filozofia ka kontribuar kryesisht në trajtimin e problemit të realizmit në nivel metateorik, teoria e letërsisë dhe e artit janë ndalur vetëm në përkufizimin e realizmit si një problem që i përket fushës së krijimtarisë artistike. Megjithatë, gjatë zhvillimit historik të letërsisë, *koncepti i realizmit* në teorinë letrare nuk ka mbetur brenda sferës së çështjeve që lidhen thjesht me përfaqësimin në art; realizmi perceptohet tashmë si një qëndrim teorik që kundërshtohet nga relativizmi, në mënyrë të veçantë nga kultura postmoderne dhe mënyra poststrukturaliste e të menduarit. Koncepti i realizmit ka krijuar një mosmarrëveshje lidhur me kuptimin e tij, të nënkuptimeve (në çdo nivel të teorisë ose praktikës, të semantikës ose ontologjisë), dhe madje lidhur me vendin e tij në strukturën e përgjithshme të disiplinave të ndryshme. Rast i veçantë janë debatet mbi llojin e konceptit të *realizmit* në filozofi si dhe debatet në studimet letrare mbi realizmin e gjinisë epike (sidomos romanit). Diskutimet vazhdojnë të filozofë dhe teoricienë të artit dhe të letërsisë

1 Ruth Ronen: *Philosophical realism and postmodern antirealism*. Article from: Style: June 22, 1995.

me një intensitet që varion në kohë të ndryshme.

Në filozofi, *realizmi* nënkupton një metaperspektivë mbi marrëdhëniet e shenjave dhe koncepteve mbi realitetin. Kuptimi realist mbështetet në ekzistencën e pavarur nga mendja të botës së objekteve, në besimin tek e vërteta si komunikim mes gjuhës dhe botës, si dhe në bindjen se ka vetëm një përshkrim të vërtetë të botës. Ndërsa në teorinë letrare realizmi i referohet aftësisë së shenjave dhe imazheve për pasqyrimin bindës, të kujdesshëm të realitetit. Duket se kemi dy përdorime të termit me përmbajtje të ngjashme. Por ky koncept i përfaqësuar nga realizmi psikologjik dhe social i shek. XIX, u komplikua nga letërsia moderniste dhe, pas saj, ajo postmoderniste, të cilat sollën tronditjen e parimit realist të krijimit.

Është shtruar një pyetje shumë interesante: a mund të thuhet se letërsia është 'paraqitje e realitetit' kur dihet se vetë realiteti rishfaqet në të përmes krijimeve të imagjinatës?

Maksima e filozofit E. Kant, se "qenia nuk është tregues real", orientoi mendimin teorik në pikëpamjen se në interpretimin e letërsisë *realja* në realitet nuk është pjesë e përmbajtjes reale të vetë letërsisë. Ky koncept merr përmasa të tjera, bëhet veçanërisht i mprehtë në gjykimin e letërsisë postmoderniste.

Në studimin letrar kjo do të sqaronte çështjen se si konceptohen nocionet 'realiteti' dhe 'pasqyrimi' në praktikën e poetikës së postmodernizmit, e parë si kontradiktë me perspektivën realiste. Si kuptohet natyra e pasqyrimit letrar?

Në teorinë letrare koncepti i *realizmit* nuk ka mbetur thjesht në sfondin e çështjeve që lidhen me pasqyrimin në art, sepse me daljen e krijimeve moderniste postmoderniste, është ripercptuar dhe ritheksuar si një qëndrim teorik i kundërt me relativizmin, pra si një e kundërt ndaj kulturës postmoderne dhe mënyrave poststrukturaliste të mendimit.

Kundërvënia është e dykrahshme: realizmi kundër relativizmit dhe moderne/postmoderne kundër realizmit në kuptimin klasik të tij.

Problematikat që kanë lindur rreth marrëdhënies midis *postmodernizmit* dhe pasqyrimit *realist* janë të ndryshme. Studiuesja L. Hutchon, e njohur për interesimin dhe interpretimet në fushën e letërsisë postmoderniste, mbështet pikëpamjen se në artin postmodern historia (brenda veprës letrare: shënimi im) në të vërtetë shihet si intertekst. Historia bëhet tekst, ndërtim diskursiv që tërheq fiksionin, sikurse janë tekstet e letërsisë. Kjo pikëpamje për historinë, në letërsi, është vazhdim logjik i teorisë së Riffaterre-it, sipas të cilit referenca në letërsi është përherë referencë e tekstit në tekst, që nënkupton se historia letrare nuk mund të na orientojë kurrë në botën e vërtetë empirike, përveçse në tekstin tjetër. Fjalët na udhëzojnë jo drejt gjërave, por drejt sistemit të shenjave, të cilat paraqesin "njësitë e gatshme tekstuale". Sipas kësaj pikëpamjeje kjo është mënyra përmes së cilës letërsia nuk e pranon konceptin naiv mbi pasqyrimin. Në pikëpamjen e kësaj teorieneje referenca

postmoderniste dallon nga referenca realiste, sepse afirmon pamundësinë relative të njohjes së asaj të shkruarës, që ka ekzistuar objektivisht edhe para se ne të kemi qenë në dijeni për të. Me këtë qëndrim ajo i afrohet traditës së gjatë filozofike që pohon se realiteti, ndonëse mund të ekzistojë për së jashtmi, është i rregulluar përmes koncepteve dhe kategorive të të kuptuarit tonë njerëzor. Teoricieni tjetër, i marrë gjerësisht me çështjen e postmodernizmit, F. Lyotard, shkruan se gjuha e ka të pamundur të zotërojë realitetin jogjuhësor. Sipas tij gjuha nuk e artikulon kuptimin e botës; ajo e përjashton atë që përpiqet ta zotërojë. Kjo situatë kontroverse na kujton paradoksin e përgjithshëm të diskutit postmodernist, i cili konvencat, brenda të cilave vepron, i përdor dhe i shpërdor në mënyrë ironike, i afirmon dhe i mohon. Interpretime të tilla teorike na krijojnë një qasje jo në sipërfaqen e realizmit, por në kuptimin e brendshëm, filozofik të tij.

## E vërteta një iluzion?

Koncepti i *së vërtetës* është një ndër aspektet themelore që përball postmodernizmin me realizmin. Trillimi postmodernist hedh poshtë nocionin e të vërtetave universale dhe luan me mundësitë e interpretimit, perspektivave shumëplanëshe, pasigurive dhe kontradiktave. Interpretimi që *realiteti* dhe *e vërteta* janë ndërtime më tepër se një entitet ose një thelb, është një nga shqetësimet më të mëdha të romanit postmodernist. Fiksioni i shekullit XIX dëshmonte se realiteti është përgjithësisht një eksperiencë që mund të ndahet midis autorit dhe lexuesit. Modernizmi e sfidoi këtë pikëpamje, duke konfirmuar kalimin nga pasqyrimi objektiv i realitetit në një perspektivë individuale të realitetit. Nga ana e tij fiksioni postmodernist synoi të shkonte më tej, duke pasqyruar një botë ku 'realiteti ose historia janë të përkohshëm: nuk ka një botë të të vërtetave të përjetshme, por një seri ndërtimesh, artificesh, strukturash të përkohshme'.

Fiksioni postmodernist hedh poshtë nocionin e së vërtetës universale dhe luan me mundësitë e interpretimeve, perspektivave shumëplanëshe, pasigurive dhe kontradiktave.

Kështu edhe romani nuk mund të jetë një i tërë koherent, ai zhgënjën lexuesin në pritjet për mbylljen narrative, zbulime paraprake, që realizohen nga narratori i gjithëdijshëm. Ch. Norris pohon se 'Çështja kryesore e narratives postmoderne është të sfidojë, të shkatërrojë, ose, në mënyrë paradoksale, të shfrytëzojë konvencionet në lojë kur ne nxjerrim kuptimin e tekstit. Kështu postmodernizmi sjell një tendencë të fuqishme 'metanarrative', e cila thekson naivitetin e besimit në narracionin e zakonshëm të rendit të parë. Adorno shkruante madje se një 'vepër e madhe moderne është pikërisht ajo që arrin të shfaqë kontradiktën mes dukjes dhe realitetit'. Sipas tij, vepra letrare nuk na jep një reflektim të mirëformuar dhe një njohuri të realitetit, ai thekson largësinë mes veprës dhe realitetit.

Sipas teoricienes L. Hutchon, në një nivel formal, romani mban në tension marrëveshjen midis historisë dhe fiksionit, duke nxjerrë në plan të parë konfliktin midis së vërtetës dhe gënjeshtërs, fakteve dhe bindjeve, të *vërtetës* dhe *iluzionit*.

Sipas N. Krasniqit "...qenia jonë kurrë nuk mund të konsiderohet imitim i realitetit tonë, i një ekzistence në një 'kohë reale'. Por më shumë është një imitim në 'kohën e humbur', ekran, pamje e shpërndarjes së subjektit dhe identitetit të tij... Qenia, e cila është krejtësisht e ndryshme nga besimi, është më shumë rezultat i sfidës ndaj realitetit, rezultat i pranimit të një iluzionit objektiv, e shumë më pak një realitet objektiv... Instinkti më i fuqishëm i njeriut është të jetë në konflikt me mendjen e tij dhe realen."<sup>2</sup>

Pra është e qartë se referenca postmoderniste dallon nga referenca realiste në faktin se afirmon karakterin relativ të çdo realiteti që mund të ekzistojë objektivisht.

Konkluzioni tipik postmodernist është që *e vërteta* universale është e pamundur dhe *relativizmi* është i pashmangshëm. "E vërteta absolute" është përkufizuar si realitet jofleksibël. Por, nëse përfaqësuesit e filozofisë relativiste deklarojnë se nuk ka absolutisht të vërtetë absolute, atëherë është e qartë se ky pohim është gjithashtu po aq absolut. Sipas Morris-it<sup>3</sup> po kaq interesante është edhe pikëpamja që, duke iu referuar shprehjes tjetër: "e vërteta është relative," e quan edhe këtë një pohim absolut. Nëse, sipas teoricienit, do t'i qëndrohej besnik konceptit filozofik të postmodernizmit që i kundërvihet realizmit, atëherë do të duhej të thoshim se ky pohim i fundit, në vetvete, është gjithashtu relativ.

Në të gjitha këto pohime mjaft interesante dhe origjinale mendoj se përballja midis konceptit *realist* të *së vërtetës* dhe kuptimit postmodernist të së vërtetës, shpreh konfliktin e filozofive që përfaqësojnë ato dhe meriton trajtim të veçantë. Koncepti postmodernist, sipas të cilit askush nuk e di nëse e vërteta ekziston dhe se çdo njeri beson që pohimi i tij është

2 Teori dhe kritikë moderne, zgjedhi e përktheu Nysret Krasniqi, Rozafa, Prishtinë, 2008.

3 Pam Morris: *Realism*, the New Critical Idiom, "Routledge", London, 2005.





(*Vijon nga faqja 9*)

i drejtë, por kjo është e pakonfirmuar, hap një fushë shumë interesante në interpretimin e romanit postmodernist, në përballje me romanin realist.

Por, kjo nuk do të thotë se të gjithë teoricienët, pa përjashtim, mbështesin konceptin e relativizmin si triumf ndaj realizmit. Kështu ekziston edhe pikëpamja që e karakterizon *relativizmin* si kontradiktor, anarkik. Filozofi francez M. Foucault synoi të provojë se të menduarit e njerëzve, rreth të vërtetave të përhershme të natyrës dhe shoqërisë njerëzore, ndryshon gjatë rrjedhës së shoqërisë. Studimi i tij mbi konceptin e postmodernizmit mbështetet në kuptimin konvencional të historisë si kronologji e fakteve të paevitueshme dhe zëvendësim i të fshehtave të njohurive të shtypura dhe të pavetëdijshme, *në* dhe *përmes* historisë. Kur flet për postmodernen (postmodernizmin) F. Jameson vë theksin te 'zhdukja e sensit të historisë' në kulturë, te cektësia e kuptimit, te një 'e tashme e paqëndrueshme', në të cilën kujtesa e traditës ka ikur. Siç shohim, na del se analiza postmoderniste është një goditje mbi besueshmërinë në filozofi, narrativen dhe marrëdhëniet e arteve me të vërtetën. Sipas tyre, *e vërteta absolute* në përballje me *realitetin* është një realitet jo fiks e uniform.

Në një intervistë I. Hasan pohonte, se “Tani, nëse E Vërteta ka vdekur, atëherë çdo gjë lejohet – teorikisht. Dhe nëse çdo gjë është arbitrare, e kushtëzuar dhe relative, asgjë nuk është detyruese...” Mendoj se në thelbin e këtij pohimi qëndron pikërisht ajo çka ndodhi në romanin postmodernist (edhe në romanin tonë), ku u përmbysën kritere formale, kur liria e trillimit artistik nuk i nënshtrohet asnjë detyrimi formal.

Por T. Eagleton është kundër thelbit *apokaliptik* që shpreh teoria postmoderniste. Sipas tij postmodernizmi bën gabimin apokaliptik kur beson te vdekja e së vërtetës...

## Marrëdhënia e postmodernizmit me të drejtën dhe të gabuarën

Për postmodernistët nuk ka asnjë rëndësi mendimi se çfarë është e drejtë, e gabuar, false, e mirë apo e keqe, sepse në filozofinë e tyre asnjë nga këto nocione nuk i referohet një të vërtete absolute. Kjo do të thotë, sipas tyre, se askush nuk mund t’u imponojë të tjerëve idenë e tij si moral i drejtë apo i gabuar. Vetëracionalizimi i tyre mbi shoqërinë, botën që na rrethon, shpreh konceptin për relativizëm të moralit.


Sipas konceptit postmodernist nuk ka një realitet koherent dhe të unifikuar. Vepra e R. Qoses, duke u ngritur shpesh mbi paradoksin, transformime radikale, mbi parodinë, fragmentizmin, synon të ndrydhë rrëfimin kryesor, çka, në të vërtetë, i jep theks të veçantë synimeve ideore të romanit. Romani fsheh bindjen e autorit se realiteti i vërtetë vjen përmes vështrimit dhe interpretimit individual; për këtë arsye problemi që nxjerr vepra “*Nata është dita jonë*” lidhet, veç të tjerave, edhe me pyetjen: **kush është në plan të parë: realiteti apo refleksioni i autorit?** Në një kuptim universal mbi natyrën e artit, këto dy aspekte nuk do të ndaheshin.

FLORESHA DADO

## IDENTIFIKIM I POETIKAVE

### NË PLAN TEORIK DHE HISTORIKO-LETRAR

Onufri



Por në romanin e R. Qoses dilemma shfaqet sepse kuptimi mbi realitetin është ndryshe nga letërsia paraardhëse, sepse shpesh fshihen kufijtë midis ëndrrës dhe rrëfimit të reales.

Në vazhdim të kësaj filozofie për Pam Morris-in (vepër e cituar) një postmodernist e sheh botën jashtë vetvetes si një ekzistencë në gabim, do të thotë se një e vërtetë e njerëzve bëhet e padallueshme nga e gabuara. Në këtë kuptim thelbi i postmodernizmit është sfida e sigurisë, shtrimi i pikëpyetjeve mbi kuptimin e figurës, tek e cila ne mund të kemi pranuar një herë ekzistencën e disa “të vërtetave” absolute.

Studiuesi shqiptar A. Saliu i referohet pikëpamjes që pranon qëndrimin pragmatist për të vërtetën, e cila është krejtësisht jashtë skemave tradicionale të trajtimit të saj. Sipas tij identifikimi i filozofisë me të vërtetën dhe të mirën ka qenë presupozim i vetëkuptueshëm i filozofisë tradicionale. Fjala ‘e vërteta’ dhe ‘e mira’ janë të papërcaktuara. E vërtetë është se nuk ka të vërtetë... të gjitha pretendimet e filozofisë për të vërtetën tanimë janë vetënuar dhe janë shndërruar në pengesë serioze për afirmimin e kulturës liberale.<sup>4</sup>

Postmodernistët e kundërshtojnë të *vërtetën absolute* përballë faktit që ekzistojnë shumë kundërpohime mbi dukuri të jetës njerëzore. Meqenëse, siç thamë më parë, teoria e tyre mbështetet në bindjen se ‘nuk ekziston absolutja’, ‘e vërteta është relative’, atëherë edhe në raport *me moralin* nuk ekziston e drejta dhe e gabuara. Atëherë askush nuk ka të drejtë të gjykojë moralin. Koncepti relativist i referohet pikëpamjes se secili mund të besojë çfarë të dojë! Sa e përcjell romani ynë këtë të vërtetë?

## Realizmi dhe Relativizmi

Postmodernizmi është i lidhur me filozofinë relativiste që mbështet idenë se “gjithçka ndodh”, dhe ku braktiset bindja për të vërtetën absolute, përqafohet ideja se njohuria është e varur nga një perspektivë. Pohimi se mesjeta besonte në Zot, kurse Niçja deklaroi se “Zoti ka vdekur”, në njëfarë mënyre sillte idenë se në jetë nuk ka pika fikse të përgjeshme. Kështu filozofët postmodernë kanë pranuar se postmodernistët janë ndjekës të bindjeve të Niçes. Dekonstruktivizmi, që i qëndron pikëpamjes se e vërteta është gjithnjë *relative* ndaj pikëvështrimeve të ndryshme, ka si një nga principet themelore mohimin e mundësisë për përkufizime përfundimtare ose të vërteta. Për dekonstruktivizmin marrëdhënia e gjuhës me realitetin nuk është e dhënë, ose e sigurt, përderisa gjithë sistemet gjuhësore janë ndërtime kulturore jo të sigurta.

Filozofia e Derrida-s dhe e teoricienëve të dekonstruktivizmit ishte kundër teorisë që, për një kohë shumë të gjatë, e kish parë marrëdhënien mes gjuhës dhe botës si të drejtpërdrejtë dhe të besueshme. Ata nuk e kuptojnë gjuhën si pasqyrë të natyrës dhe e quajnë iluzion lidhjen e kuptimit të një fjale me strukturën e realitetit. Përfaqësuesit e dekonstruktivizmit kritikuan besimin naiv në “tekstin realist klasik” dhe mbështetën pikëpamjen sosyriane se të gjitha fjalët duhen shpjeguar vetëm në sistemin e marrëdhënies së tyre me sistemet e ndryshme në të cilat marrin pjesë. Sipas tyre, në çfarëdo që themi, ne jemi të kapur brenda një sistemi gjuhësor që nuk lidhet me realitetin e jashtëm, sepse çdo term brenda çdo sistemi gjithashtu aludon, ose varet nga ekzistenca e termave të tjerë brenda sistemit.

Pyetjes drejtuar Ihab Hasanit: Si mendoni, megjithatë, se “relativizmi” u vu në një rend me “postmodernen”? Mendoni se ka një lidhje logjike mes llojit të artit që ju identifikuat si postmodern dhe një pozicioni radikalisht relativist? – ai i është përgjigjur:

“Teatri, parodia, një imitacion stili (*pastiche*), pluralizmi – produktet bazë të një stili postmodern apo racionales – kanë tendencë drejt relativizmit, ashtu si tendenca për t’u hapur apo pavendosmëria. Filozofitë jothemelore apo pragmatike kanë gjithashtu tendencë drejt relativizmit. Çdo shoqëri hibride, heterogjene, konfliktuale ka tendencë drejt relativizmit. Këto të tria janë pjesë e “kushtit postmodern”. Por vini re ju lutem se unë them “kanë tendencë”: Dyshoj se mund të ushqehet në praktikë një “relativizëm radikal”. Shihet se edhe pohimet e tij kundra së vërtetës absolute, kanë gjithashtu karakter relativ, në koherencë me pikëpamjen e tij filozofike...

## Realiteti në konceptin postmodernist

Qëndrimi i përbashkët që lidh shkrimtarët postmodernistë, pavarësisht dallimeve, është mospranimi i doktrinës së realizmit mbi ‘pasqyrimin objektiv të realitetit social’. Sipas tyre, letërsia krijon iluzionin e *realitetit* vetëm për ta prishur atë. Si pasojë, trillimi postmodernist, në të njëjtën kohë, edhe plotëson, edhe përmbys pritjet e lexuesit. Narratori fshin dallimin midis botës reale dhe botës fiktive.

Teoricieni Bran Nicol theksonte se postmodernizmi i

referohet një shkalle më të lartë të vetëdijes, duke theksuar se eksperiencia jonë mbi *realitetin* ka ndryshuar. Realiteti nuk është më diçka që mund ta marrim për bazë, por diçka që ne dyshojmë. Kjo eksperiencë e ndryshuar mbi ‘realen’ shpreh një tipar të rëndësishëm të qëndrimeve teorike të postmodernizmit, i cili synon ta paraqesë këtë aspekt si dëshminë e një transformimi paradigme në shoqëri, dhe jo thjesht si term të stilit kulturor. Goditja e teorisë sociale postmoderne është teza sipas së cilës të jetosh në postmodernitet do të thotë ta gjesh veten të ndarë nga ato aspekte të jetës që janë parë si autentike, të vërteta, reale. Në postmodernitet ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë të veçantën e vendosjes sonë historike, nuk mund të krijojmë vepra arti origjinale, ne jetojmë dhe punojmë më shumë në një hapësirë ‘virtuale’, sesa në realitet.

Në kontrast me teoricienë si L. Hutcheon dhe U. Eco, veprat e të cilëve janë më liberale rreth eksperiencës sonë të ndryshuar të realitetit në postmodernitet, ka teori postmoderniste, të prira më sociologjikisht, që synojnë të shohin ndarjen nga realja si të rrezikshme ndaj psikikës individuale dhe kolektive. Për këtë arsye, sipas tyre, teoria postmoderniste i kthehet gjuhës së psikopatologjisë – skizofrenisë, histerisë, narcizmit, paranojës etj., për të shpjeguar kuptimin e ri për këtë marrëdhënie. Realiteti nuk është më real, është hiperreal. Praktika formale më karakteristike në trillimin postmodern është njohur si *metafiksion*, trillim që në njëfarë mënyre nxjerr në plan të parë specifikën e këtij ndërtimi trillues, ku metafiksioni është një formë ironike ndaj pranimit të realitetit. Metafiksioni na kujton se vepra është *vetëm* një vepër trilluese, ajo nuk është reale. Bota që portretizohet nuk është bota reale së cilës i ngjan. Efekti i metafiksionit është prishja e dallimit midis *trillimit* dhe *realitetit*, duke thyer iluzionin e realitetit (këtë dukuri e kemi ndjekur në disa prej romaneve të letërsisë sonë postmoderniste...) Por, njëkohësisht ndodh edhe e kundërta: krijimi fiksional zbulon një botë përtej botës reale. Teza të tilla postmoderniste nxjerrin iluzionin e realitetit dhe mjeshtërisë; del në plan të parë marrëdhënia problematike midis jetës, trillimit dhe ekzistencës së realitetit. Romanet e R. Qoses, V. Zhitit, nxjerrin në plan të parë dikotominë midis reales dhe imagjinare, pavarësisht se narratorët nënkuptojnë që bota e trillimit që ndërtojnë, është në thelb rrokje e realiteteve shqiptare... J. Bodriar e kish përkufizimin e tij origjinal që e konsideron realitetin një iluzion... vetë realiteti duhet të mbetet i maskuar dhe ta zgjerojë vetveten si një rreth, pa u kujdesur për vetë konceptin e tij... Është bota e jo realiteti, e cila duhet të mbetet e hapur, por jo si mendim, por vetëm si iluzion... Sepse, sipas tij, realiteti nuk është një fenomen edhe aq i fortë që të rezistojë fuqishëm.

Ekziston edhe një shpjegim interesant, sipas të cilit iluzioni i realitetit në veprën artistike krijon iluzionin e jetës vetëm për ta prishur atë, duke krijuar një situatë paradoksale që i referohet një realiteti jashtë tekstit dhe procesit. Kjo perspektivë kontradiktore është quajtur qasje ‘*double-focus*’, që është karakteristike për vepra postmoderniste.

Teoricienë postmodernistë kanë shprehur bindjen se realizmi i letërsisë së shekullit XIX tashmë nuk është më frytdhënës për pasqyrimin e realitetit bashkëkohor, dhe, sipas tyre, është pikërisht trillimi postmodernist që mund të krijojë formë romaneske për të zbuluar realitete të tjera të mundshme, duke krijuar botë të ndryshme nga bota që ekziston. Trillimi postmodernist synon paraqitjen e një bote ku realiteti ose historia janë të përkohshëm, jo më një botë e të vërtetave të pavdekshme, por një seri ndërtimesh, artificesh, strukturash të paqëndrueshme. Për këtë arsye edhe J. Lyotard e karakterizon trillimin postmodernist si një mohim, ‘mosbesim ndaj metanarratives’. Por Holbrook thekson se diskutimet rreth postmodernizmit janë bërë të debatueshme. Idetë se veprat letrare nuk kanë kuptim, ose që e drejta dhe gabimi moral nuk ekzistojnë, ose që e vërteta është një iluzion, ose që gjithë veprat e artit dhe praktikatat kulturore janë vlera të barabarta, ose nuk ka gjera si realitet etj., paraqiten si të dyshimta.

Realiteti ekziston pavarësisht nga pasqyrimi njerëzor. Nëse kjo është e vërtetë, në kundërshtim me postmodernizmin, ky pohim mbështet ekzistencën e “realitetit të jashtëm të pavarur-mendërisht”, që është quajtur “realizëm metafizik”.

Gjuha komunikon kuptime, por gjithashtu u referohet objekteve dhe situatave në botë që ekzistojnë pavarësisht nga gjuha. Në kundërshtim me postmodernizmin ky postulat mbështet konceptin e gjuhës që ka funksion komunikativ dhe referencial.

\*\*\*

Siç shihet, edhe kur postmodernizmi u bë fakt filozofik e letrar, pikëpamjet ndaj tij kanë mbetur gjithnjë të diskutueshme. Por, ajo që mendoj se është thelbësore, lidhet me :pyetjen që shtrova si titull të këtij trajtimi: kundërvënia midis realizmit dhe postmodernizmit nuk e ka thelbin te aspektet formale-estetike, (si e ndeshim në disa romane të letërsisë sonë në 10 vjeçarët e fundit), por në thelbin e filozovive që përfaqësojnë. Dhe në filozofi njerëzit gjithnjë janë ndarë apo pajtuar me njeri tjetrin.

<sup>4</sup> Astrit Saliu: *Sfida e postfilozofisë*, Revista Teorike Letrare MM, nr. 1, Prishtinë, 2009.



# MBRETËRIA E ËNDRRAVE në vegimet e Ndue Ukajt


Nga Elvi Sidheri  
shkrimtar dhe përkthyes

**T**ë lexosh në ditët e sotme një vazhdë të rrjedhshme tregimesh, doemos përbën pikësëpari një sprovë besnikërie ndaj ëndjes tënde letrare, duke nënkuptuar gjithaq edhe një dëshmi të mëtejshme të përkushtimit tënd si lexues ndaj krijimit letrar si dukuri kulmore e frymëzimit njerëzor...

E fatmirësisht të gjitha këto përsiatje të mësipërme, ngërthehen vetvetiu në përmbledhjen burimore të frymëzimeve tregimore që Ndue Ukaj na ofron përmes Mbretërisë së tij të Ëndrrave, ku pleksen e shpleksen pareshtur pikëtakimet e tij intelektuale, letrare dhe vetjake me universin bashkëkohor shqiptar e atë kosovar në veçanti, të ravijëzuara në suazat e një sërë rrëfimesh që mishërojnë thelbin e stadiit zhvillimor dhe mendësisë aktuale të shoqërisë, kombit dhe shtetit të cilit autori i përket kulturalisht, përveçse gjuhësisht.

Mbretëria e Ëndrrave përvijohet nëpër skutat më kuptimplota që ndryjnë mrekullisht tisin e botëkuptimit të sotëm shqiptar, të sendërtuar nëpërmjet një shumësie personazhesh groteske e guximtare, ngjarjesh rrëqethëse dhe vagëllimesh onirike, fanitjesh të shkuara dhe amullish të tashme, duke shpërfaqur një larmi dehëse pikënisjesh që të shpien drejtpërdrejt në bërthamën e ngurosur ku dergjet vetë shpirti i drobitur i shqiptarit të shekullit XXI, në Kosovë apo tjetërkund.

Janë tregime ku rrëfëhet zhdërvjellët realiteti ynë i prekshëm, qoftë në kuturisjet që depërtojnë në honet e maktheve të një sundimtari anakronik (personazh përherë aktual në viset tona të lashta dhe fort harraqe për shkak të kujtesës së mangët, fatkeqësisht) apo në mëdyshjet mistike të njeriut të pushtetshëm kundruall pasqyrës ku jetësohet mirëfilli gjithçka syri ynë i hutuar ngurron të shikojë çiltërsisht; qoftë në deliret e satrapit që digjet nga marazi prej qesëndisë së vegjëlisë; qoftë



në përshkrimet e kthjellëta të përditshmërisë së zymtë të një kryeqyteti të dalë nga flakët e luftës, ku mugëtitrat jetësore e shoqërojnë këmba-këmbës njeriun krijues në kohë, hapësirë dhe gjallim pandalshëm.

E në këtë realizëm ëndërrimtar të sintetizuar përmes secilit prej këtyre rrëfimeve ekzistenciale ku frymon sakaq gjithsecili që rëndon mbi dheun e këtyre trojeve, pa dyshim duke përfshirë këtu edhe lexuesit që do të kenë fatin të lexojnë dhe të kridhen me zemër e mendje në këto tregime, autori ia ka dalë kryekëput mbanë që vranësirave ciklike që vrenjtin rregullisht qiejt shqiptarë, t'u japë sidoqoftë ngjyrat e penelit të frymëzimit të tij, që duke zhveshur lakuriq mbretër, prijës e pushtetarë mëtues të absolutizmave të tejshkuara, rreket të zgjojë ndërgjegje të dremitura, të çelë sytë e verbuar rishtas dhe t'ia rikthejë ylberin kulturor qytetit, vendit dhe shoqërisë së tij.

Kjo Mbretëri Ëndrrash sjell njëherësh edhe portretizimin besnik të dukurive më karakterizuese të tranzicionit kosovar, ku veçanërisht për lexuesit nga përtej Morinës në Shqipëri, ndriçohen dritëhijet e zhvillimeve që i kanë dhënë trajtat e sotme shoqërisë, kulturës dhe aktualitetit në Kosovë, në çdo aspekt e veçori që kanë ndikuar fuqimisht në këtë këndvështrim.

Gjithashtu këto tregime ofrojnë një mori puqjesh grishëse me tranzicionin shqiptar të tridhjetë viteve të fundit, paçka se vitet e tranzicionit në Kosovë patën rrjedhur në kondita krejt të ndryshme, teksa gjithsesi ndërkaq shpërfaqen ngjashmëri të panumërta me gjithçka të ndodhur në Shqipëri thuajse njëkohësisht, përkundër ndryshimeve jo të pakta në shoqëritë e Kosovës dhe të Shqipërisë, për shkak të ndarjes thuajse shekullore, regjimeve totalitare dhe shtypjes të cilës i qenë nënshtruar përdhunshëm shqiptarët në gjithë hapësirat ballkanike të banuara prej tyre gjatë shumicës së shekullit XX.

Këto vegime që gjejnë jetësim në tregimet që i japin trajta kuptimore të patjetërsueshme kësaj Mbretërie Ëndrrash të mirëfilltë që emërton këtë libër, janë shpeshherë shajnitë tona individuale që ndërfiten tinëzisht në ëndërrimet tona natore, duke na bërë të gjejmë kthjellimin e shumëpritur ku shoshiten shumë nga pikëpyetjet çoroditëse të përditshmërisë tonë sflitëse, e ndoshta edhe disa nga përgjigjet thelbësore do të gjenden në këtë libër.





# ATDHEU ËSHTË I VETËM, SI HOMERI

*Cikël poetik nga Xhelal Tosku*

\*\*\*

trëndafili ka arsyen e tij

gruaja e mori në dorë  
buzeqeshi  
dhe vazhdoi rrugën.

trëndafili ka arsyen e tij  
gruaja ka aromën e saj

\*\*\*

ajo shkonte në dyqan  
dhe blinte për mua trëndafila.

kuptohet: artificialë

unë dilja në kopësht  
dhe për të  
mblidhja trëndafila

kuptohet: natyralë

për dashurinë nuk flet më askush

\*\*\*

rrëzim i gjetheve gjithë në ar  
vetëtimat nëpër qiej dhe shiu  
se çkam një trishtim pyjesh  
tani në vjeshtë

dhe ty nuk të shoh gjëkundi

Ti dhe krijimi i botës

errësira është aq e dendur  
sa që nuk mbaj mend asgjë

kur vjen nata kujtohem çfarë më pret

e gjithë kjo do ishte asgjë  
sikur ti të mos ishe e ëndërrt.

\*\*\*

e di era e detit çfarë bën me detin  
e di deti çfarë bën me shkëmbin e anëdetit  
po kokrriza e rërës e di që origjinën e ka nga  
shkëmbi  
ti që shkon nëpër rërën e lagur të detit  
e di këtë çast kujt për ty  
i dhemb shpirti

\*\*\*

napoletane e vogël  
napoletane e bukur  
cili qiell me shi  
ia shuajti zjarrin  
ndonjëherë  
Vezuvit

\*\*\*

mespërmes mëngjesit

me krizantema të bardha në duar

mos hidhni vështrime  
më kot.

grua si kjo  
nuk do të ketë më.

\*\*\*

mirë dielli  
po yjet

mirë yjet  
po hëna  
pse duhet

pyet udhëtar i ngratë  
dhe rruga zgjatet  
e zgjatet

askush nuk përgjigjet  
askush nuk dëgjon  
sepse është natë

\*\*\*

kur erdha unë  
atdheun tim e kishin vrarë

çfarë mund të bëja

\*\*\*

lulet e bardha të mollës  
kanë kujtime të bukura  
nga hëna

natë natë  
dhe mrekullisht  
hëna është e plotë

si është të vdesësh  
në një kopësht me mollë  
si lulet e mollës  
si është të vdesësh  
në një natë të tillë

\*\*\*

të ikurit janë të shumtë  
atdheu ashtu si Homeri është i vetëm

kënga flet vetëm për Odisenë që u kthye

jemi në një kohë  
ku secili bard  
mund të verbohët  
shumë lehtë

\*\*\*

unë me fytyrën mbështetur në xhamin e dritares

dhe shiu që troket në xhamin e dritares

kështu kemi mbetur në kujtesën e një dimri

\*\*\*

i ngulun në tokë si pemë dimri pa gjethe  
nëse ti nuk vjen

## Mërsina ime

jam rritur në tokë  
ku në asnjë stinë nuk mungojnë  
mersinat e gjelbërta dhe dielli

duke shkuar shumë larg  
kushedi sa herë  
kam rrezikuar të helmoj shpirtin tim.

ti mërsina ime e gjelbërt  
me lulet e vogla e të bardha  
si yj të vegjël nate  
ti mërsina ime e gjelbërt  
me aromën tënde mesdhetare  
si një mister  
më ke ndaluar.

jam rritur në viset e mesdheut  
me diell dhe mërsina

Mërsina është bima e dashurisë, asaj të shenjtës dhe plot pasion. Kjo është arsyeja përse në shumë kultura dhe qytetërime, mërsina është përdorur për të vulosur betimet e dashurisë nëpër dasma. Në shumë vende të ndryshme mërsina simbolizon pjellorinë dhe bukurinë femërore





# NJË MËNYYRË E MIRË PËR TË VDEKUR

*Tregim nga Istref Haxhillari*

- Mezi të njoha, - thirri me zë buçitës, si goditje tam-buri.

Sytë e prushtë, shtati masiv, siguria në vetvete kishin hir të zhurmshëm.

- S'ke ndryshuar fare! - i tha Zamira.

Dy paralele pas Loranit në shkollën e mesme të gjuhës frënge, ruante hijet e miqësisë së dikurshme që nuk shkoi më shumë se aq.

- Kurse ti qenke bërë më e bukur.

- Ç'ka ndodhur me ty? - u orvat të zhbironte njëzet vite.

- Kam jetuar, - u përgjigj me ton tjetër lloj.

I dhuroi një buzëqeshje të vogël, para se të linte kujtimet të rridhnin.

- Quhet dashuri edhe të lësh dikë të ikë. Shtatë vjet martesë u mbajt mbi një fije, - u rrëfye kokulur, të mos i shihte pikëllimin që e rrëmbente sa herë e sillte rasti të përmendte familjen e humbur.

Brenga i dha ngjyrën e dhimbjes takimit.

- Ke radhën, - i tha.

Zamira fshehu fytyrën me duar, zakon i mbetur nga vitet e shkollës.

- I kam braktisur fjalitë e gjata, - kërkoi të fitonte kohë.

- Ç'do të thuash?

- Flas shkurt.

- Gjithsesi po vonohesh...!

- Jam beqare, - i tha sa fundi.

Nuk pati jetën që shpresoi, por ishte jeta e saj, donte ta respektonin.

Lorani i futi krahun.

Bari i kushtueshëm në qendër të qytetit ishte fantastik. Zunë tavolinën e cepit pas dritares me sytë mbi njëri-tjetrin. Pas xhamave akujt vishnin trungjet e pemëve, degët e ngarkuara me borë të ngrirë rrezatonin ngjyrat e ylberit. Brenda bënte nxehtë. Zamira hoqi trikon, e palosi mbi mbështetësen e kolltukut.

- Miku i radhës, - u dëgjua një zë i shëmtuar pas tyre. Qëllimisht i lartë.

Lorani lëvizi vendit, ajo i vuri dorën në sup...

Takimi tjetër erdhi shpejt.

- Dua të them diçka, - i telefonoi Lorani.

Pranoi me zemër të thyer. Mëshirën s'e donte. Shkoi vetëm t'ia thoshte.

Nuk arriti.

- Dua të fejohe mi, nëse më pranon kështu siç jam, - i propozoi pa ulur, - takimi me ty ishte ai që më mungonte.

Përgjigja humbi para se ta kapte, gjuha e lirë përkëdheli heshtas emrin e tij.

- Do dalim për kafe?

Nuk i mbajti dot lotët.

- Që ç'ke me të dhe do t'i thyej turinjtë kujt do që guxon.

Trup vigani, krahë muskulorë! Thua mjaftonin? Nuk do të lodhej nga jeta me një...? S'guxoi të shkonte më tej.

- I vetmi premtim, - tha Lorani, - për të tjerë s'ke nevojë...

Makina la rrugën kryesore, rrëshqiti në drejtim të njollave ndriçuese mes parcelës së pemëve lakurique. Kohë pas kohe perde të pluhurosura bore pengonin lëvizjen. Strukur në ndenjësën e parë, Zamira ndjente jakën e ngritur t'i bëhej përqafim.

Parkuan larg vilës së vetmuar. Rrugicën e kall-drëmtë e bënë në këmbë. Flokët e plogëta të borës ua

gjenin qepallat, u vishnin shikimin, rrëzoheshin dhe ngriheshin të përqafuar.

Tavolina e kuzhinës shtruar për festë, lule, qirinj. Mbi abazhurët vesonin leskra të imëta prej flakëve të zjarrit në oxhak. Lorani ra në gjunjë, nxori nga xhepi unazën e artë me gur diamanti blu. Ajo ngriu me sy përdhe. Jo se nuk e donte atë fejesë. E shkuara mund të gjente rrugë të tërthorta të shkatërronte në fare pak kohë. A do ta përballonte një dramë tjetër? Kapi bebëzat e tij të çelura dhe zemra ndërroi marsh, imagjinata, i vetmi armik i pranishëm, u dorëzua. Nuk ishte aq e keqe sa mendonte. Të paktën një herë në jetë donte të ishte gruaja e një burri.

- Sa e kam pritur këtë çast! - i shpëtoi pa dashur.

Puthja erdhi e ëmbël, e ngrohtë, marramendëse, ashtu si duhej të ishte. Prekja e tronditi si shok elektrik, trupi i etur u përgjigj i tendosur.

*Zot, ç'ditë!*

- A mund të presësh pak? - iu lut.

- Do të gri! - i tha ai.

Frymëmarrja iu pengua, u shkëput të mbushej me ajër.

- E besoj...



Banja e priti të dehur, kraharori po i çahej. E shijonte çastin, si t'i ikte dhe ajo të mos e kapte dot. Provoi të kuqin rozë. Iu duk i shpëlarë, e zëvendësoi me të ndezur. Ndërroi të brendshmet, këmishën, veshi fustanin lela, të hapur, seksi. I shkrepiti të këpuste ca trëndafila kundërmues nga buqeta. I shkoliti, shpërndau fletët nëpër trup. Deshi të shikohej sërish në pasqyrë, po ikën dritat.

*"E de, mirë je, mjaft u vonove!"*

Lagja u zhyt në errësirë, era e akullt fishkëllente, xhamat e ngrirë blloktonin shikimin, brenda ngrohtë, qirinjtë e festës ndriçonin të patrazuar.

- Erdha, zemër, - thirri te pragu.

Ishte kaq e mbushur!

U habit kur e pa të flinte mbi divan. Gërhiste lehtë, sa mezi dëgjohej. Dhoma lahej në dritën e zjarrit, fytyra e tij herë ndriçohej, herë fshihej në errësirë. Nënqeshja e ëmbël, e palëvizshme e tregonte të lumtur. E shtyu pak e nga pak zgjimin, u kujdes të mos bënte zhurmë.

Pastaj u tremb.

- Ngrehu, gjumash, për se më ke thirrur! - nuk duroi gjatë.

I preku lehtë ballin, e shkundi ngadalë, më fort. Nuk lëvizi, as dha shenja zgjimi. Gjendje të fikëti, apo...

Zemra i thoshte se vuante nga ndonjë sëmundje e panjohur.

Rrëmbeu celularin, u ra numrave me radhë. Dilnin fikur ose të paarritshëm. Hodhi aparatën, rrëmbeu pultin e portës. Sistemi nuk funksiononte pa energji elektrike. Tërhoqi dorezën, as bëhej fjalë, kanati i blinduar nuk donte t'ia dinte.

U kujtua të merrte ambulancën.

- Dikush po vdes, - u tha, - ejani sa më shpejt.

- Ku të vijmë, zonjë? - u përgjigj një zë i përgjumur.

Hera e parë që shkelte aty, s'e kishte idenë ku ndodhej. U vonua të sajonte vendndodhjen, telefoni u mbyll. Iu kthye numrave nga e para.

Dikur kapi sinjal.

- Lor, këtëj nga ne është kulmi i punës, - u përgjigj një zë i largët, - si e ke hallin?

- Është sëmurë, - i tha.

- Doktor nga Amerika kërkoni?

- Në djall!

Vuri duart në kokë, ia krisi të qarit.

Koha ikte me shpejtësi, e mblodhi veten, hapi dritaren, mori frymë thellë të gjente zërin e humbur.

- Ndihmë, Lorani po vdes, - bërtiti sa munda.

Nga shtëpia përballë doli një burrë i shkurtër me xhup dhe kokore sharrëxhinjsh. Në duar vërtiste elektrikun me bateri.

- Cila je ti? - i lëshoi konin e dritës.

U rrek të gjente përgjigje të besueshme.

- Nusja, - thirri së fundi.

- Ç'nuse moj, Lorani është beqar, - u kthye mbrapsht i inatosur.

Shaka bajate!

- Sapo u fejuam, - u mundua ta zbuste.

Ai pothuaj s'e dëgjoi. Mbase nuk donte.

- Lodër e bukur! - zëri i ngjirur kumboi në errësirë si ogur i zi.

Qindra pandehma e sulmuan, sa mundahej të kapte njërin, i ikte tjetra. Truri nuk i bindej, idetë i shteruan.

Zjarri i pa ushqyer vdiste ngadalë...

Rryma elektrike erdhi në të aguar. Kërkoi pultin, hapi portën. Nuk e pa kanatit të mbyllef vetiu pas saj. Qyteti i ngrirë rënkonte nga fshikujt e erës, masa të ngjeshura, të bardha rrëshqisnin çative, mbushnin oborret. Fustani i tejdukshëm i futi ngricën në çdo pore, u desh fare pak të mpihej. Lëvizi disa herë dorezën, porta nuk hapej. Vështrimin ia veshi një si perde e padepërtueshme, buzët iu nxinë, këmbët nuk donin të bindeshin.

Iu dorëzua mjerimit të vet...

U zgjua në spital me fytyrën zjarr, fytyrën e nxehtë e të ashpër, frymëmarrje të mpakur. Sytë e kapitur kapën aparatën e serumit, krahët zbuluar, tubat plastikë, shiringat. Një objekt masiv që i zinte pamjen, dalëngadalë u bë plakë e bëshme, shumë e vjetër. Priti ta sqaronte dikush, t'i thoshte çfarë kishte ndodhur, po asgjë nuk pipërinte.

As e ëma e Loranit, ngrirë gur varri mbi krye.



# ET YD

## Tregim nga Fatmir Mborja

K ishte një copë herë që rrinim në verandën e mbuluar të hotelit, e cila gjatë verës përdorej si birrari dhe gumëzhinte nga pushuesit, ndërsa tani, në ditët e fundit të marsit, kur sezoni i plazhit dukej akoma mjaft larg, ishte krejt e lënë pas dore dhe veç ne të dyve, nuk kishte njeri.

Ishte hoteli më i vjetër i plazhit, i vogël e fare i lirë, që edhe pse pa ndonjë komoditet, na pëlqeu e na u duk i përshtatshëm, mjafton të ishim më vete, pa të huaj nëpër këmbë e të ndiheshim lirshëm, si në shtëpi. Patëm ardhur i gjithë grupi që të pardjeshmen për një ekskursion katër ditor, përpara se të shpërndaheshim për praktikën e fundit, por si të na e bënte me kast, shiu që nuk kishte ndërmend të pushonte, na mbylli brenda. Kështu, që pjesën më të madhe të kohës, e kalonim nëpër dhoma me muhabetë e shaka, apo duke luajtur me letra, herë kupat, herë xhol më pesëdhjetë qindarka të djegurën, kur në lojë hynin vajzat dhe bëheshim shumë. Ndërsa mbrëmjeve vallëzonim nën tingujt e një gramafoni të stërlashtë, nga ata me të kurdisur, të cilin, nga dëshira për të na kënaqur me sa mundej, na e solli nga shtëpia e tij përgjegjësi i hotelit. Pllaka ishin pak, diçka më tepër se një duzinë, ca tango e fokstrote, po aq të vjetra sa gramafoni dhe që duheshin ndërruar orë e çast. Por asnjë nga këto nuk përbënte shqetësim, se meloditë qenë të mrekullueshme, kurse ata që i ndërronin, i jepnin jetë më tepër asaj relikeje familjare, sidomos, kur njëra nga vajzat shpiku “dënimin për shkeljen e këmbës”. Qe një propozim që u pranua njëzëri nga të gjithë e që u kthye në një argëtim më vete, sipas të cilit dënoheshe me tri ndërrime pllakash nëse partnerja ankohej për shkeljen e këmbës gjatë vallëzimit, që për shkak të ngushtësisë së vendit, mund të ndodhte rëndom po të mos tregoheshë vazhdimisht i vëmendshëm. Kështu shpesh, pranë gramafonit bëheshin disa të dënuar njëherësh, ndërmjet të cilëve, kuptohet, një pjesë qenë viktimë.

Kishte dhe nga ata që ngrinin zërin e protestonin, por nuk fitonin asgjë. Prandaj, që të shpëtoje vetëm me valën e parë të të qeshurave, ishte më mirë të mbyllje gojën e mos ndiheshë. Ndryshe, veç dënimit, duhej të duroje dhe romuzet e atyre që mezi prisnin rastin, duke harruar se, pas pak, mund të binin edhe vetë viktimë e po ashtu, të bëheshin objekt humorit për të tjerët. Të gjitha këto e ndiznin akoma më tepër atmosferën gazmore dhe ne vallëzonim deri vonë pasmesnate, nën tingujt melodiozë të atyre tangove e fokstroteve që përsëriteshin e përsëriteshin pa pushim, sa i mësuaam përmendësh, aq sa edhe sot, ndonëse që atëherë kanë kaluar shumë vite. Jo rrallë e zë veten duke i kënduar ato nën zë.

\*\*\*

Ishim ulur që të dy me vështrim nga deti. Ajo kishte përpara një krikëll birre paksa të nisur, kurse unë një dopio fënet, përzierë me aranaxhatë në një gotë uji, nga e cila, më shumë se gjysmën, e kisha pirë me një frymë që në banak. Të mbrëmshmen kishim vallëzuar shumë herë së bashku, por, deri në çastin kur m'u tek të bëja atë provën idiote duke i shkelur këmbën, s'kishim shkëmbyer veç fare pak fjalë. Ajo dukej e trishtuar dhe m'u kujtua se, po kështu, e trishtuar më ishte dukur kur po vinim, e për këtë ishim ulur pranë dritares. Ndërsa pas mbërritjes, që kur u shpërndamë nëpër dhoma, s'ma kishte zënë syri gjëkund. Mirëpo, ja! Po e shihja përsëri. Nuk e di ç'më shtyu ta bëja atë provë, por nga që nuk e llogarita mirë, duket e shkela më shumë nga ç'desha. Ajo lëshoi një klithmë të lehtë dhe i pashë fytyrën t'i rrudhej nga dhimbja. Kjo zgjati fare pak dhe, si t'i vinte rëndë për atë çast dobësie e të donte të shfajësohej, më buzëqeshi e tha:

-O, sa më vrave!

-Nuk po më denoncon? – e pyeta unë atëherë duke e vështruar ngultas në sy.

-Jo. Po qe se je i mërzhitur me mua... – tha ajo dhe, ndonëse vazhdonte të buzëqeshë, kuptohej që s'e kishte me shaka. Megjithatë, unë bëra sikur nuk e kuptova dhe duke i treguar me kokë të dënuarit që rrinin grumbull pranë gramafonit, i kujtova se, sido që të qe, rregulli i vendosur duhej respektuar. Por ajo mblodhi supet dhe m'u përgjigj se rregullat sajoheshin pikërisht për t'u shkelur, ndryshe nuk do të kishte kaq shumë e për çdo gjë. Ishte një përgjigje disi e papritur, megjithatë, duke bërë një lojë fjalësh, ia ktheva se sipas saj, rregullat shkeleshin ngaqë qenë shumë e, meqë qenë shumë, mund t'i shkelje si të doje. Ajo tha se ishte tamam kështu, se kishte ca si shumë edhe rregulla, edhe norma gjithfarë, sa që qe e pamundur mos t'i shkelje. Madje, ato sikur të nxitnin vetë t'i shkelje, si puna e atyre tabelave që fillojnë me “Ndalohej” apo “Mos” vendosur vend e pa vend, enkas si për të të kujtuar se duhet bërë e kundërta. Ndaj kur i shkel ndjen vërtet kënaqësi. E tërë kjo për mua ishte tejet e re, madje befasuese, sepse qenë dashur të kalonin katër vjet që ta dëgjoja të fliste kaq shumë e të shprehej kështu, në kundërshtim të plotë me natyrën e saj aq të heshtur e të ndrojtur dhe nuk mund ta quaja ndryshe, veç një shpërthim edhe pse nuk e kuptoja ç'donte të thoshte e gjithë kjo. Njëri nga çiftet që vallëzonin ngjitur më shtyu padashur nga pas dhe unë i shkela prapë këmbën e në të njëjtën kohë u gjenda i puthitur pas trupit të saj, duke ndërë në trupin tim tërë ngrohtësinë dhe format e tij dhe pa vetëdije e shtrëngova fort për beli. Ajo nuk kundërshtoi dhe nuk bëri asnjë lëvizje për të më shmangur. “Dy në dorë” tha pastaj me atë buzëqeshjen që ia mbushte fytyrën gjithë dritë dhe unë mendova se edhe pa atë buzëqeshje, ajo ishte mjaft simpatike, vetëm se këtë nuk e kisha vënë re më parë, mbase ngaqë nuk i kisha kushtuar asnjëherë vëmendje.

Dhe ti prapë nuk do të më denoncosh? – e pyeta unë, ndërsa vazhdoja ta mbaja të shtrënguar pas vetes.

Kuptohet që jo, – tha ajo dhe duke mbështetur kokën mbi supin tim shtoi: “Kur hyn në rrugën e krimit nuk ka më kthim prapa.”

Pastaj zuri të shoqëronte nën zë melodinë e tangos që po vallëzonim. Ndjeva ngrohtësinë e frymës së saj të më prekte qafën dhe faqen. Papritur, pata ndjesinë dehëse të lumturisë që vjen e të futet deri në palcë e të ngre lart



në ca qiej të panjohur dhe s'mund ta kuptoja kurrësi si qe e mundur që, duke e pasur aq pranë, ishte dashur të kalonin gjithë ato vite gjer të vinte kjo mbrëmje ta zbuloja. Si të kisha frikë mos më ikte, e shtrëngova akoma më fort pas vetes dhe s'di si arrita të përmbahem te mos e lëshoja kokën drejt kokës së saj, drejt atyre syve të pulitur që më vështronin si nëpër ëndërr, drejt asaj goje gjysmë të hapur me buzët që regëtinin.

\*\*\*

Kur u zgjova në mëngjes, nuk isha fare në formë. Magjia e një mbrëmjeje më parë ishte prishur, aq sa tani më dukej e largët, e largët, si t'i takonte një kohe tjetër, një bote tjetër, dikujt tjetër. Ishte prishur një herë e mirë dhe qe e pamundur të rikrijohej. Nga tërë ajo gjendje shpirtërore s'kishte mbetur asgjë, veç ca rrënojave dhe ndjenjës brejtëse të fajit. Isha nisur pa asnjë paramendim, thjesht për të bërë një shaka, për ta sjellë pak në humor, nga që dukej e trishtuar. As që mund ta merrja me mend ç'ndiente ajo. Ndërsa, kur e kisha kuptuar, kishte qenë tepër vonë. Nuk varej më prej meje asgjë. Gjithçka ndodhte jashtë vullnetit, si një rrjedhë që s'mund të ndalej. Ç'më kishte dehur ashtu? Mirë që nuk isha shtyrë më tej pas puthjes së ndarjes.

U veshja dhe zbrita poshtë me dëshirën për të pirë. Tavolina, të cilën ma nxori bufetieri, me njëren këmbë më të shkurtër, lëkundej bezdisshëm sa herë që rëndoja mbi të dhe fëneti zinte e kërcente faqeve të gotës, si një kafshëz e zënë në çark. Po gota qe e madhe, gotë uji dhe nuk arrinte të derdhej asnjë pikë.

Pas një ndërprerje të shkurtër, shiu ia kishte nisur shtruar e me nge. Retë shtyheshin e ngjiteshin pas njëra tjetrës, të rënda e nursëze. Deti kishte marrë një ngjyrë të errët, gati të zezë, si asfalt, mbi sipërfaqen e të cilit, si tufa patash të trembura, vraponin varg krahët e bardhë të valëve që vinin nga thellësia e shuheshin mbi ranishte me një ofshamë të mbytur.

Ajo kishte ardhur e më qe afruar pa e ndierë, aq sa e vura re vetëm kur më qëndroi pranë, ashtu e ndrojtur dhe e heshtur si përherë. Ndonëse më pëlqente të rrija vetëm, i thashë të ulej e s'di përse i propozova një krikëll birrë. Vajta e mora vetë e ia vura përpara, edhe pse ajo nguli këmbë se nuk donte asgjë. Birra qe e freskët, mbuluar me një kapuç shkume të lehtë e poroze që zhuzhiste. Ajo, duke u përpjekur të më buzëqeshë, e kapi me të dy duart e, pasi i fryu për t'i larguar shkumën nga ana ku do pinte, piu fare pak, dy a tri gllënjka dhe e lëshoi prapë mbi tavolinë. Nuk piu më.

Diçka po thoshte, po s'e kisha mendjen fare atje. I dëgjoja vetëm zërin. Edhe ai, sikur s'ishte tamam zëri i saj, sikur vinte prej së largu, përzier me shushurimën e shiut mbi mbulesën e verandës, me ofshamën e valëve që lëshoheshin e treteshin atje mbi breg e që ashtu, pleksur, më kalonin nëpër vetëdije pa lënë asnjë gjurmë. Po magjia e së mbrëmshmes ishte prishur njëherë e mirë dhe ishte e pamundur të rikrijohej. Madje qe e kotë të përpiqeshë. Tani në dritën e ditës gjithçka kish ndërruar, kishte marrë pamje tjetër dhe ajo që kish ndodhur i ngjante një lajthitjeje a një keqkuptimi, sado që ndjeja keqardhje.

Edhe tani më dukej po aq simpatike dhe prapë më vinte çudi se si s'e kisha vënë re që më parë. E megjithatë përsëri nuk ndjeja asgjë më tepër nga ç'kisha ndërë dikur. Ç'do të ndjeja për një tjetër nëse do të rrinte ulur tani pranë meje?! Ndoshta do të kisha dëshirë të bëja dashuri, kurse me këtë nuk e kisha as këtë dëshirë. Jo se s'më pëlqente si femër, por ja që s'mundja...

Piva dy-tri gllënjka fënet dhe ndeza një cigare. Ranishta e gjerë nxinte e zyrtë dhe e shkretë deri tej, si një brez i vjetër e i rreshkur lëkure, shtrirë me zor përgjatë radhës së vilave boshe me pamjen e pikëlluar e të braktisur, si dekor i çngjyrosur i një pjese gazmore të luajtur kohë më parë e të harruar. Tutje, më të djathtë, shquhej një cep i portit, veshur nga një tis i hollë mjegulle: ca krahë vinçash, ca çati, ca direktë dhe akoma më tutje, fare në skaj, fari i gurtë si hiri i pa shkundur i një cigareje, ndërsa përballë, anijet që qëndronin në radë. Të vogla e të pa lëvizura nga largësia, ngjanin si të prera në letër e sepse më sillnin ndërmend dhe atë librin e aritmetikës të klasës së parë, mbushur plot me figura lloj-lloj.

Befas, ajo pushoi së foluri dhe u bë qetësi. Tek ktheva kokën, hasa vështrimin e saj të ndrojtur e pritës. U mata ta



pyesja çfarë kishte thënë, po ato anijet qëkurse kishin dalë nga libri i aritmetikës dhe uji që tërhiqej gjatë gjithë vijës së bregut, duke e bërë ranishtën më të gjerë, më shtinë në mend diçka tjetër, diçka më të volitshme se një bisedë që do të qe krejt pa kuptim dhe në vend ta pyesja çfarë kishte thënë, e pyeta:

- A të të them një gjë e gjëzë?

Ajo mbeti si e ngrirë. Natyrisht që priste tjetër gjë. Diçka që kishte të bënte me ne të dy, çfarëdo që të ishte, sepse asnjëherë s'mund të jesh plotësisht i sigurtë. Aq më tepër pas asaj që kishte ndodhur natën e shkuar. Edhe në s'kishte qenë një premtim, një lloj marrëveshje sidoqoftë kishte qenë dhe të jepje të drejtën të shpresojë. Qoftë edhe fare pak, po gjithsesi të shpresojë...

- Hë! – këmbëngula unë – ta them apo jo?

Sytë e saj kishin mbetur mbërthyer mbi mua pa asnjë shprehje dhe unë vura re si filluan të njomeshin e të humbitnin diku thellë, sikur po mbyteshin në një det të tërë trishtimi.

- Si të duash. – tha ajo më në fund me një fije zëri, duke e hequr vështrimin nga unë, dhe me një lëvizje të plogët, largoi flokët që i kishin shkarë mbi faqe.

- Po s'deshe, nuk e them.

- Jo. Thuaje! Përse të të mbetet merak?

- Merak? E përse të më mbetet merak?

- Nuk e di. Megjithatë, po ke për ta thënë thuaje.

- Mirë atëherë, dëgjo. Nga anija është lëshuar një shkallë që ka katër këmbë,... secila 50 centimetra larg njëra tjetrës, ndërsa e fundit është rrafsh me sipërfaqen e detit. Ndërkohë fillon batica, që ngrihet me shpejtësi po 50 centimetra në orë. A e gjen dot sa kohë duhet që niveli i ujit të arrijë këmbën e sipërme të shkallës?

- Sa këmbë ka shkalla?

- Katër.

- Dhe e fundit është rrafsh me sipërfaqen e detit?

- Rrafsh me sipërfaqen e detit.

- Kurse batica ngrihet me shpejtësi 50 centimetra në orë?

- Po. Dhe këmbët e shkallës janë po ashtu 50 centimetra larg njëra-tjetrës...

Ajo filloi të mendohej. E kishte mbledhur veten disi dhe përpiquej të tregojë e interesuar, Sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Në një rast tjetër do të kisha qeshur me gjithë shpirt. Ishte fare e pazonja të shtirej. E kisha vënë re edhe herë të tjera më parë. Tamam si një fëmijë akoma e parrahur nga jeta...

- Hë, e gjete?

- Tri orë – tha ajo dhe më vështroi.

- A je e sigurtë?

- Po. – largoi prapë flokët që i kishin shkarë mbi faqe dhe u përpoq të buzëqeshte.

- Shkalla ka katër këmbë, - ia nisi me gjallëri të shtirur, por zëri që dridhej e tradhtonte – domethënë, tri hapësira nga 50 centimetra secila që bëjnë 150 centimetra? E meqë zbatica ngrihet po 50 centimetra në orë, niveli i ujit do të arrijë këmbën e sipërme pas tri orësh.

Heshti pak çaste dhe mori frymë e lehtësuar, sikur nga ajo përgjigje të varej gjithçka.

- A nuk është kështu?

- Të lumtë! – ia ktheva dhe rraha shuplakat. – Je me të vërtetë vajzë e zgjuar. Sipas kësaj mendjes tënde të ndritur të tëra anijet e botës duhet të qenë mbytur me kohë. Po, për fat të mirë, diçka e tillë as ka ndodhur ndonjëherë. Dhe e di përse? Për faktin e thjeshtë se bashkë me baticën ngrihen dhe të gjitha objektet lundruese, kështu që niveli i ujit nuk ka për të arritur kurrë asnjë prej këmbëve të shkallës, edhe sikur ti të rrish e të presësh në breg të detit gjersa të plakesh.

Ajo kafshoi buzën. Mbi mollëza u bë e bardhë, e bardhë si letër dhe tiparet e fytyrës i mbetën si të ngrira nga ngërçi.

Rrinte e më vështronte pa bërë asnjë lëvizje me ata sytë e mëdhenj që shkëlqenin nga lotët, sikur donte të pyeste: “Përse, përse?” Pastaj u ngrit ngadalë, duke u mbështetur pas tavolinës dhe pa kthyer kokën prapa, shkoi drejt hyrjes së hotelit.

Papritur, diçka e brendshme më shtyu me forcë të ngrihesha dhe unë, ta arrija, t'i merrja duart në të miat, t'i kërkoja falje, të shpjegohesha. Po as u ngrita dhe as i thirra të kthehej. Nuk do të kishte kuptim. Më mirë kështu, thashë me vete. Më mirë pa iluzione...

Pas një ore rrija ulur në vagonin e trenit, i qullur e i mardhur, ndërsa në shpirt më rëndonte ndjenja e fajit...

# VYSHKUN VJESHTE

*Cikël poetik nga Sokol Sylejmani*

## UMBILICUS

Nanë, secilën nyjë  
Jetës merrja e lidhja nyjë  
E vegzë 'em vegzë, falma  
Vetën tande; merre, shtro,  
Përqafo shumë; jepi gji;  
Lidhe ndjep - shtine ngjumë...  
Rritën tande!

## SOT (118:24, Psalmet)

As buka s'e pat t'njejtën shije  
sot. As untija, lakminë e njejtë; as na  
'dy – të njejtën hije... rrotat përpara shtyejm  
Në jetë – rrotat kohën mbajnë  
Zhdjergun në ije.

## DRENI 'PLAGUEM

Si fjolla e borës që  
Ban yrysh m'u shkri si ta prekin – pa kuptu se  
A po e dojnë a p'e lodrojnë; qashtu njejtë,  
Yrysh me ikë prej deke, përpjeket n'ujk  
Dreni 'plaguem.

## KUR FRYEN JUGU

Kur bora shkrinë  
Ti mbetesh  
E strukun ndër plepin e zi  
Që mbanë mbi duert e veta  
Çerdhet e qyqeve.  
Diftoju erës së Jugut  
Ashtu çysh je  
E ambël dhe e bukur  
Tue u shkri në pikë uji  
Ndër buzën e  
Thamun prej fjalëve  
Të shumta, po që s'thonë asgja  
Nanë.  
E ambël dhe e bukur  
E shkrime në mu.

## DIELLI

Kur Hanës i zditë sall gjysa e  
Ftyrës së saj... ti i avitesh tuj e qetësue.  
I difton për Diellin.

## VYSHKUN VJESHTE

### (Prelude)

Ke nisë me u vyshkë  
Si gjeth i dërrmuem martese,  
Që kotet kryeulun në cep të degës së  
Vjeshtës që e lam pas vjetëve të qenit,  
Që na randojnë shpatullave e lehin  
Tejsa t'biem, gërmaz' shkyem, dekun n'tokë.

### (akt I)

Ke nisë me u vyshkë bashkë me ndjenjën e epshin  
Që kqyrin përmallshëm, lidhun për gardhi  
t'gabuem  
E lakmojnë si fmija që sheh n'sahan t'tjetrit e  
lëpihet,  
Se për veti i 'get se ka ma pak. E s'un nxjerrë za  
me diftue,  
Se marre.

### (akt II)

Ke nisë me u vyshkë, bashkë me trungun, me u  
kalbë  
Si pema e kajsisë n'oborr t'miqëve që  
U dasht m'e u pre se  
Krejt hijeshinë i'a merrke fikut.

### (akt III)

Kem' nisë me u vyshkë,  
Si gjethe t'dërrmueme vjeshte,  
Të lodhun jemi te dyt. Kryeulun në cep te jetës që  
E hap zgorin' e bërtet, tejsa t'biem dekun n'tokë.

## NINULLË

Kur fmija t'kanë n'zemër  
Zoti asht tuj t'knue në vesh, me t'diftue se  
Ka me çelë sabahi.





# MISTERET E BERATIT

*Etyde nga Xhevair Lleshi*

«Jeta është historia që thonë për ty, jo ajo që tregon ti...» *John Green*

## 1

Basti ynë u vendos në çastin e fundit. Ai që do të mundej do ta pësonte duke pirë një shishe verë plus! Po, nga vera e kantinës *Riko* në Goricë, pasi Landi ka edhe verën më të vjetër, sido që Zoi Kumati, që tani rri i degdisur andej nga Lioni e Parisi, e sjell ndërmend (vetëm kaq) por jo se merret me verërat. Me mikun tim piktor u takuan në *Rogner*, pimë një kafë dhe unë ia kujtova që për të parë një qytet të rrallë nuk mjaftojnë edhe javë të tëra. E pranoi sfidën dhe ne do të niseshim një mëngjes me shumë diell e dritë të vesuar prilli. Makina dhe shoferi ishin gati. Ne do të rrinim të dy pas, me shpresën se nuk do të ngopeshim duke folur rreth asaj që na priste. Por, miku im piktor, s'ma vari, vuri kufjet dhe më tha se kishte përgatitur sipas mënyrës së tij njëqind fraza në anglisht, të deklamuar nga aktorë të vërtetë anglezë me një diksion dhe ritmikë të përsosur, kështu, me të mbërritur në Berat, do t'm'i thoshte tëk e tëk e tëk pa bërë asnjë gabim. Ai u krodh në anglishten e përcaktuar si detyrim personal, ndërkaq mua më duhej të vizatoja mirë me mend planin e vizitës. Ku do të ngecte si miza në mjaltë, që sigurisht s'e kishte të parën herë që vinte në Berat? Eh, në të vërtetë do doja që këtë vizitë me bast ta bëja me Roland Gjozen dhe t'i hipja me të kalit të «përrallës», e t'i tregoja ato që as mëma e tij s'ia ka treguar ndonjëherë. Për mua ka qenë gjithnjë mundësi dhe një marifet i vogël të mësoja pikat më të nxehta e të padukshme të këtij qyteti që u bë imi falë këmbënguljes, dëshirës dhe dashurisë...

## 2

I pari që m'i futi fitat ka qenë **Todi Sotira**, mjeshtri i muzeut, ciceroni i famshëm që në rininë time të parë. Dhe, nuk kishte si Todi ynë! Dinte të mbërthente zjarrin me dorë dhe ta mbante shpuzën e rrëfimit ndezur gjithë kohën. Është e tepërt të them se xha Todi vdiq ndanë një sokaku në Mangalemin lindor dhe nuk e kapte njeri me dorë nga frika e ndonjë sëmundjeje ngjitesë. Prej tij i mësova misteret e Beratit, që të dalin përpara dhe të zënë pritë papritur, aq sa befasia të mban frymën dhe ti mbetesh si një budalla i vogël para tij. Hesht. Bukuri, edhe heshtja duhet, se dihet, me heshtje janë mundur ushtri të mëdha, janë pushtuar Kala dhe... unë tek thirrja e osmanit të famshëm spiun që u ngjit me litarë drejt Tabies... do ta filloja me mikun tim... Çekbeniiiiii!

## 3

Ja dhe rruga prej 120 kilometra nga Rogneri në sheshin «Teodor Muzaka II» në Berat mbaroi. Një orë e treçerek. Shoferi e quante veten kampion. Ndoshta. Im bir, kur sillte Redon Makashin me një *Benz* tjetërsoj e kishte bërë për një orë, nga teatri popullor në teatrin e qytetit. Por ky do të ishte rekord tjetër. Ndërsa miku im piktor e mbajti fjalën, duke m'i thënë përmendësh të njëqind shprehjet anglisht, deklamuar si aktorët anglezë të regjistruar në një CD origjinale, unë i bëra pyetjen e parë sa për të thyer kureshtjen: A e dinte ai se cili ishte kampioni i botës në njohjen e aromave? A e dinte piktori ynë se rekordi Guinness për aromat (1001 të tilla, sa edhe përrallat e Persisë së famshme) dhe rekordmen ishte **Kela Mbuhuri** që nuk ia përmend njeri emrin?...

## 4

Është emër i harruar si edhe emri i **Nasi Papapavlit** që mbrojti kodikët e famshëm dhe ua solli njerëzve sot në duar, edhe pse s'jeton. Ehu, shpirti është mes nesh. Tjetër gjë shpirti, apo jo?! Dhe Kela Mbuhuri e gjeje gjithnjë mbi lule, nëpër bezgat e kalasë, në Tomor e në Shpirag, në damarët e Myzeqesë dhe mbi pllajën e Dumresë. Kudo. Thonë se edhe Alpet i kishte prekur dhe aromat ia njihte. Çudi. Ne të zakonshmëve edhe kishat e një qyteti na duken krejt të njëjta jo më aromat. Ja, e dinte ky se...

## 5

Do ta fillojmë me **muzeun etnografik**, i thashë. Të duhet pak tranazh. E di atë tranazhin e ushtrisë «vishu-zh-vishu» para krevatit në mënyrë që t'i zërë gjumi shpejt, apo jo? Edhe unë do ta tregoj një nga misteret. Se Berati ka 999 mistere, ta dish. Duhet 999 net dimri që t'i tregoj. Lum ai që ka durim. Por një mjafton në pak sekonda. Një nga **këngët popullore qytetare** të Beratit (ia këndova, duke theksuar vargjet «ky jeleku i ngushtë në sqetull, / iu thefshin duart kush ta ka qepur!» Perlë, apo jo? T'u thyje duart rrobaqepësve se vajza rritej brenda natës dhe jeleku i djeshëm s'bënte më sot, se gjoksi i saj ishte bymyer nga prilli – me siguri prill ka qenë edhe atëherë kur u qanë me lot këta vargje, ndoshta si ky prill me diell të vesuar sot, teksa u nisëm nga *Rogneri* i famshëm...) Si do ta bënte piktori ynë portretin e asaj vajze? E kuptoj, më tha, çdo gjë e bukur, nis me vargjet e një kënge të famshme. Deri tani basti anon nga ti.

## 6

Të shohim. Ecim, se u bëmë vonë. Do t'i biem nga **rruga e Telelkave**. Dhe dalim atje ku duam. E ku duam ne sot? - pyeti. **Kisha e Shën Mëhillit**. Ku? Atë kishë e njoh me centimetra. Si? E njeh? Po basti, si? Njëri nga ne të dy do ta pijë atë verë! Mirë, le të bëhet si thua ti. Vajtëm. Porta. Kambanorja që ngrihej në shkëmb. E gjithë kisha zgjatet në gji të shkëmbit dhe humbet brenda vetes. E sheh dot si u fsheh? - e pyeta. Nuk e shoh. Po çfarë shikon ti!? Mbaje mendjen këtu. Kemi hyrë në kishë. Qetësohu. Merr frymë thellë. Se, para se të vizitohet kjo kishë duhet bërë ushtrim joge. Kuptohet, kërkon të më sugjestionosh.

## 7

Rruga e Telelkave... *Telelkat = Telendaret, ngjelkat... Ki-sha e Telelkave... Xhamia e Telelkave...* Sheshi i Telelkave... Dhe ja tani edhe romani Telelkat... Magjia e Telelkave... Zot më mbaj mendjen... **Berati është i vetmi qytet në botë** që i ka Telelkat si toponime dhe emërtime...

## 8

Marifetçi bastesh qenke! Jo, mor vëlla, këtu jemi në **Shën Mëhill**. Kujdes shikoj ikonat, mundohu t'i prekësh me dorë. Ta them vërtet. Dhe piktori, miku im, zgjaste duart të prekte ikonat dhe duart nuk arrinin dot tek ato. E pse? Ç'po ngjet? More rrufjan, se mos më bën magji. E si mund t'i ndalosh duart e mia për të prekur ikonat e famshme? Ç'thua, s'ka bërë vaki ndonjëherë. E di pse ndodh kjo? Ndodh që atij që ka dashur t'i prekë për herë të parë ia kanë prerë duart. Të dyja. Dhe tani, për të mos u prerë gjithë duart e njerëzimit, se njerëzit rrojnë, hanë e pinë me ato të uruara duar, (sidozot ti bën edhe piktura me mollëzat e gishtave, apo jo? Të themi edhe ndonjë ikonë të re!...) dhe si i bëhej hallit? Ja përse ndodh kjo. I nxit ikona, i tërheq. Po të duash puthi, të lejojnë, të pranojnë me nderim të thellë. E pra, puthe njërën! Piktori u afrua dhe e puthi cepin e ikonës. Mos ki frikë, nuk të ha! Tani afroji duart. I afroji. Sa ta prekte dhe dora mbeti në afërsi, punë milimetri. Shtjellë ajri? Magji? Ç'të të them! Ngeci para ikonave miku im piktor dhe merre te jepte për të prekur **misterin e Shën Mëhillit**...

## 9

Është **shpirt i shenjtë, Shën Mëhilli i famshëm**, që nuk të lejon. E puthura është shpirtërore dhe lejohet të arrihet si mundësi. Puthja mbahet mend, prekja jo. Ti mund të përdorësh duart në mënyrë fantastike dhe nuk ke mundur dot ta arrish atë ndjeshmëri të lartë që të dhurohet nga

Perëndia prej të puthurës. Kështu që ikonat e Shën Mëhillit i mbron një tjetër shpirt, sepse dora që i ndërton, ajo dhe i shkatërron. Jetojnë bashkë vesi me virtytin! Si thua? E dhe provimin hyrës në ikonografi? Qeshi. M'u duk se s'përmbahej nga inati dhe i dukej se një botë e tërë fantazmash ishte e pranishme aty. Do detyrohej ai edhe unë të kalonim në labirintin e tyre të përfytyruar.

## 10

Iu afruam një dritareje të ngushtë. Vështro, i thashë. Dhe pa. Tomori larg. Më afër Osumi. Pjesa poshtë e qytetit. Ndihej një puhizë e këndshme. Tani vëri re muret. I sheh? Jo. Bukur. Dalim përjashta atëherë. Vijnë te dritarja. Kujdes se është shkëmb dhe mund të biesh. Kujdes se ka nepërka, po lutju Zotit që jemi në prill dhe ende s'kanë dalë, por në zgjim janë, po u mbaron gjumi letargjik. **Helmi i këtyre nepërkave të Shën Mëhillit është ilaç**, more vesh. E pinë ata, shenjtorët, se duhet të ketë fuqi që të prodhojnë rrymën e pandjeshme të ajrit që ndalon duart e tua.

## 11

Të njeh Perëndia ty, duket! Dhe t'i ndal duart. Po, e lëmë më mirë. Tani shih nga jashtë brenda kishën. Sheh gjë? Jo! Si qenka e mundur? Ti po më luan mendsh mua! Pse e ke kapur kaq keq, zotëri? Kam ardhur qindra herë këtu, po me këtë gjuhë s'ka folur njeri me mua. Duket se po vë në përdorim imagjinatën e shfrenuar, që ma paske naaa! Hapi krahët dhe sytë nuk i ndante nga dritarja frëngji. Shih e bot. Nuk ngopej, por ama inati që pse i turbullohej gjithçka nuk i shqitej. Si të ishte e mundur? E, pra, mister. Një nga misteret e Shën Mëhillit. Por besimtarëve nuk u ndodh kështu. Ata shohin. Provoje ta gjejmë një besimtar. I tregova se kisha ardhur në kohën kur stërvitesha në njohjen e guximshme të imtësive të panumërta të tregimeve e gojëdhënave të njerëzve. Me **Mim Kumatin**. Ai shihte dhe prekte gjithçka. E kishim dhe sekretar partie të teatrit. Mimi bënte numra të rrezikshëm, ndonëse i sëmure nga zemra, por bari i helmët i nepërkës e kishte shpëtuar nga plasia e saj. Mimit ia afronte duart ikona. Mimi shikonte punë e madhe edhe nga dritarja frëngji, nga jashtë brenda, merr vesh? E pra, punë besimi... Dhe kjo nuk është pak.

## 12

Mendo çfarë shqisë të tepërt duhet të kesh. Ke më nga këto në Shën Mëhill? Me kaq s'fiton dot...

I thashë papritur që të gjente **Tabien e Kalasë**. I hodhi sytë lart dhe e vuri dorën strehë. Dielli i prillit, ndonëse ishte pak freskët, e digjte shkëmbin dhe mjegulla e çuditshme e tij krijonte një vello të mrekullueshme e të paparë, saqë askush nuk e besonte dot. Ke pikturuar ndonjëherë pas një nape të tillë të lehtë e fluore? E ke shikuar ndonjë vajzë që rri pas një kremi të magjishëm që të zbulon shtatëdhjetë për qind të dritës, brenda një misteri kaq xigluës? Mos thua jo. Ja, hidhi sytë sërish. Një zë i thellë, sikur shkapetej nga toka u dëgjua si pëshpërimë e thellë burri që merr frymë me zor, me shpatulla, thellë. «Çekbeni!» Ç'është kjo? Duhet ta dish. Këtë e shkruan edhe **Evlia Çelebiu** i famshëm turk, udhëtari që ua zbuloi këto thesare njerëzimit, duke i parë si një besimtar tjetër lloj. «Çekbeniiiiii!» Miku im zuri veshët me duar. Shaka e rëndë kjo. Por asgjë nuk bëhej për shaka. Të më besonte. Ato s'ishin zërat e regjistruar të aktorëve më të mirë anglezë për anglishten e tij! Jo. Ato ishin shpirt i dëshirës dhe shpirt i vvarë.

## 13

Sikur të thoshin se ishte shpirti i Mona Liza Xhokondës të Leonardo Da Vincit, që rënkonte, të gjithë do ta besonin. Sepse Xhokonda tashmë është një figurë botërore. Njëlloj sikur t'i ngjitnin një gjë të pamundshme Mesit dhe njerëzit me siguri do të tundnin kokën, edhe pse s'e dinin atë që mund të kishte ndodhur apo jo! Ç'të thuash! Por ama gdhend fjalët në shkëmb po deshe që në një masiv në **Valamarë** pikon qumësht, këtë s'ta beson kush! Por atje, ndarë nga Guri i Kamjes barinjte freskohen nga pika e qumështit. Se qumështi nga bari bëhet dhe rrënjët e qumështoreve fryjnë gjinjte e malit dhe ky kullon qumësht në guvat e Gurit të Topit, në shpellat e Kamjes dhe në gjinjte e plotë të Valamarës. Kur fjeta një natë në Valamarën e Istrias m'u kujtuan pikat e qumështit të Valamarës sonë... **Kështu pikon qumësht mbi Shën Mëhill**...

## 14

Ej, mos më thuaj se ka edhe qumësht ky shkëmb që mban në gji këtë kishë? Po, i thashë, por vetëm tani në prill.



Veçse duhet të jesh i guximshëm, të ngjitesh në gurë të thepisur për të pikasur qumështore. Dikur, ama dikur, gjeje edhe dhi që flinin aty, bashkë me nepërkat e dhisë, se nuk bënin dot pa njëra-tjetrën. I dashur ciceron (unë ciceron?! ) pse më the të vështroja Tabien? S’ka nevojë ta them unë. **A nuk e sheh që ka një kënd të thyer midis Tabies dhe Shën Mëhillit?** Po. Atëherë, mendo sa e bukur do të ishte një ngjitje me ashensor këtu! Perlë. Ti as me mend nuk e merr se çfarë humbasim. Kemi 30 vjet, nuk e di saktë, që bërtasim e themi se duhen projekte. Po projektet i ha lubia atje në kryeministri, apo në ministri, se nuk mendon për një ashensor, por më së pari për një PPP me ishullin e Piratëve, që do ta ndërtokan kinezët. Na ndërtuan njëherë e një kohë kombinatin tonë për të veshur të paveshurit e botës, madje edhe marksistë-leninistët e zgjuar tek Zoti, kurse tani do ta bëjnë me Ishull! Perëndi e madhe, më gjej vend të futem...

## 15

E more vesh edhe këtë? Tani do futemi sërish në kishë. Do të dëgjojmë fjalë të vjetra dhe organo. Si? Edhe këto do t’i kemi? Bukur. S’paska më bukur. Qenka si Notrë Damë e Parisit me Kurrizon dhe Esmeraldën. Më keq, i thashë. Por kjo ndodh në pak ditë. **Duhet të jesh këtu një javë para Pashkës. Ku e di kisha se kur vjen Pashka?** Gjëra të mësuara, Zot. S’ka si shpjegohen ndryshe. Pse, e gjithë toka e Shën Mëhillit kështu qenka? Po a ka mundësi që kjo të mbahet në këmbë nga kureshtja e njerëzve? Po tallesh më duket. Jo, vetë ishe i pranishëm, nuk të dolën ato që të thashë? Po, vërtet. E pra. E fshehta është te besimi. Këtu, i dashur njeri i zakonshëm, bëhet diferencimi i madh: si asnjë dëshmi tjetër që ndodhet në Shën Mëhill, duhet edhe kjo pamundësi: as zërat, as ikonat, as muret, dhe... as besimi nuk mbrohen me xham. Me xham të thjeshtë, nga ai i thyeshmi, ku depërton drita e fshehtë. Se tani njeriu është zhvilluar shumë, bën edhe lojë me drita, apo jo?...

## 16

**Mijëra drita e godasin natën Shën Mëhillin dhe ai duket i ngjyruar si i fshehur në ylber.** Sa dashuri dinë të falin ata që i besojnë dritës. Por... e dini se Shën Mëhilli u fshihet dritave vetvetiu. Është një nga magjitë e tij të mrekullueshme. Nuk i fik kush dritat, jo. Kjo është lojë kalamajsh dhe as që ngjan me fantazinë e njeriut. Është thjesht dritë dhe kjo po aq thjesht humbet. E bën të mundur ndoshta Shën Mëhilli. Më thoshte dikur kryetari i bashkisë së këtij qyteti se nuk mjafton buxheti i bashkisë për të ndriçuar Beratin, lagjet muze të mbrojtura nga UNESCO. Mirëpo nuk ma zuri ngoje që Shën Mëhilli ia kursente lekët Bashkisë. Edhe kjo çudi ngjante. Por kjo s’kishte të bënte me misteret e tij. Të tjera ishin ato. E merr me mend, i thashë piktorit, mikut tim, se si mund të ngjiteshim pa ashensor në Tabie. Do të dilte shkumë, edhe pse e merr me mend se kjo do të ishte më e bukura.

## 17

Këtu, në këta shkëmbinj deri vonë nga fundi i viteve gjashtëdhjetë ka rrojtur, në **sheshet e braktisura të Shën Mëhillit, Memeci i Dines**, ai që i fuste tmerrin Beratit, kur i shkrepse të dilte rrugëve (qeji i tij ditët e Pazarit!) teksa ndërsente dyzet langonjtë e tij, me hejbet varur në krahë dhe rrobat copë e trokë, leshra lëshuar, zgjyrë e gjallë, që ulërinte me «aaaaa!» dhe «iiii!»-të e tij të llahtarshme...

## 18

Lëmi i Shamatasë... Sheshi i Shamatasë... Shkolla e Shamatasë... Kisha e Shamatasë... Dhe tani së fundi portreti *E Bukura e Shamatasë...Berati është i vetmi qytet në Botë që e ka toponimin dhe emërtimin e fjalës Shamata*, Shamatë...

## 19

Ndoshta, për t’u mbrojtur ndryshe, **Shën Mëhilli** i madhërishëm mori masa urgjente dhe **u dha dritë ca gjërave që ne na duken mistike**. Duheshin mbrojtur ikonat, muret, drita. Provo të ecësh mbi pllakat e gurta të Shën Mëhillit dhe të ndihesh ngushtë, **sepse trupi yt nuk peshon fare**, edhe pse je i mbështetur mirë mbi tokë. Mund të jesh, madje edhe peshë e rëndë si puna ime, dhe prapë nuk peshon. Para këtij ligji kozmik, s’qenka gjë edhe obeziteti. Ku m’i gjen më operacionet për të hequr dhjamin. Ta heq fët Shën Mëhilli...

## 20

Kështu, miku im, ne mund të ngjiteshim edhe me shkallë të rregulluara bukur, rrethuar me drita anash, drejt Tabies, prej kësaj foleje të Zotit të plotfuqishëm. Dhe do ta meritonim. Turistët, sigurisht, këtë do ta pëlqenin shumë. Dhe kjo do të donte më tepër besim dhe jo aq pará sa do të donte ashensori me kënd të thyer deri në Tabie. E ç’duhet Ishulli i Piratëve para kësaj vepre të madhe? Sepse koha është e vyer. Kush ka nge le t’u bjerë shkallëve, kurse të tjerët do ta mbajnë frymën në Tabie, si për ta përshëndetur edhe njëherë Shën Mëhillin tonë të madh.

## 21

Ti si thua? E bëjmë ne ashensorin? Pse jo! Do të fitonim shumë. Rrethuar me xham me dritë diellore dhe pse jo edhe fotografike. Do të jetë më e shikuara, nuk e fsheh. Sigurisht aty do të thuret një enigmë tjetër, ashtu si më thoshte Mim Kumati i ndjerë se **Shën Mëhillin nuk e lag as shiu**. E provova në kurrizin tim dhe u bëra qull. Ama Mimi nuk ishte lagur. Me mua ndenji. Çudi, për të luajtur mendsh! Mirë që ditën e atij fundprilli nuk ra shi se të dy me mikun

tim piktor do të ishim bërë si rosat në pellg dhe ndoshta do ta paguanim shtrenjtë këtë bukuri të allasojtë në **Shën Mëhillin e ajgëtuar nga të fshehtat**. Por, sidoqoftë, moslagien e Mim Kumatit s’mund ta harroj kurrë. Të dy nën shi, të dy ndryshe: ai me tesarën e PPSH në gji dhe unë pa të? Mos vallë e kishte fajin tesera? E di që s’do ta zbërthente dot njeri këtë mister. Se askush s’mund ta kishte vullnetin e këtij Shenjti të tjetërfartë nga bota!

## 22

Ndoshta dikur, në dritën e fuqishme të yjeve të shuar (se drita e tyre udhëton, paçka se ata janë shuar me kohë, pse jo edhe mijëra vjet më parë) **do të zbërthehet enigma e vërtetë e Shën Mëhillit**, që këdo e tërheq me pamjen nga jashtë aq fine dhe me një elegancë të paparë, saqë të fshihet pas një nuri të pathënë ndonjëherë për t’u përmbytur nga blicet dhe dashuria e pafund e njerëzve. Po unë sidoqoftë, mikut tim Roland Gjozës, shkrimtarit që shkruan nën dritën e një tjetër magjie, pafundësisht i dashuruar me zemrën njerëzore, në Nju Jorkun e largët, do t’i thosha që një ditë të bekuar ne do ta ruanim për të qenë bashkë e për të përjetuar magjitë e Shën Mëhillit. Por ai është besimtar dhe unë sërish do ta pësoj. Do të jetë përsëri e bukur. E pashë në sy piktorin. U ngrysem këtu, i thashë. Do ta pimë verën?...

## 23

Ndërkaq ai u përpoq të rimonte diçka që ngjante me jelekun e vazzës së vogël e të rritur brenda natës së prillit: **Shën Mëhill o i uruar, iu thefshin duart kush të ka ndër-tuar...** Qesha. Po të ishte këtu Faslli Haliti do të jepte një flakërimë që ta mbaje mend e do të thoshte: Pse kështu vargëzohet o trupeshk?! Sidoqoftë ne drekën e hëngrëm në darkë, por ama, basti bast, verën plus e piva vetëm unë!... Po. **I gjithë Shën Mëhilli, është një mister...**

## 24

Miku im piktor, përsëri s’ma vari, vuri sërish kufjet dhe më tha se prapë do të merrej me njëqind frazat në anglisht, gjithnjë sipas mënyrës së tij, të deklamuar nga aktorë të vërtetë anglezë me një diksion dhe ritmikë të përsosur...

Duan të prishin muret, i thashë. I kanë zhveshur nga bimët kacavjerrëse dhe kanë krijuar një shesh pushimi me gjatësi sa gjithë perimetri i murit në tërë shtrirjen, nga jashtë. Mos është thjesht një trill? Ndoshta, por sot unë nuk i besoj askujt, ta dini. Mund të ndodhë që të jetë një fiksion, se s’bën vaki të prishen muret sot më 2020-ën! Por ama çdo gjë mund të ndodhë. Me ata që kemi mbi krye, të prishur nga mendja dhe me oreks optimal mund të zhduket edhe nga harta. Mjafton të luajnë në dorë ca miliona! Ëndrra në diell, miqtë e mi. Organizatat jo qeveritare, duke parë me një sy shkrepimën e diellit mbi Tomor, u gjendën të shokuar nga befasia: Republika e katërt e Tiranës. Zgjedhje të reja. Të gjithë për zgjidhjen përfundimtare. Sakrificë kombëtare: të gjithë shqiptarët kudo në botë, që kanë emrin në listat zgjedhore, të vijnë medoemos ditën e zgjedhjeve dhe të votojnë për alternativën e re studentore... Njerëzit po shihnin njëri-tjetrin. Ishte gdhirë në këmbë një aktor skeçesh e baladash, një Pepe Grilo shqiptar, që s’dilte nëpër sheshe, por punonte vetëm me internet, me thirrje të fuqishme... Asnjë s’mund të zgjidhej: as nga pd, as nga ps, as nga lsi. Në lëvizje thirrreshin vetëm të ndershmit. Pikë...

## 24.1 (ose 999, fundja edhe 1001... )

Ëndërr apo e vërtetë? Po me Kalanë ç’patën xhanëm? Po e ndreqin apo po e prishin? S’dihet, por kësaj radhe duan të kurorëzojnë lirinë! Vdiqën sheshet, fluturoi mbrojtja e turmave. S’ka më turma. Ka vetëm njerëz të ndershëm. Kështu bëjnë vetëm njerëzit me mend dhe jo kokëkrisurit!

Kjo atmosferë elektrizuese na solli në Kalanë e Beratit, bashkë me një grup norvegjezësh të etur për diell. «Bukur. Shumë bukur!» thoshin nëpër buzë, duke prekur paksa një buzëqeshje të fikur. Ecnin si të handakosur, sikur t’i kishin rrahur (efekt trallisës i diellit!), po më fort se gjithçka donin të shihnin diellin në sy dhe hapnin krahët si të shkalur, si për t’u mbrojtur nga era që ua ngrinin leshrat përpetë. Ndaluan pak te hyrja prapa **Katedrales «Shën Mëria e Fjetjes»** dhe donin të hynin brenda për të parë ikonat e famshme të Onufrit. Abdyl Pilafi nuk i thotë gjë askujt dhe as mburret se Onufrin e kishim dhuratë prej tij. Por këto, sot, nuk i vlejné askujt...





*Bashkëshortes sime, Shpresa Bërdëllima,  
në ditëlindjen e saj*

## SI ERDHE NË JETËN TIME? DHE SI U LARGOVE?

*Nga Arjan Miluka*



Në një ditë të zakonshme ndodhi e jashtzakonshmja jonë. Të pashë të ulur aty ku s'e mendoja dhe u njohëm, megjithëse të njihja mirë prej kohësh. Të përshendeta si pa problem teksa zemra më rrihte fort. Nuk do t'i pergjigjeshe shikimit tim, mendova. Por jo! Ndërkohë, mora fryme thellë për të mposhtur emocionet dhe me bisht të syrit vëreja qetësinë tënde. O Zot, shpëtova disi! Por si të vazhdoja? Me një qetësi të shtirur të tregova nja dy barcoleta që të pëlqenin! Fitova ca pikë që më dhanë guxim. Por tani çfarë të bëj? Sa doja të qëndroja më gjatë, por trembeshja së mund të të humbisja. Jo, i thashë vetes, do të luaj indiferentin, dhe në moment të përshëndeta që të largohesha. Një buzëqeshje e ngrohtë dhe e çiltër e zbukuroi portretin tënd engjëllor. Unë e di si kaluan tri ditë pa u parë, a thua se ishin tre vjet, kështu m'u dukën. Kur shoh ti po vije si një flutur duke qeshur, dhe m'u duk sikur nuk po me drejtoheshe mua. Ktheva kokën për të parë mbrapa se kush mund të ishte pas meje. Askush! Ec e mos i beso mrekullitë!

-Hë, - më the pa të keq dhe duke qeshur, - po flet me veten? Apo je i zënë tani?

-Jam aq kot, sa nuk e di ç'të bëj, - munda të të thosha, megjithëse, të jem i singertë, më prisnin diku.

-Unë jam e lirë nja dy orë, -më the, - dhe mirë që të takova. Sigurisht, nëse je i lirë dhe nuk ke kundërshtim!

AbraKadabra, thashë me vete, si vjen jeta.

-A ke ndonjë barcoletë si atë ditë, -më pyete?

-Kam disa, ose sa të duash ti, - të thashë gjithë tangerllik, që s'di nga më erdhi.

-A shkojmë te kafe Flora, - m'u duk se më ftove ti.

-Mrekulli, në këtë orë është qetë aty, - të thashë gjithë gëzim.

Shkuam, u kënaqem, u lumturuam. E çuditshme, po si iku koha kaq shpejt?.

Folëm me çiltërsi për shumë gjera të njeri tjetrit. U ndamë, dhe i premtuam vetes se do të shihemi së shpejti. Dhe më pas, të shiheshim çdo ditë, na u bë e domosdoshme! Të dy e kërkonim njeri tjetrin pa zhurmë!

Kishim ndrojtje nga të tjerët. Si zakonisht, në këto raste, një pjese e miqve tanë kujtonin se njiheshim prej kohësh. Isha i sigurt se do te fillonin intrigat e zakonshme.

Bisedat e takimet tona u bënë të shpeshta, të domosdoshme për të dy, por pa deklarata.

Një pasdite e lamë të shkonim te shtëpia e një shoqes tënde për vizitë.

U ngjitëm në katin e katërt, por për fatin tonë të mirë apo të keq, shoqja jot nuk ishte brenda.

U mërzitëm e pak dhe si të tronditur paksa, ndoshta nga kjo e papritur, sikur kishim nevojë të uleshim e të mblidhnim veten.

Pa u kuptuar, u afruam dhe u mbështetem tek njeri tjetri, krejt natyrshëm.

Sikur një temperature 3000 grade më kapi. Kështu thoshte një shok im, në të tilla, mund të, shkrinte dhe wolfram.

Një tundje e lehtë flokësh preku fytyrën time, pa e



kuptuar u afruan buzet e mia, u takuan me të tuat, nuk besova, e gjitha kjo më dukej sikur ishim në një ëndërr.

U kthyem të dy ne realitet, e pa folur filluam të zbrisnim shkallet.

Ne po zbrisnim kur shoqja jote ngjiste shkallët.

-O, më falni, -tha jo, - dola bleva diçka për të pirë.

U futem ne apartamentin e shoqes saj. Ishte teper modest, por shumë i miqësor.

E ndieja se po me këputeshin gjunjet. I thashë vetes, e po, me demek, je dhe i fortë, mbahu tani!

Ishte fillimi i një mrekullie apo i një mundimi?

Telashe në të ardhmen tone. Ndërsa neve çdo ditë na behej më e bukur, te tjerë mundoheshin te na e nxinin. Dy kontraste, po mirë, ç'hall kishin të tjerët?

Kujt t'i bëje ballë përpara: familjeve? Njerëzve të ndryshëm? Institucioneve?

E pa le, komitetit të Partisë! Kaluam vështirësi të panumërta.

I përballuam të gjitha dhe jeta jonë pothuajse u stabilizua, por xhelozia për ne të dy u ashpërsua.

Me ndryshimin e sistemit e pamë të arsyeshme që t'i rrinim larg kesaj lufte të padrejtë. Zgjidhja ishte emigrimi. Kaluam shumë vështirësi që janë të njohura vetëm për ata që emigruan. Por pati dhe diell për ne, erdhën ditë të bukura.

Ti Peka u aktivizove me sukses në veprimtari patriotike, tek emisionet shqip të radio Brukselit.

Po ashtu, në shumë aktivitete dhe në festat tona kombëtare. Recitimet e tua emociononin gjithkënd, shqiptarë dhe të huaj, duke e rritur ndjenjën kombëtare tek emigrantët.

Dëshira jote, Peka e dashur, për këto aktivitete ishte tepër e zjarrtë. Por ja, e keqja e madhe filloi të veprojë mbi shendetin tënd dhe pas një kohe të mposhti. Ike nga kjo jetë që e doje kaq shumë. Peka, dhimbja ime, e dy vajzave dhe e djalit, nuk kanë përshkrim.

Amaneti i saj për ne ishte që shkruhej epitafi: "Shqipëri më dhe nder, më dhe emrin Shqiptar" - 27 tetor 2019.

Sa herë është mot i kthjellët shikoj në qiell, ku kam fiksuar një yll dhe të mendoj se je gjithmonë atje!





# “LETRA E VERDHË E MURIT” DHE SHOQETËSIMET E CHARLOTTE PERKINS GILMAN-IT

Halle Butler, *The Paris Review*

Kur e lexova për herë të parë “Letra e verdhë e murit” vite më parë, para se të dija ndonjë gjë për autoren Charlotte Perkins Gilman, më pëlqeu kaq shumë. Më pëlqeu toni shkurajues, sarkastik, fundi ngjethës, qartësia e kritikës ndaj “kurës së pushimit” kaq popullore në shekullin e nëntëmbëdhjetë, në thelb një pushim i zgjatur për gratë që binin në depresion. Historia kishte ironi, nxitje për reagim, zemërim. Në ditën e fundit të trajtimit mjekësor, rrëfimtaria është plotësisht e çmendur. Mendon se është një krijesë që ka dalë nga letra e murit. Kura e pushimit shkaktoi sëmundjen që mëntonte të zhdukte.

Kaq bukur dhe qartë.

Rrëfimtari i paemër në vetën e parë përjeton tronditje mendore që e njihja mirë - një trajektore rrethore dhe klaustrofobinë e një depresioni në rritje, ndiesinë e fundosjes ngaqë diçka nuk tregojë hapur. Leximi i “Letra e verdhë e murit” përjetohet si një përzjerje e vuajërizmit me njohjen, që dalëngadalë shndërrohet në tmerr. Ishte vërtet tronditëse. Ndiheh i përhumur.

Historia mbështetet në përvojat e Gilmanit me doktor Silas Weir Mitchell, mjek i shekullit të nëntëmbëdhjetë, përherë në qendër të vëmendjes. Mitchell e rekomandonte kurën e pushimit me qëndrim të stërgjatur shtrirë në shtrat dhe me izolim për gratë e bardha intelektuale, aktive dhe me pozitë të lartë shoqërore. Virginia Woolf, Edith Wharton dhe Jane Addams, të gjitha e provuan këtë kurë, e cila mund të zgjaste me javë, ndonjëherë me muaj. Gilmanit duket qartë që ia kishte neveritur përvoja që kishte patur dhe neveritja e saj është e dukshme.

“Letra e verdhë e murit” nuk ishte ikonike gjatë kohës së saj dhe fillimisht u refuzua, më 1892, nga redaktori i *Atlantic Monthly*, Horace Scudder, me këtë shënim: “S’mund t’ia fal vetes t’i bëj edhe të tjerët të ndihen po aq të mjerë sa jam ndier vetë [duke e lexuar]”. Gjatë jetës së saj, Gilman ishte e njohur për angazhimin në politikë dhe fitoi popullaritet me shumë poezi satirike me kafshë. “Rastet e ngjashme” kaq e dashur për lexuesin përshkruan kafshë prehistorike që mburren se në çfarë kafshësh do të evoluojnë, ndërsa miqtë tallen me ta për arrogancën që tregojnë. Një tjetër, me titullin “Një Konservator”, e përshkruan Gilmanin si një lloj Darwinianeje të krisur në kopshtin e saj, duke i bërtitur në një fluturë të hutuar që po qan. “Rastet e ngjashme” shihej si ndër “vargjet më të mira satirike të kohëve moderne” (autori amerikan Floyd Dell). Ka vargje si këto: Një herë e një kohë një kafshëz, /Sa një dhelpër, jo më e madhe se aq, /I mbathi me të katra për t’u arratisur/ Nëpër shkëmbinjtë të thepisur. Dhe kështu me radhë.

Gilman tani është më e njohur për “Letra e verdhë e murit”, për shkak të Elaine Ryan Hedges, studiueses dhe anëtares themeluese të Shoqatës Kombëtare të Studimeve për Gratë, e cila e nxori Gilmanin nga harrimi. Në vitin 1973, botuesi i shtëpisë Botuese

*Shtypi feminist* nxori në treg librin e titulluar “Letra e verdhë e murit” me pasthënie të Hedges, e cila e quajti “një kryevepër të vogël letrare” dhe Gilmanin “një nga feministet kryesore të kohës së saj” megjithëse Gilman kurrë s’e pa veten si feministe (në fakt, në një nga letrat e saj shkruante: “E urrej të quhem feministe”). Madje edhe veprën që shkruante se shihte si letërsi. Në hyrje të librit që mora, Gilman citohej të ketë thënë se ajo shkroi për të “predikuar...Nëse është letërsi, kjo thjesht ka ndodhur vetvetiu”. Ajo e shihte të shkruarin si një mjet për përhapjen e politikës që mbronte, dhe veten një makinë propagandistike që përbëhej prej vetëm një gruaje. Hedges thekson në pasthënie se Gilman shkroi “njëzet e një mijë fjalë në muaj” ndërsa punonte në revistën politike që botonte vetë, *The Forerunner* (Lajmëtari).

Duke rilexuar “Letra e verdhë e murit” në pranverën e vitit 2020, kur më kërkuan të shkruaj këtë ese, më bëri përshtypje ndjesia e shqetësimit, humori dhe atmosfera e çuditshme dhe frikshme. Ishte më e thellë dhe më simbolike se sa kisha kujtuar, sikur të ishte më shumë se sa dukej. S’më kujtohej që dhoma e verdhë kishte qenë dikur çerdhe me hekura në dritare.

Shumica e tregimeve të Gilman-it përqendrohet në çlirimin ekonomik të grave të bardha. Për personazhet e saj gra, mënyra kryesore për të qenë të sigurta ishte gjetja dhe mbajtja e një burri të mirë, pavarësisht nga sakrificat që duhej të bënin. Personazhet trashëgojnë borxhe nga bashkëshortët, sakrifikojnë ambiciet artistike për hir të fëmijëve, gati dëbohen nga shtëpia për të jetuar si vejusha, dhe gjithmonë rrezikohen nga turpërimi. Shoqëria, ashtu siç përshkruhet në këto fabula nuk ofron zgjidhje të mira për këto probleme, ato jetojnë me fëmijë mosmirënjohës, lënë shtëpinë,

kthejnë dashnoren e burrit mbrapsht në rrugë për të shpëtuar pozitën shoqërore, etj. Është një botë mbytyese dhe Gilman i përshkruan efektet e saj me dhembshuri. Por ndryshe nga Edith Wharton, për shembull, (apo edhe ndryshe nga “Letra e verdhë e murit”), Gilman përpiket të paraqes zgjidhje. Protagonistët punojnë së bashku për të siguruar kujdes ditor, hapin shtëpitë për klubet e grave, marrin aty onviktore, solidarizohen me njëra-tjetrën, zbulojnë jetët dhe rutinën në shtëpitë e tyre, fitojnë dhe kursejnë paratë e tyre dhe punojnë së bashku në harmoni. Rrëfëhet një mënyrë e qetë, madje në mënyrë komike pa konflikte për zgjidhjen e problemeve sociale.

\*\*\*

“Shtrihem në këtë shtrat të madh të paluajtshtëm – besoj i mbërthyer në dysHEME – dhe rri aty rreth një orë. Ka të njëjtin efekt si gjimnastika, ju siguroj. Filloj soditjen, le të themi, nga fundi, poshtë në qoshe, atje ku nuk është prekur, dhe vendos me mijëra herë që *do të* ndjek me sy atë model të pakuptimtë për të arritur në një lloj përfundimi”. Kjo është rrëfimtaria e “Letra e verdhë e murit”. Ajo po kërkon njollat në mur, duke kërkuar të arrijë në një përfundim, ndërsa gjurmon pa pyshim me sy modelin e letrës së murit, e shtrirë në një shtrat të gozhdur në një banesë të braktisur. Çfarë do të thotë? Mos vallë thjesht dënon patriarkatin? Nëse historia është thellësisht simbolike dhe një përsiatje për modelet e fshehura, cilat janë ato? Ne e njohim këtë histori si një dënim të praktikës barbare të kurës së shërimit, por kur e skanojmë, çfarë tjetër lexojmë?

Një përpjekje: Shtrati është gozhdur në dysHEME – rrëfimtaria nuk e kontrollon dot rolin e saj në riprodhim. Shtëpia e stërgjyshërve, si simbol i trashëgimisë gjenetike (një temë që Gilman përdor edhe në ese ashtu edhe në shkrimet letrare), është në gjendje e keqe, për shkak të saj. Rrëfimtaria është e humbur sepse i shoqi nuk do ta dëgjojë - pa bashkëpunim midis burrave dhe grave, nëna humbet dhe cikli i gjendjes së keqe (ajo bëhet letra e verdhe e murit e grisur copa-copa) vazhdon. Po për sa i përket vetë letrës së verdhë të murit? Ajo do që letra të zbardhet.

Është bërë e zakonshme ndarja e “Letra e verdhë e murit” nga pjesa tjetër e veprës së Gilman-it, për ta ndarë qartë kështë histori nga pikëpamjet e saj racore dhe pasioni për përmirësimin e racës njerëzore: e tillë ishte koha në të cilën jetoi. Po, në kohën në të cilën jetoi ishte trazuese të botoje një tregim të shkurtër kritik ndaj patriarkatit dhe publiku ishte i etur për të përqaftuar një poezi të këndshme për racën njerëzore. Po tani? Ajo që na trazon është një studim i rëndësishëm.

“Letra e verdhë e murit” është rrëfim për hipokrizinë, shtypjen dhe trashëgiminë. Është histori rreth modeleve të fshehura nën modele. Letra e murit e shtyp rrëfimtaren derisa të filloj ta shohë veten te ajo, dhe të identifikohet me të. Ajo bëhet gruaja që është në letrën e murit, bëhet vetë letra e murit dhe pastaj shpëton, por e njollosur kudo dhe thellë brenda saj. Nëse mund të mësojmë nga ideja e qëndrueshme letrare e historisë (e cila sipas Gilmanit, historia është ajo që “sapo ka ndodhur”), atëherë një gjysmë e vërtetë nuk është përgjigje. Ajo që fshihet është e rrezikshme. Motivet janë të rëndësishme. Unë do të nxisja këdo që e ka parë Gilmanin si një heroinë të feminizmit të hershëm, ta shoh në një këndvështrim tjetër. Në një këndvështrim të ri do të gjeni modele të njerëzimit, por ato nuk do të jenë aq të thjeshta sa dukeshin.


Halle Butler është shkrimtare nga Midwest-i, SHBA. Romani i parë, *Jillian*, është rrëfim i shkurtër i gabimeve shoqërore të sekretares së alkoolizuar të një spitali dhe trajtimit të pashpirt nga kolegu i punës. Romani i dytë, *Unë e rilindur* (The New Me), është rrëfim i shkurtër i një punëtori zëvendësues në gjendje depresioni. Ajo ka fituar vlerësimin si Romancierja më e mirë amerikane për të rinj dhe një çmim nga Fondacion Kombëtar i Librit “5 nën 35”.

Përktheu: Granit Zela

Charlotte Perkins Gilman

## Letra e verdhë e murit


OnufriMinis





# SYRI SHQIPTAR: MARY SHELLEY DHE KADARE

Nga Gilles Bandérier



Duket disi e çuditshme të pranëvësh, në krye të një studimi, dy emra kaq të largët mes tyre në historinë e letërsisë evropiane siç janë Mary Shelley dhe Ismail Kadare. Ka fort të ngjarë që shkrimtari shqiptar të mos e ketë njohur krijimtarinë e paraardhësës së tij britanike, megjithëse - fakt që ia vlen të nënvizohet dhe që pa dyshim lidhet me qëndrimin në Institutin Gorki - burimet letrare të Kadaresë janë kryesisht klasike: nëse autori i *Dimri i madh* përmend Eskilin, Danten, Shekspirin,<sup>1</sup> Dostojevskin, Kafkan... mungesa e novatorëve të mëdhenj të shekullit XX (Xhojsi, Prusti, Muzil) është e dukshme.

Askush nuk e mohon dot, Kadareja bëri që Shqipëria të hyjë në zonën tonë letrare, ashtu siç bëri për Islandën Halldor Laxness-i. Para botimit të *Dosja H.* dhe *Kronikë e qytetit të gurtë*, para, pra, se Kadareja të mos e kishte bërë këtë vend të vogël pikën gjeometrike të të gjitha kontradiktave dhe të tragjediave të shekullit, do të ishte fort e vështirë të citoje vepra të njëfarë rëndësie (duke veçuar përshkrimet e udhëtimit) që kanë në sfond vendin e shqiponjave. Novela e Mary Shelley-t, *Syri i keq*, bën përjashtim<sup>2</sup>.

Mbi burimet e kësaj historie janë sjellë shpjegime përmes një erudicioni të hollësishëm: pikënisja ka qenë një nga ato plagjiaturat që epoka e romantizmit i kishte fort për zemër: *La Guzla* e Prosper Merimesë, e paraqitur gjoja si përkthim i tridhjetë e dy poezive me prejardhje nga Dalmacia, Bosnja, Kroacia dhe Hercegovina. Nga gjithë këto tekste vetëm njëri është autentik<sup>3</sup>.

Saktësojmë se gusla është njëloj kitare me një tel të vetëm, që përdoret në Ballkan.<sup>4</sup> Mary Shelley duhej të botonte një paraqitje për këtë botim në *Westminster Review* të janarit 1829, bashkë me përkthimin në anglisht të tri poemave: *The beloved of Dannisich*, *The Flame of Perrussich* dhe *Maximus and Zoe*. Vëmendjen tonë e ka tërhequr kjo e fundit. Siç e ka shpjeguar përkthyesja:

<sup>1</sup> Shih dy sudimet *Figurat e ëndrrës te Pallati i Ëndrrave: Eskili, Shekspiri, Kadareja dhe Kadareja dhe Dantja*.

<sup>2</sup> Kjo novelë citohet sipas botimit *Collected Tales and Stories* de Mary Shelley, ed. by Charles E. Robinson; Baltimore-London, The Johns Hopkins University Press, 1976, p. 100-116.

<sup>3</sup> Shih punimin e Alan W. Raitt, *Prosper Merime*, Londër, Eyre & Spottiswoode, 1970, f. 41-44, 58-62. Dihet se Gëtja ishte ndër të paktët që nuk u mashtruan (*Gesprache mit Eckermann*, 14 mars 1830). Kujtojmë se *La guzla* ishte përkthyer në rusisht nga Pushkini dhe në polonisht nga Mickieviçi, që të dy të mashtruar. Shih R. Maixner, "Disa viktima të *La guzla* të Merimesë", *Revue de Littérature comparée*, XXX-3, korrik-shtator 1956.

<sup>4</sup> "Gjithë vëmendja e Mark-Alemit u përqëndrua së pari në ato vegla, "lahuta", siç quheshin, tepër të ngjashme me "guslat" e rapsodëve sllavë". (*Pallati i Ëndrrave*, f. 168).

(Kjo) poemë mbështetet mbi besëtytninë që lidhet me syrin e keq, i cili, kujtdo që i drejtohet, e vret atë. Syri i keq shfaqet në mënyra të ndryshme, njëra syresh është pasja e dy bebëzave në secilin sy.<sup>5</sup>

Linja që ndjekin njëzet e tetë strofat është fare e thjeshtë. Zoe, vajza e një vojvodi, rrëmbehet me kërkesën e saj nga i dashuri i vet Maksimi. Me shumë vonesë, ajo do të vërejë se ai ka shenjën e syrit të keq dhe do të vdesë. Mary Shelley ka nxjerrë nga kjo poemë lëndën e novelës së saj; edhe pse kjo lëndë fillestare është pasuruar, në tërësinë e saj ajo e tërheq fare pak lexuesin, tek sheh si një grek nga Moreja i kërkon një shqiptari (që ka syrin e keq), me të cilin është lidhur përmes një betimi midis shokësh, të hakmerret për të, lidhur me një përvetësim trashëgimie. Si në poemat e përkthyer dhe në novelën *Syri i keq*, ndeshet i njëjti imazh për shqiptarët: popull i egër malësor, i lidhur marrëzisht

<sup>5</sup> Mary Shelley, *Westminster Review*, 1829/1



me kodin e nderit<sup>6</sup> dhe respektimin e fjalës së dhënë<sup>7</sup>, por dhe i obseduar nga besëtytni, të cilat, edhe kur nuk janë tipike shqiptare<sup>8</sup>, marrin gjithaq, në këto troje të rrepta, një theksim tepër të veçantë.

Gjithsesi, ndihet teprimi me njëloj ekzotizmi jo fort të goditur, i cili, në të vërtetë, ishte i pranishëm edhe në përkthimin e baladave të Merimesë<sup>9</sup>.

Lexuesit e Kadaresë, për mendimin tonë, duhet ta ndiejnë veten në tokë të njohur. Në veprën e Mary Shelley-t, ata gjejnë po ato tema që janë në themelet e veprës së shkrimtarit shqiptar: gjakmarrjen, në fillesa serish të pafundme vrasjesh<sup>10</sup>, *kanunin*, kodin e nderit, i pashkruar me rregullat e tij shumë të përpikta të mikpritjes (*besa*) dhe, sidomos, syrin e keq, besëtytni së cilës Kadareja i ka kushtuar një nga tregimet e tij më të mira, *Qorrfermani*, shkruar në vitin 1984, para mërgimit, por të cilit iu desh të priste vitin 1993 për t'u botuar në Francë. Aty gjen konstantet e universit legjendar shqiptar, si urën me tri harqe<sup>11</sup>, e përmendur gjithashtu dhe te *Muri i madh*<sup>12</sup>. Te *Qorrfermani* veprimi zhvillohet

në Perandorinë Osmane, por ne e kuptojmë se bëhet fjalë pikërisht për Shqipërinë (zhvendosja i ka krijuar shpesh Kadaresë mundësinë për t'i shpëtuar censurës). Asnjë e dhënë kohore nuk jepet, gjithsesi

<sup>6</sup> "A s'ndiqet ai nga armiqet e tij, dhe a s'janë betuar ata se gjaku nuk paguhet" ("The Flame of Perrussich", str. 1; art. i cit.; Raitt, po aty f. 377a).

<sup>7</sup> Shkrimtarja britanike e paraqet "The flame of Perrussich" me këto fjalë: "Një prej këtyre poemave mbështetet mbi betimin mes shokësh, që është diçka e zakonshme për luftëtarët ilirë. Dy njerëz të bashkuar në këtë mënyrë quhen *Pobratimi*, ose gjysëm-vëllezër; shpesh ata flijojnë jetën e vet për njëri-tjetrin, dhe çdo grindje mes tyre është po aq skandaloze sa kur, ndër ne, djali keqtrajton babanë e tij" (art. i cit.; Raitt, f. 376b).

<sup>8</sup> Shih Jaroslav Frycer, "Syri i keq - vështrimi frenetik", *Romantizmi frenetik*, përmbledhje artikujsh, f. J. Frycer dhe F.P. Kirsch; Brno-Wien, Masarykovy universita- Universität Wien, 1993, f. 61-72: "Kjo bestytni ndeshet në mbarë botën, që nga Irlanda në Kore, nga Groenlanda në Peru dhe Brazil, tek Bantutë si dhe te Pigmejtë. Në lashtësinë greke, ajo quhej *baskania*, në Romë *fascinum*, *fascinatio*, në spanjisht *mal ojo*, në italisht *fascino* ose *jettatura*, në anglisht *evil eye*, në gjermanisht *böser blick* etj." (f. 63-64). Dihet se Teofil Gotjeja ka shkruar një novelë me titull "Jettatura".


<sup>9</sup> Një strofë si kjo p.sh.: "Më mirë do ndjeheshit sonte në shtëpinë time; atje ka jastëkë atlasi, dhe ju do të preheshit natën me perde damasku" ("Maximus and Zoe", 21; M. Shelley, art. cit.; Raitt, p.379 a) nuk mund të mos të bëjë të qeshësh, kur dihet se, në malësinë shqiptare, jastëkët prej atlasi ishin po aq të rrallë aso kohe sa edhe sot.

<sup>10</sup> As gjakmarrja nuk është një veprim posaçërisht shqiptar. Shih Ernst Jünger: "Ndëshkimi ngrihet mbi gjakun e kriminelit, dhe përmes tij e drejta. Një ndëshkim i pakryer përbën rrezik për të gjithë. Ndaj thuhej dikur se "gjaku nuk duhet të mbesë mes nesh" (*Le mur du temps*, § 52; përkth. Henri Thomas, Paris, Gallimard, coll. "Folio-Essais", 1994, p.102)

<sup>11</sup> (...) vjehri i saj, Aleksi, maniak siç qe për të shpjeguar zanafillën e mbiemrit të familjes, i kishte vizatuar atij një urë triharkëshe, që ndodhej diku në Shqipërinë Qendrore dhe në të cilën ishte bërë dikur një flijim" (*Qorrfermani*, f. 28)

<sup>12</sup> (...) kishte parë, në një vend shumë të largët, një urë në themelet e së cilës ishte muruar një njeri. (...) Ishte një urë e vogël, më saktësoi ai, dhe , për të shmangur shembjen e saj, ishte dashur të bëhej një flijim" (*Muri i madh*)





prania e Tabir Sarajit<sup>13</sup>, e familjes së Qyprillinjve<sup>14</sup> dhe e Mark-Alemit<sup>15</sup>, na lejon t’i vendosim ngjarjet e përshkruara në këtë novelë rreth pesëmbëdhjetë vjet para atyre te *Pallati i Ëndrrave*. Madje ky i fundit përmbante një aluzion të pakapshëm deri në botimin e *Qorrfermanit*<sup>16</sup>.

Kjo novelë paraqet, si në rastin e *Sjellësi i fatkeqësisë*, zbatimin e një dekreti të qeverisë osmane. Kësaj here, sidoqoftë, nuk kemi të bëjmë me mbulimin e fytyrave të grave të vendeve të pushtuara, por me verbimin e të gjithë atyre për të cilët dyshohej se kishin, realisht apo në mënyrë të hamendësuar, syrin e keq; ndërsa vullnetarëve u jepej dëmshpërblim dhe e drejta për të zgjedhur mënyrën e verbimit më pak mizore se të tjerat.<sup>17</sup> Shumë shpejt, bëhet e qartë se dekreti është shpallur vetëm për arsye politike, me synimin për të larguar, me goditje të tërthortë, nga sferat e larta të shtetit vezirin Qyprilli<sup>18</sup>. Pasi arrihet ky synim, shfuqizimi i dekretit do të dërgojë ende në botën e territ ata që ishin ngarkuar ta zbatonin më parë.

Për krijimin e kësaj novele, Kadareja ka mundur të shfrytëzojë gojëdhënat dhe besëtytnitë popullore shqiptare (të cilat ai në shumicën e rasteve i ka rikrijuar). Në kapitullin e fundit, kur të verbrit, pas shfuqizimit të dekretit, vërshojnë rrugëve dhe kafeneve, atij me siguri i është kujtuar momenti

<sup>13</sup> “Dëgjove ç’ndodhi dje përpara Tabir Sarajit?... (Qorrfermani, f. 60)

<sup>14</sup> Familja ku ajo do të hynte ishte fis (vërtet i largët, me gjithë atë fis) me Qyprillinjtë e famshëm. Madje mbiemri i saj Ura, nuk ishte veçse mbiemri i vjetër, paraprak, i Qyprillinjve, që ata, për arsye të larta shtetërore, e kishin ndërruar duke e përkthyer nga shqipja në osmanishte. (po aty, f. 28 ) Shih *Pallati i Ëndrrave*, f. 68: (...) “mbiemri i Qyprillinjve s’ishte veçse përkthimi i fjalës “Ura”, që vinte nga një urë e moçme triharkëshe në Shqipërinë Qendrore, e ngritur në kohën kur shqiptarët ishin ende të krishterë, dhe në themelet e së cilës ishte muruar një njeri.”

<sup>15</sup> (...) “një nipi të tyre, një djalë i zbehtë dhjetë-dymbëdhjetëvjeçar, që kishte ardhur për vizitë një vit e ca më parë së bashku me të ëmën. Djali quhej Mark-Alem, ishte i paafueshëm. (Qorrfermani, f. 28)

<sup>16</sup> Të verbrit që vinin në kafene nuk ishin të verbër dosido, të bërë kështu nga sëmundja apo ndonjë goditje, as të plagosur në luftë (...) Nga femënia Mark-Alemit i kujtohej, ndonëse turbull, dekreti i famshëm i “Qorrfermanit”, me anë të të cilit shteti kishte shpallur verbimin e dhjetëra mijëra njerëzve që, me syrin e keq, rrezikonin mbretërinë; por vetëm prej kafetarit kishte mësuar ç’kishte ndodhur në të vërtetë : ankthin e pafund, gjuetinë e sykëqinjve, së fundi pensionet që u kishte dhënë shteti atyre që u paraqitën vullnetarisht për t’u çliruar prej syve të vet. (*Pallati i Ëndrrave*, f.122-123 )

<sup>17</sup> Në një udhëzim të tij Komisioni Qendror kishte përcaktuar qartë pesë mënyrat e nxjerrjes së syve: bizantino-venecianen (me hekur me dy gjilpëra), tibetianen (me shtypje gurësh mbi zgrof për të shkaktuar daljen e kokërdhokëve), mënyrën vendase (me thartirë gërryese), romako-kartagjenasen (me tepri drite) dhe atë evropianen (me mungesë drite). Po në të njëjtën qarkore përcaktoheshin gjithashtu se, përveç shpërbllimit në të holla, do të kishin të drejtën e zgjedhjes së mënyrës së verbimit gjithë ata që do të paraqiteshin vullnetarisht përpara komisioneve. (*Qorrfermani*, f. 23).

<sup>18</sup> Fjala është për një episod nga përplasja e përhershme mes Qyprillinjve dhe Sheh- Ul-Islamit (po aty f. 10-11), që përshkon dhe *Pallati i Ëndrrave* gjithashtu.

nga *Komedia Hyjnore*<sup>19</sup>, kur Dantja me Virgjilin kryqëzohen me një procesion të verbrish.

*Nuk e besoj se ka njeri mbi dhe  
aq zemërgur, që të mos mbesë i prekun  
dhimbje për çka pastaj unë vura re.*

*Kur unë arrita te ata të vdekun  
dhe qartë e pashë gjendjen e tyre, shumë  
shfrevë me lot për sa ishin tue hjekun.*

*Me kmishë torture dukeshin t’mbuluem,  
në sup shoshoqin mbanin pa ia nda  
e muri i mbante mos me u rrezuem.*

*Kështu t’verbtët e shkretët e fukara  
rrinë para kishës e lëmoshë kërkojnë  
e njani prir te tjetri kryet paksa,  
se me i prekë zemrën botës dëshirojnë;  
jo veç me ato fjalë që u dalin fill,  
ma tepër me atë pamje të pikëllojnë.  
Sikur te qorrat nuk arrin kurrë diell,  
kështu dhe shpirtnat që përmenda ishin,  
dritë mbi ata nuk resh i ambli qiell;*

*qepun me tela sytë e tyne i kishin,  
siç ia punojnë skyferit grabitqar,  
që rrin i butë kur qepun e ka mishin.*<sup>20</sup>

Bie në sy ajo çka e dallon Shqipërinë e Mary Shelley-t nga ajo e Kadaresë. Shkrimtarja britanike krijon personazhe, të cilët, edhe pse nuk shquhen për thellësi psikologjike, nuk kanë më pak karaktere të spikatura; kaçakë e luftëtarë për të cilët hakmarrja dhe krimi janë çështje që zgjidhen mes individësh. Asnjëherë nuk bëhet fjalë për drejtësi shtetërore, për rregullime apo dëmshpërblime legale. Gjithçka shtjellohet brenda kuadrit të një kodi nderi të pashprehur e të pashkruar. Fryma e romantizmit në përgjithësi dhe ndikimi i Bajronit, në veçanti, dallohen dukshëm. Ndërsa bota e Kadaresë është ajo e frikës së ngritur në mjet për të qeverisur, e administratave të pazbërthyeshme, e funksionarëve të ngurtësuar e të ndërkëmbyeshëm, e natës komuniste që ra mbi Shqipërinë (mjaft e ndryshme, dhe më pranë, në disa aspekte, Mary Shelley-t, është imazhi që përcjell *Kështjella*). Le të krahasohet fillimi i *Syrit të keq*:

*Moreoti Katusthius Ziani, i raskapitur dhe me frikën e kusarëve vendës, udhëtonte nëpër pashallëkun e Janinës; gjithsesi nuk kishte arsye për të qenë i tmerruar. A nuk mbërriti ai, i lodhur e i uritur në një fshat të vetmuar – a s’u ndodh ai papritur në djerrinat e pabanuara, i rrethuar nga një bandë kaçakësh – apo në qytetet më të mëdha a nuk u zmbraaps ai kur e pa veten të veçuar nga raca e tij midis malësorëve të rreptë dhe turqve despotikë – kur sapo njoftoi se ishte Pobratimi i Dhimitrit me Syrin e Keq, iu zgjat çdo dorë dhe çdo gojë i uroi mirëseardhjen*<sup>21</sup> me një pasazh si ky më poshtë nga *Qorrfermani*:


*Një gjë e njohur, disi e harruar që prej disa vjetësh, nisi të notonte në erë: frika. Ishte një frikë e veçantë, fare e ndryshme nga ato që përftonin sëmundjet, kusarët, fantazmat apo vdekja: frika prej shtetit. E akullt, pa përmasa, me një zbrazëti të madhe tejprtej, por që mbushte megjithatë gjithçka, ditë për ditë e orë pas ore, ajo nisi të përfshinte në qerthullin e saj qindra mijëra njerëz.*<sup>22</sup>

<sup>19</sup> Për lidhjet mes romancierit shqiptar dhe *Komedisë Hyjnore*, shih studimin tonë të përmendur në shënimin e mësipërm.


<sup>20</sup> *Komedia Hyjnore* (përkthyer nga Pashko Gjeçi), Onufri, 2021, f. 277

<sup>21</sup> Shelley, Mary. *Syri i keq*, f. 100

<sup>22</sup> Kadare, Ismail. *Qorrfermani*, f. 14



Janë dy tregime të ndryshme të ngritura mbi të njëjtën besëtytni, por dallimi mund të shpjegohet më tepër me ndryshimet e sjella prej historisë se sa me dy personalitetet sigurisht të pangjashme apo se bëhet fjalë për dy talente të dallueshme mes tyre (megjithëse është fakt se nuk ka dyshim që Mary Shelley nuk shfaqet në tërë lartësinë e saj te *Syri i keq*, që paraqitet mjaft i dobët). Mes romantizmit heroik të Mary Shelley-t dhe pesimizmit absolut të Kadaresë, ka hyrë historia, që ka marrë pamjen e totalitarizmave të përmasave të mëdha. Mund të thuhej: “Për fat të keq! Ka kaluar historia”, njëlloj siç thoshte Remboja “Për fat të keq! Ka kaluar Bibla”. Figura emblematike e universit Kadarejan, njeriu i ri i Partisë Komuniste kineze, i vdekur para se të lindë, ruan gjurmë të këtij kalimi. Nëse *Syri i keq* është një degë e dobët në trungun e fuqishëm të *Çaild Haroldit*, *Qorrfermani* shënon, si dhe *Pallati i Ëndrrave*, një kthim te Dantja; dhe jo një shtesë të thjeshtë anësore, por fare qartë rimarrjen e një konfiguracioni teologjik, i cili, sipas vetë Kadaresë e gjen rilindjen e tij në sistemet politike të një shekulli të ndërkryer.





# 13 GABIME QË HASEN RËNDOM NË KRITIKËN LETRARE DHE SI TË SHMANGEN ATO

JAY A. FERNANDEZ  
shkruan për disa gjëra të gabuara

Përktheu nga origjinali Engjëllushe Shqarri

Kuptohet lehtë se përse të shkruarit e kritikës letrare tërheq aq shumë autorë, aspirues apo të njohur, apo dhe studiues të tjerë të letërsisë: për mundësinë që ajo na jep për të vënë në dukje dashurinë për librat, duke treguar ndërkohë zotësinë tonë si shkrimtarë dhe mendimtarë. Interpretimi mendjendritur i jetës letrare të botës është bërë pjesë e diskursit publik që 2.500 vite më parë dhe luan një rol gjallërues, thelbësor në shëndetin e arteve dhe të shoqërisë sot. Është një veprimtari e admirueshme, frymëzuese, e cila e lidh komentuesin me një traditë zanafilla e të cilës shkon deri tek Aristoteli.

Unë e dua gjuhën dhe adhuroj gjithkënd që punon për zotërimin e arteve gjuhësore. Është një përpjekje e vështirë, befasuese, shpërblyese, e cila i përllig dilemat e veta. Letërsia mund të jetë pafundësisht elastike, por kritika e librave ka praktikën dhe parametrat e veta më të mira, të cilat nuk janë më pak të fuqishme për faktin se mund të mos jenë të shkruara. Ajo është një formë që mund të mësohet, një zanat që mund të përmirësohet dhe rafinohet. Si shkrimtar dhe redaktor prej më shumë se 20 vitesh, kam vënë re disa praktika mbizotëruese që e prishin një shkrim kritik, që ndryshe do të ishte i mrekullueshëm, edhe pse mua vetë më siguron jetesën përmes një pune që e bëj me shumë kënaqësi.

Duhet të them se njohja nga ana ime e këtyre gabimeve trashanike e ka zanafillën tek angazhimi im i hershëm për të mos i përsëritur ato. Puna ime e parë e vërtetë ishte si ndihmës redaktor në seksionin e kritikës letrare në *The Washington Post*, *Bota e librit*. Kjo ka ndodhur nga mesi, deri fundi i viteve '90të, kur kam pasur fatin e madh të dëgjoja përditë debatet letrare të një grupi të shkëlqyer njerëzish të apasionuar pas letërsisë, të moderuara nga dy redaktorë të kritikës që kishin fituar Çmimin Pulitzer për kritikën e tyre të mrekullueshme—Jonathan Yardley (1981, kur punonte në *The Washington Star*) dhe Michael Dirda (1993), që të dy autorë librash. Burra dhe gra të tilla shkruanin kritika për emrat më të mëdhenj të letërsisë, e megjithatë, nuk drruheshin për asnjë çast të sugjerionin ndryshime të nevojshme që e përmirësonin një pjesë letrare. Ata u treguan shumë bujarë që më lejuan të provoj dorën me këtë zanat, duke më drejtuar në punën time të hershme si kritik letrar.

Në ditët e sotme, politika e internetit, sipas të cilës të gjithë mund të bëjnë gjithçka, ka nxitur përhapjen e epidemisë së terrorizmit sintaksor. Ka shumë pak rojtarë editorialë dhe, me sa shihet, shumë të diplomuar në artet e bukura, të cilët arrijnë të zotërojnë teorinë por jo mekanikën e kritikës. Gjithashtu moria e pafund e materialit që Interneti të lejon të kopjosh, ua bën gati të pamundur shumicës së redaktorëve, qoftë edhe atyre vërtet të mirë, të gjejnë kohë për të diskreditur si duhet kopjimet dhe për të bërë komente gjithëpërfshirëse rreth saj. Dhe kjo është e turpshme, sepse reputacioni i botimeve vuan kur shkrime jo cilësore arrijnë të shohin dritën e botimit, ndërsa kritikë potencialisht të mëdhenj përfundojnë duke mbledhur komente jo cilësore për shkak se të shkruarit e tyre të pakujdesshëm nuk ka arritur të përthithë vitet e përpunimit të kritikës, që sistemi i vjetër do të kish kërkuar me këmbëngulje prej tyre. *ideo list is empty*.

Ne të gjithë i jemi futur kësaj pune të vështirë për shkak të dashurisë për gjuhën dhe të përdëllimit që kemi ndjerë sa herë që kemi hasur ndonjë frazë të mrekullueshme. Që do të thotë se të gjithë jemi të një mendjeje me idenë se një shkrim – i kujt do qoftë – duhet të këndojë. Sigurisht, leximi i shkrimeve të kritikëve të mëdhenj, duke nisur nga Harold Bloom, Martin Amis, dhe John Updike e Michiko Kakutani, Doris Lessing, dhe Susan Sontag, do të ishte me dobi të pafund. Gjithsesi, këtu po ju jap disa udhëzime të mia për t'u qëndruar larg gabimeve më të zakonshme (Lëshimet gramatikore do t'i lëmë për një ese tjetër).

## 1. PRETENDIME TË MËDHA

Fillimi i një kritike me një ndjenjë hiperbolike—kam parë fillime të tilla si, “Autori filan është një shkrimtar i cili arrin që të çajë tejprtej pëlhurën e kohës për të zgjidhur të fshehtat e jetës”—mund të tingëllojë mirë, por çfarë kërkon të thotë, realisht? Për më tepër, është një pohim kaq i fryrë, sa lexuesin e shtyn të kujtojë një listë tepër të shkurtër autorësh për të cilët mund të ketë pretendime të tilla, listë e cila nuk e përfshin autorin filan i cili sapo ka botuar romanin e tij të dytë. Kështu që, përpara se të ketë përfunduar së lexuari fjalinë apo paragrafin e dytë, lexuesi ka nisur të dyshojë tek një gjykim i tillë. Ulini kërkesa të tilla dhe sigurohuni që të jenë të qarta dhe të mbrojtshme.

Një aspekt tjetër, është niveli i njohurive tuaja. Nëse keni ndërmend të shpallni diçka si më të mirën e vitit, apo aq të shkëlqyer sa nuk ta rrok mendja, do të bënit mirë që më parë të lexonit të gjitha romanet që kanë dalë atë vit dhe të njiheshit si një kritik që jeni provuar si një prej më të lexuarve në botë. Modestia dhe përmbajtja do të ishin në të mirën tuaj. E kundërta do t'ju bënte të dukeni qesharak.

## 2. MUNGESË QARTËSIE

Shumë shkrimtarë, përshi edhe mua vetë, ndonjëherë janë fajtorë që e lënë imagjinatën të marrë krahë, me një gjuhë me fjalë të hatashme nga pikëpamja zanore dhe rrokjesore, por që në fakt nuk të thotë asgjë. Që të tregohem i mëshirshëm, zakonisht, ngasja impulsive është që lexuesin ta impresionosh me një gjuhë befasuese, të bukur dhe për këtë: *bravo*. Që të jem më pak i mëshirshëm, kjo është një orvatje jo konsensuale, e nxitur nga egoja juaj për ta detyruar lexuesin t'ju shohë tek masturboni i shfrenuar me përdorimin e fjalëve. Në një rast të tillë, duhet të punoni për vendosjen e kufijve!

Koklavitje të tilla këmbëngulëse shumë shpesh e errësojnë kuptimin dhe e futin lexuesin në grackën e leximit me vëmendje të çdo fjalie shatë herë, vetëm e vetëm për të gjetur atë që *mund* të kishin dashur të thoshit. Për të vlerësuar në mënyrë të paanshme punëdoren tuaj të lezetçme, pas fluksit fillestar frymëzues, kërkohet një qëndrim i vendosur kundër broçkullave dhe fjalëve mikluase. Një paralajmërim, në këtë pikë, truri juaj do të refuzojë të shoshitë me kujdes

një fjali apo frazë të caktuar nga frika se mos do t'ju duhet ta ndryshoni. Në këto raste, kthehuni mbrapsht: rishkruajeni idenë në prozë të drejtpërdrejt të klasës së tretë dhe pastaj nisni e zbukurojeni.

## 3. PËRSËRITJE DHE FJALË TË TEPËRTA

Zakonisht kjo ndodh për shkak të shtysës së brendshme për t'u siguruar që lexuesi të mos e kalojë pa e vënë re atë që kërkon të thoni, e cila sipas jush është jashtëzakonisht e zgjuar. Fatkeqësisht, ajo që përsëritja në fakt tregon është pasiguri lidhur me një argumentim dhe kjo e pakëson besimin e lexuesit tek ju. Edhe nga këndvështrimi i lexuesit, është e lodhshme; njëllot sikur ta detyrosh të ecë mbi ujë, ndërkohë që është në mesin e një noti të bukur, të hijshëm.

Një paragraf që qarkullon të njëjtën ide përmes disa përsëritjeve ngjason me një kumtesë kolegji që zgjatet e tejzgjatet deri sa të kapë kufirin minimal të fjalëve për faqe. Nga ana pozitive, në të shumtën e herëve, atë që kërkon të thoni, e keni thënë më së miri që herën e parë. Hiqeni pjesën tjetër dhe pasurinë tuaj të vyer të patundshme përdoreni për gjëra të tjera. Mundësia tjetër është që nuk jeni shumë të sigurt se ku doni të dilni dhe keni vendosur të jepni disa goditje të shkurtra, në vend që të punoni shumë për të dhënë një grusht të fortë drejt e në shenjë. Bëni mirë të numëroni deri në tetë, para se ta provoni dorën edhe një herë.

## 4. NARCIZMI I RASTËSISHËM

Këtu ka një paradoks të çuditshëm të cilin e has vazhdimisht. Po, ju jeni ai që po bën kritikën e librit. Përgëzime! Por, drejt e mori, nuk keni pse të tërhiqeni vëmendjen për këtë gjë.

Thënë troç: *bëhuni i padukshëm në shkrim*. Një arsye për këtë, nëse nuk jeni Chimamanda Ngozi Adichie ose Michael Chabon, nuk e keni statusin në botën letrare që të meritojë interesimin e lexuesit për pikëpamjet tuaja të përgjithshme. Prandaj, deklaratat në vetën e parë janë më së shumti vetë-lavdëruese dhe shpërqendruese. Përqendrohuni tek puna që duhet të bëni. Dua të them, duke qenë shkrimtar, mund ta shihni situatën nga ana tjetër: Keni punuar një vit, ndoshta edhe tre, duke u djersitur për të shkruar atë roman dhe befas, del një student çfarëdo i arteve të bukura që gjysmën e kritikës prej 1500 fjalësh e shpenzon për të shkruar *mua* kështu, e *unë* ashtu. Është e pahijshme, e gabuar dhe, do të thosha, harbute.

Edhe diçka tjetër: është një punë krejtësisht e panevojshme. *Emri juaj është në artikull, zakonisht mu në krye!* Pra, kuptohet që çdo mendim i shprehur është një opinion juaji. Më besoni, përmes një zëri të sigurt, të fuqishëm, transmetohet një autoritet më i madh se sa përmes komenteve të mendjengushta personale, që lexuesi nuk ka arsye t'i marrë parasysh. Fjala është për një kritikë libri, prandaj mbajeni mend: misioni juaj është t'i shërbeni së pari, lexuesit dhe së dyti, autorit. Nuk bëhet fjalë për ndonjë afishe ku të shpalosni budallallëqet tuaja, që do të ishte një shenjë e sigurt amatorizmi. Nëse shkrimi juaj lexohet sikur të ishte shkruar për një blog, atëherë e ka vendin në një blog.

## 5. SHPJEGIMI I TEPËRUAR I SUBJEKTIT

Mund të jetë një përpjekje për t'iu shmangur mungesës së besimit në aftësitë kritike, ose keqkuptim i misionit të kritikut, por të shkruash një kritikë letrare, që fund e krye përshkruan subjektin, është si t'i përshkruash dikujt dimensionet e sakta të një pishine, pa i dhënë asnjë mundësi të kridhet në ujin e saj. Kjo është njëherazi tepër shumë dhe tepër pak. Detyra juaj nuk është që të jepni një përshkrim të plotë të subjektit të librit, por vetëm të vini në lëvizje fijet kryesore të tij, me qëllim që lexuesi të ketë informacion të mjaftueshëm për të mësuar nëse libri në fjalë i përshtatet më së miri shijeve të tij (dhe ia vlen kështu të shpenzojë kohë dhe para për të). Shikojeni këtë si flirtim: ju duhet të shkoni aq larg sa lexuesi të kuptojë nëse dëshiron ta marrë librin me vete në shtëpi.

Gjëja tjetër që duhet pranuar është se në fakt, komentet janë ato që përbëjnë *kritikën*. Që do të thotë se, nëse të gjitha komentet i keni përdorur për subjektin, atëherë nuk keni vlerësuar temat, personazhet, të fshehtat narrative, dialogun, strukturën, gjuhën, origjinalitetin, rëndësinë për njerëzimin në përgjithësi, kontekstin kulturor, cilësinë e saj si vepër arti, etj. Dhe nëse veproni kështu, atëherë përse lexuesi do të kishte nevojë për ju?

Ja një këshillë e mirë, e përgjithshme: mos përshkruani asnjëherë konkretisht diçka për subjektin përtej mesit të librit. Nga ana tjetër, shoh edhe shkrimtarë të zotë që zhyten drejt e në fund të kritikës, duke mos dhënë asnjë përshkrim bindës të subjektit të librit. As këtë mos e bëni.



## 6. GJATËSI E TEPRUAR

Kjo sigurisht është një çështje shijeje dhe jashtëzakonisht elastike, sidomos në epokën digjitale, duke qenë se nuk ju duhet të shkruani sipas formateve të bezdisshme të faqeve dhe kufijve të reklamave, me të cilat botimet e shtypura duhet të përplasen. Por, tekefundit, aty qëndron edhe problemi. Pikërisht fakti se mund të shkruani një kritikë letrare prej 3.200 fjalësh, nuk do të thotë se duhet të shkruani aq gjatë. Këtë lloj vëmendjeje duhet ta *fitoni* dhe ndodh rrallë që një kritik, apo materiali, ta meritojë këtë gjatësi.

Deri sa kam arritur këtë moshë, kam pasur mundësi të punoj në kohën që dizajni i një faqeje me material të shtypur, përfshinte kufij (kufij!) në gjatësinë e artikujve. Dua të theksoj se kjo nuk ishte thjesht një funksion i hapësirës fizike. Ishte një pasqyrim vlere. Në kushte ideale, lexuesi ia lë në dorë botimit dhe shkrimtarit që t’ia bëjnë gjykimet e vlerës për të. Dhe është vështirë të gjesh ndonjë arsye se përse kjo gjë duhet të ndryshojë në rastin e uebit.

Në fakt, shumë mirë mund të thuhet plotësisht e kundërta. Lexuesit sot kanë opsione të pafundshme për të lexuar materiale gjithë ditën e ditës. Prandaj, do të kërkonit tepër shumë duke i bombarduar me mijëra fjalë për një libër të vetëm – përveçse kur ky mund të ishte libri i fundit i një shkrimtari të dorës së parë, ose një rivlerësim i rëndësishëm i një klasiku të madh i bërë së fundmi. Në të shumtën e herëve, kufijtë e fjalëve e ftojnë një shkrimtar të bëhet më i mprehtë dhe të përdorë sa më pak zakonet e këqija të renditura këtu. Kujtoj kohët e *Ditës Botërore të Librave* dhe nëse David Remnick dhe Margaret Atwood mund t’ia dalin mbanë me 1.000 fjalë, me siguri edhe ju mund ta bëni.

## 7. ARGUMENTE PA LOGJIKË

Kjo nuk është e njëjta gjë si mungesa e qartësisë, ndonëse mund të mbivendoset me të. Njëra përfshin përdorimin e një gjuhe panevojshmërisht ekstravagante dhe ndërtime fjalish galopante për të errësuar një ide shumë të mirë, ndërsa tjetra nuk ka qenë ndonjëherë një temë që ia ka vlejtur për ta diskutuar. Një mënyrë e mirë për ta kapur veten në këto aspekte, është që një lexues i dytë të bëjë rolin e djallit të prozës suaj. Pak a shumë si me përgatitjet për debat, kur doni që pjesa juaj t’i jetë përgjigjur paraprakisht çdo pyetjeje dhe kundërshtimi të mundshëm nga lexuesit.

Ka një mungesë dëshirë për ta bërë këtë, për faktin se shumë prej nesh krijojmë ato që mendojmë se janë përsëritje të mençura, por neglizhojmë apo refuzojnë të kontrollojnë logjikën e tyre, nga frika se do na duhet të heqim dorë nga një krahasim i mrekullueshëm apo një batutë sarkastike. Zakonisht instiktet nuk na gabojnë: rreshti është vërtet problem. Kërkohet modesti që opinionet t’ia nënshtrohi provës së stresit, por si pasojë e kësaj, ju siguroj se shkrimi juaj do të përmirësohet. Përveç kësaj, çdo redaktor i mirë do t’ju thërriste për t’i korrigjuar dhe do të ishit i detyruar ta bënit.

## 8. REFERENCA LETRARE VETËMIKLUERE

Kjo është një patericë e veçantë e shkrimtarëve më të rinj në moshë dhe në profesion, që zakonisht vjen nga ngasja për të kompensuar pasigurinë lidhur me kritikën letrare që ju kanë besuar të shkruani (ose, mos e dhëntë perëndia, nga që besoni ndershmërisht se jeni tepër i zoti në botën letrare). E kuptoj, doni të përligjini qenien në një pozitë gjykuese, përmes krijimit të kredencialeve personale, dhe të përdorni referenca bombastike si një instrument për të përmirësuar legjitimitetin tuaj. Puna është se këto gjëra shihen që një kilometër larg dhe bëjnë efektin e kundërt.

Prandaj do t’ju sugjeroja që t’i shmangeni futjes së këtyre referencave te Herakliu apo Anna Akhmatova, përveç se kur jeni të sigurt se janë organike. Shpesh referenca të tilla kanë shumë pak rëndësi për atë që jeni duke diskutuar. I vetmi qëllim i tyre është t’i tregojnë lexuesit se jeni një kritik me njohuri të gjera, të cilat njerëzit e tjerë do t’i linin gojëhapur. Por, ajo çka ato tregojnë *në të vërtetë*, është aftësia juaj për të kërkuar midis *Citimeve* për të gjetur se ku përmenden shelgjet (ç’kemi Ofeli!).

## 9. SUPOZIME TË KUFIZUARA

Rritja e diversitetit dhe një përfaqësim më i paanshëm në botën letrare janë pa diskutim zhvillimi pozitivë. Por, edhe nëse, për shembull, romanin e ka shkruar një grua dhe bëhet fjalë për çështje të grave dhe ju jeni në fakt grua (apo e identifikuar si grua) mos e trajtoni kritikën sikur nuk do ta lexonte apo vlerësonte kurrë ndonjë burrë. Dhe e kundërta. E njëjta gjë vlen edhe për letërsinë e shkruar nga autorë gei.



Pjesa më e madhe e revistave me interes të përgjithshëm lexohen nga të gjithë llojet e njerëzve. Dhe jam i sigurt se autori i librit do të parapëlqente që lexuesit tuaj të ishin sa më të shumtë dhe nga të gjitha fushat. Përsëri, bëni një përshkrim të shpejtë të subjektit dhe një analizë të pikave të forta dhe të dobëta të veprës, që do ta bënin lexuesin të vendoste vetë nëse librin në fjalë do ta përfshinte në listën e librave që do të blente.

## 10. NGËRÇET STRUKTURORE

Krijimi i një pune të këndshme, të rrjedhshme e të gjallë është një art i bukur dhe kritika letrare ka modelet e saj të natyrshme. Përfundimi i shkrimit në formë të rastësishme dhe tematike, me një fjali që me zgjuarsi të kujton fillimin e tij, është një paraqitje e mençur dhe e kënaqshme, ndërsa paraqitja e subjektit që në fillim dhe rezervimi i gjysmës së dytë të saj kryesisht për analizën kritike, është një strukturë e mirë, por e vrazhdë.

Padyshim që duhet të jeni krijues, por çelësi është që problemet e subjektit të shkrihen dhe të rishkrihen me problemet kritike në mënyrë që të gjitha të shtyhen përpara njëlloj dhe në mënyrë efikase, drejt një rryme të vetme, koherente. Një kritikë që përmban blloqe të rastësishme përshkrimi të subjektit të hedhura aty këtu, pa rregull, i kërkon lexuesit të bëjë shumë punë për të gjetur se çfarë ka ndodhur. Por, edhe një kritikë që përfshin që në fillim një masë analize kritike, e lë lexuesin të humbur, pa pasur një kontekst narrativ dhe pa personazhe që t’i vendosë në të.

## 11. PËREMRA MOSPËRPUTHËS

Kur i referohet lexuesit të mundshëm të romanit (dhe lexuesit të kritikës), tepër shpesh kritiku përdor një përzierje përemrash që e çorienton lexuesin. Nëse ndonjëherë përdorni “ju” dhe ndonjëherë “ne” dhe herë të tjera “Njeriu” dhe diku tjetër “lexuesi” apo “lexuesit”, kjo e bën shkrimin të rrëmujshtëm dhe të ngatërruar. Pastaj, është përemri i tmerrshëm “unë”, për të cilin folëm më sipër. Lexuesi detyrohet të ndalojë dhe të pyesë, kujt po i flet përsëri! “Ju-ja” është juve apo unë? Përse më përfshin edhe mua në këtë “ne”?

Mendimi im është që të përpigjeni të shmangni përemrin në veten e dytë shumë, dhe duke pasur parasysh Pikën 4 (Narcizmin), përsëri ju inkurajoj që përemrin “Unë” ta lini jashtë, nëse nuk jeni Joyce Carol Oates, ose Michelle Obama. Sa herë që kini mundësi, shkruajeni kritikën duke përdorur “lexuesi” ose “lexuesit” ose, nëse duhet pa tjetër, përdorni përemrin “ne”. Por, e rëndësishme është, që të jeni konsekuentë.

## 12. MUNGESA E KRITIKËS

Në gjithë diskutimin për kritikën e librave, kam vënë re një mungesë të vazhdueshme alarmuese të kritikës së vërtetë. Shumë shpesh, kritikët lexohen si të ishin shkrime të shkurtra për kapakun e pasmë të një fletushke së botuar nga një mik.

Pikësëpari, lëvdatat e mëdha janë logjikisht absurde. Çdo vepër e shkruar ka dobësitë e veta, veçanërisht kur në të futen shijet personale. Është detyra juaj t’i vini ato në dukje, në mënyrë të qartë, por me takt (dhe taktike), duke e matur veprën me standarde të arsyeshme të letërsisë dhe/ose me zhanrin e saj. Nëse ideja se mos lëndoni ndjenjat e autorit ju bën të ngurroni, kjo është shenjë e mirë që tregon se ka gjasa që të tregoheni i respektuar. Nëse nuk jeni i gatshëm që t’i futeni fare atij rreziku, duhet të mos merreni fare me kritikë letrare.

Së dyti, me siguri ka të ngjarë që të mos keni lexuar 20.000 libra dhe ajo përqindje e vogël që keni lexuar përfshin një numër të vogël kryeveprash. Po të isha unë, do të tregohesha i kujdesshëm në lëvdatat e veprës së parë apo të dytë të një romancieri të panjohur, duke ua rezervuar ato shkrimtarëve me emër si Dickens dhe Wharton.

Së treti, si do ta ndihmonit lexuesin duke u treguar tepër entuziast për një libër pa kushedi se çfarë konteksti, duke e krahasuar me vepra të tjera të këtij lloji, pa bërë asnjë koment për mënyrat stilistikore, dialogun, gjuhën, ritmin, strukturën, sfondin, karakterizimin, koherencën narrative apo vërtetësinë emocionale? Më lejoni ta them kështu: kur merrni me lavdërime të kota, mua më vjen të gogësisj.

Thelbi është ky, një kritikë spontanisht keqdashëse, e ushqyer nga zilia krijuese është mizore dhe e pasinqertë. Mos prisni me shpatë nga të gjitha anët, vetëm sepse jeni në një pozitë që mund ta bëni. Nëse vepra që ju kanë dhënë të analizoni është vërtet aq e tmerrshme, këtë e merrni vesh që në 50 faqet e para dhe mund ta refuzoni me mirësjellje atë punë dhe të kërkonti një tjetër.

## 13. KONFLIKTI I INTERESIT

Detektori im i broçkullave bie herë pas here kur konstatoj hollësi biografike, arsimore apo të botimeve në historinë e një kritiku, që tregojnë një mbivendosje të çuditshme me autorin, veprën e të cilit ai bën sikur komenton. Kur kritika është një përrua lavdërimesh të zjarrrta, është akoma edhe më e dyshimtë.

Kjo është e lehtë. Mos bëni kritikën e askujt që njihni apo me të cilin keni pasur një kontakt më të gjatë në jetën profesionale apo personale. Arsyeja për këtë duhet të jetë e dukshme. Ndryshe i bie që autorët t’u kërkojnë mamave të tyre të shkruajnë kritika për ta. Kjo vlen edhe për qejfmbetjet. Kjo lloj prite hakmarrëse është banale dhe dëmton njëlloj si botimin që e bëri këtë të mundur, aq edhe autorin dhe kritikun.

Sigurisht media sociale dhe bota e tejmbushur me programe për shkrimet letrare, takimet, atelietë e punës i lejojnë shkrimtarët të lidhen me bashkëvuajtësit e tjerë më shumë se më parë. Kjo është diçka e mrekullueshme, duke qenë se shumica jonë jemi izolacionistë vetëdijshues, që druheni se miqtë e vetëm që kemi, janë ata që na frymëzojnë për krijimin e personazheve të çuditshëm në veprat tona. Por, kjo gjë bëhet shkas për vendosjen e një fare reciprociteti të korrupsuar, të kamufluar si mbështetje komuniteti.

Kështu që, në ndonjë rast të rrallë që e paralajmëroni redaktorin për një marrëdhënie të kahershme por, megjithatë, ai ju ngarkon të shkruani një kritikë, përdorni kartën e Nxjerrjes së Plotë që në fillim të shkrimit tuaj. Lexuesi juaj meriton të dijë nëse keni ndonjë interes dhe nëse jeni neutral lidhur me atë që po shkruani.



MODERNË KLASIKË



Roberto Arlt  
**DASHURI  
SHTRIGANE**  
roman

OMBRA GVG  
DESIGN | 21

